



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 25

Tiranë – E hënë, 12 shkurt 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 2/2024, datë 25.1.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për aktivitetet operacionale të kryera nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë.....
	2623
Dekret i Presidentit nr. 41, datë 6.2.2024	Për shpallje ligji.....
	2666
Ligj nr. 3/2024, datë 25.1.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 14.12.2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”, të ndryshuar.....
	2666
Dekret i Presidentit nr. 46, datë 7.2.2024	Për shpallje ligji.....
	2667
Ligj nr. 4/2024, datë 25.1.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 14.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar.....
	2667
Dekret i Presidentit nr. 42, datë 6.2.2024	Për shpallje ligji.....
	2667
Ligj nr. 5/2024, datë 25.1.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.....
	2667
Dekret i Presidentit nr. 43, datë 6.2.2024	Për shpallje ligji.....
	2668
Ligj nr. 7/2024, datë 25.1.2024	Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar.....
	2668

Dekret i Presidentit nr. 47, datë 7.2.2024	Për shpallje ligji	2668
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 30.1.2024	Për miratimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit të disa formave të peshkimit.....	2668
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 670, datë 7.11.2023	Për delegim kompetence.....	2675
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 43, datë 1.2.2024	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”	2675
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70, datë 27.12.2023	Me objekt shfuqizimin e VKM-së nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, si të pajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	2676



LIGJ
Nr. 2/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EVROPIAN PËR AKTIVITETET
OPERACIONALE TË KRYERA NGA
AGJENCIA EVROPIANE E ROJËS
KUFITARE DHE BREGDETARE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, 121, pika 1, të
Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së
Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për aktivitetet
operacionale të kryera nga Agjencia Evropiane e
Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e

Shqipërisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji
dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 6/2019,
“Për ratifikimin e marrëveshjes statutore ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian
për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës
Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e
Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren
Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 41, datë 6.2.2024, të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**



MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN
PËR AKTIVITETET OPERACIONALE TË KRYERA
NGA AGJENCIA EVROPIANE E ROJËS KUFITARE DHE BREGDETARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

СПОРАЗУМЕНИЕ
МЕЖДУ ЕВРОПЕЙСКИЯ СЪЮЗ
И РЕПУБЛИКА АЛБАНИЯ
ЗА ОПЕРАТИВНИТЕ ДЕЙНОСТИ, ПРОВЕЖДАНИ
ОТ ЕВРОПЕЙСКАТА АГЕНЦИЯ ЗА ГРАНИЧНА И БРЕГОВА ОХРАНА
В РЕПУБЛИКА АЛБАНИЯ

ACUERDO
ENTRE LA UNIÓN EUROPEA
Y LA REPÚBLICA DE ALBANIA
EN LO QUE RESPECTA A LAS ACTIVIDADES OPERATIVAS
LLEVADAS A CABO POR LA AGENCIA EUROPEA
DE LA GUARDIA DE FRONTERAS Y COSTAS
EN LA REPÚBLICA DE ALBANIA

DOHODA
MEZI EVROPSKOU UNIÍ
A ALBÁNSKOU REPUBLIKOU
O OPERATIVNÍCH ČINNOSTECH PROVÁDĚNÝCH
EVROPSKOU AGENTUROU PRO POHRANIČNÍ A POBŘEŽNÍ STRÁŽ
V ALBÁNSKÉ REPUBLICI

AFTALE
MELLEM DEN EUROPÆISKE UNION
OG REPUBLIKKEN ALBANIEN
OM OPERATIONELLE AKTIVITETER, SOM GENNEMFØRES
AF DET EUROPÆISKE AGENTUR FOR GRÆNSE- OG KYSTBEVOGTNING
I REPUBLIKKEN ALBANIEN

VEREINBARUNG
ZWISCHEN DER EUROPÄISCHEN UNION
UND DER REPUBLIK ALBANIEN
ÜBER OPERATIVE TÄTIGKEITEN,
DIE VON DER EUROPÄISCHEN AGENTUR FÜR DIE GRENZ- UND KÜSTENWACHE
IN DER REPUBLIK ALBANIEN DURCHFÜHRT WERDEN

EUROOPA LIIDU JA
ALBAANIA VABARIIGI VAHELINE
EUROOPA PIIRI- JA RANNIKUVALVE AMETI
OPERATIIVTEGEVUST
ALBAANIA VABARIIGIS KÄSITLEV
KOKKULEPE

AL/EU/X 1a



ΣΥΜΦΩΝΙΑ
ΜΕΤΑΞΥ ΤΗΣ ΕΥΡΩΠΑΪΚΗΣ ΈΝΩΣΗΣ
ΚΑΙ ΤΗΣ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑΣ ΤΗΣ ΑΛΒΑΝΙΑΣ
ΣΧΕΤΙΚΑ ΜΕ ΕΠΙΧΕΙΡΗΣΙΑΚΕΣ ΔΡΑΣΤΗΡΙΟΤΗΤΕΣ ΠΟΥ ΔΙΕΞΑΓΟΝΤΑΙ
ΑΠΟ ΤΟΝ ΕΥΡΩΠΑΪΚΟ ΟΡΓΑΝΙΣΜΟ ΣΥΝΟΡΙΟΦΥΛΑΚΗΣ ΚΑΙ ΑΚΤΟΦΥΛΑΚΗΣ
ΣΤΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ ΤΗΣ ΑΛΒΑΝΙΑΣ

AGREEMENT
BETWEEN THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND THE EUROPEAN UNION
ON OPERATIONAL ACTIVITIES CARRIED OUT
BY THE EUROPEAN BORDER AND COAST GUARD AGENCY
IN THE REPUBLIC OF ALBANIA

ACCORD
ENTRE L'UNION EUROPÉENNE
ET LA RÉPUBLIQUE D'ALBANIE
CONCERNANT LES ACTIVITÉS OPÉRATIONNELLES
MENÉES PAR L'AGENCE EUROPÉENNE DE GARDE-FRONTIÈRES
ET DE GARDE-CÔTES EN RÉPUBLIQUE D'ALBANIE

COMHAONTÚ
IDIR AN tAONTAS EORPACH
AGUS POBLACHT NA hALBÁINE
MAIDIR LE GNÍOMHAÍOCHTAÍ OIBRÍOCHTÚLA ARNA nDÉANAMH
AG AN nGNÍOMHAIREACHT EORPACH UM AN nGARDA TEORANN AGUS
CÓSTA I bPOBLACHT NA hALBÁINE

SPORAZUM
IZMEĐU EUROPSKE UNIJE
I REPUBLIKE ALBANIJE
O OPERATIVNIM AKTIVNOSTIMA KOJE
AGENCIJA ZA EUROPSKU GRANIČNU I OBALNU STRAŽU
PROVODI U REPUBLICI ALBANIJI

ACCORDO
TRA L'UNIONE EUROPEA
E LA REPUBBLICA D'ALBANIA
RELATIVO ALLE ATTIVITÀ OPERATIVE SVOLTE
DALL'AGENZIA EUROPEA DELLA GUARDIA DI FRONTIERA E COSTIERA
NELLA REPUBBLICA D'ALBANIA

NOLĪGUMS
STARP EIROPAS SAVIENĪBU
UN ALBĀNIJAS REPUBLIKU
PAR OPERACIONĀLĀM DARBĪBĀM,
KO ALBĀNIJAS REPUBLIKĀ VEIC
EIROPAS ROBEŽU UN KRASTA APSARDZES AĢENTŪRA

AL/EU/X 1b



EUROPOS SĄJUNGOS IR
ALBANIJOS RESPUBLIKOS
SUSITARIMAS
DĖL EUROPOS SIENŲ IR PAKRANČIŲ APSAUGOS AGENTŪROS
ALBANIJOS RESPUBLIKOJE VYKDOMOS
OPERACINĖS VEIKLOS

MEGÁLLAPODÁS
AZ EURÓPAI UNIÓ
ÉS AZ ALBÁN KÖZTÁRSASÁG KÖZÖTT
AZ EURÓPAI HATÁR- ÉS PARTVÉDELMI ÜGYNÖKSÉG ÁLTAL
AZ ALBÁN KÖZTÁRSASÁGBAN VÉGZETT
MŰVELETI TEVÉKENYSÉGEKRŐL

FTEHIM
BEJN L-UNJONI EWROPEA
U R-REPUBBLIKA TAL-ALBANIA
DWAR ATTIVITAJIET OPERAZZJONALI MWETTQA
MILL-AĠENZIJA EWROPEA GHALL-GWARDJA TAL-FRUNTIERA
U TAL-KOSTA FIR-REPUBBLIKA TAL-ALBANIA

OVEREENKOMST
TUSSEN DE EUROPESE UNIE
EN DE REPUBLIEK ALBANIË
INZAKE OPERATIONELE ACTIVITEITEN
VAN HET EUROPEES GRENS- EN KUSTWACHTAGENTSCHAP
IN DE REPUBLIEK ALBANIË

UMOWA
MIĘDZY UNIĄ EUROPEJSKĄ
A REPUBLIKĄ ALBANIĄ
DOTYCZĄCA DZIAŁAŃ OPERACYJNYCH PROWADZONYCH
PRZEZ EUROPEJSKĄ AGENCJĘ STRAŻY GRANICZNEJ I PRZYBRZEŻNEJ
W REPUBLICIE ALBANI

ACORDO
ENTRE A UNIÃO EUROPEIA
E A REPÚBLICA DA ALBÂNIA
SOBRE AS ATIVIDADES OPERACIONAIS REALIZADAS
PELA AGÊNCIA EUROPEIA DA GUARDA DE FRONTEIRAS E COSTEIRA
NA REPÚBLICA DA ALBÂNIA

ACORD
ÎNTRU UNIUNEA EUROPEANĂ
ȘI REPUBLICA ALBANIA
PRIVIND ACTIVITĂȚILE OPERATIVE DESFĂȘURATE DE
AGENȚIA EUROPEANĂ PENTRU POLIȚIA DE FRONTIERĂ ȘI GARDA DE COASTĂ
ÎN REPUBLICA ALBANIA

AL/EU/X 1c



DOHODA
MEDZI EURÓPSKOU ÚNIOU
A ALBÁNSKOU REPUBLIKOU
O OPERAČNÝCH ČINNOSTIACH VYKONÁVANÝCH
EURÓPSKOU AGENTÚROU PRE POHRANIČNÚ A POBREŽNÚ STRÁŽ
V ALBÁNSKEJ REPUBLIKE

SPORAZUM
MED EVROPSKO UNIJO
IN REPUBLIKO ALBANIJO
O OPERATIVNIH DEJAVNOSTIH,
KI JIH EVROPSKA AGENCIJA ZA MEJNO IN OBALNO STRAŽO IZVAJA
V REPUBLIKI ALBANIJI

EUROOPAN RAJA- JA MERIVARTIOVIRASTON
ALBANIAN TASAVALLASSA
TOTEUTTAMIA OPERATIIVISIA TOIMIA KOSKEVA
EUROOPAN UNIONIN JA
ALBANIAN TASAVALLAN VÄLINEN
SOPIMUS

AVTAL
MELLAN EUROPEISKA UNIONEN
OCH REPUBLIKEN ALBANIEN
OM EUROPEISKA GRÄNS- OCH KUSTBEVAKNINGSBYRÅNS
OPERATIVA VERKSAMHET
I REPUBLIKEN ALBANIEN

AL/EU/X 1d



Bërë në Tiranë, më pesëmbëdhjetë shtator të vitit dy mijë e njëzet e tre.

Съставено в Тирана на петнадесети септември две хиляди двадесет и трета година.

Hecho en Tirana, el quince de septiembre de dos mil veintitrés.

V Tiranë dne patnáctého září dva tisíce dvacet tři.

Udfærdiget i Tirana den femtende september to tusind og treogtyve.

Geschehen zu Tirana am fünfzehnten September zweitausenddreißig.

Kahe tuhande kahekümne kolmanda aasta septembrikuu viieteistkümnendal päeval Tiranas.

Έγινε στα Τίρανα, στις δέκα πέντε Σεπτεμβρίου δύο χιλιάδες είκοσι τρία.

Done at Tirana on the fifteenth day of September in the year two thousand and twenty three.

Fait à Tirana, le quinze septembre deux mille vingt-trois.

Arna dhéanamh i dTíorána, an cúigiú lá déag de Mheán Fómhair sa bhliain dhá mhíle fiche a trí.

Sastavljeno u Tirani petnaestog rujna godine dvije tisuće dvadeset treće.

Fatto a Tirana, addì quindici settembre duemilaventitré.

Tiranā, divi tūkstoši divdesmit trešā gada piecpadsmitajā septembrī.

Priimta du tūkstančiai dvidešimt trečių metų rugsėjo penkioliką dieną Tiranoje.

Kelt Tiranában, a kétezer-huszonharmadik év szeptember havának tizenötödik napján.

Magħmul f'Tirana, fil-ħmistax-il jum ta' Settembru fis-sena elfejn u tlieta u għoxrin.

Gedaan te Tirana, vijftien september tweeduizend drieëntwintig.

Sporządzono w Tiranie dnia piętnastego września roku dwa tysiące dwudziestego trzeciego.

Feito em Tirana, em quinze de setembro de dois mil e vinte e três.

Întocmit la Tirana la cincisprezece septembrie două mii douăzeci și trei.

V Tirane pātnāsteho septembra dvetisīcdvadsa'tri.

V Tirani, petnajstega septembra dva tisoč triindvajset.

Tehty Tiranassa viidentenätoista päivänä syyskuuta vuonna kaksituhattakaksikymmentäkolme.

Som skedde i Tirana den femtonde september år tjugohundratjugotre.



Për Republikën e Shqipërisë
За Република Албания
Por la República de Albania
Za Albánskou republiku
For Republikken Albanien
Für die Republik Albanien
Albaania Vabariigi nimel
Για τη Δημοκρατία της Αλβανίας
For the Republic of Albania
Pour la République d'Albanie
Thar ceann Phoblacht na hAlbáine
Za Republiku Albaniju
Per lq Repubblica d'Albania
Albānijas Republikas vārdā –
Albanijos Respublikos vardu
Az Albán Köztársaság részéről
Għar-Repubblika tal-Albanija
Voor de Republiek Albanië
W imieniu Republiki Albanii
Pela República da Albânia
Pentru Republica Albania
Za Albánsku republiku
Za Republiko Albanijo
Albanian tasavallan puolesta
För Republiken Albanien

Për Bashkimin Evropian
За Европейския съюз
Por la Unión Europea
Za Evropskou unii
For Den Europæiske Union
Für die Europäische Union
Euroopa Liidu nimel
Για την Ευρωπαϊκή Ένωση
For the European Union
Pour l'Union européenne
Thar ceann an Aontais Eorpaigh
Za Europsku uniju
Per l'Unione europea
Eiropas Savienības vārdā –
Europos Sąjungos vardu
Az Európai Unió részéről
Għall-Unjoni Ewropea
Voor de Europese Unie
W imieniu Unii Europejskiej
Pela União Europeia
Pentru Uniunea Europeană
Za Európsku úniu
Za Evropsko unijo
Euroopan unionin puolesta
För Europeiska unionen

AL/EU/X 3



MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN
PËR AKTIVITETET OPERACIONALE TË KRYERA
NGA AGJENCIA EVROPIANE E ROJËS KUFITARE DHE BREGDETARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dhe

BASHKIMI EVROPIAN,

në vijim të referuar individualisht si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët",

DUKE PASUR PARASYSH SE mund të krijohen situata kur Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare ("Agjencia") koordinon bashkëpunimin operacional midis Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë territorin e Republikës së Shqipërisë,

DUKE PASUR PARASYSH SE duhet të krijohet një kuadër ligjor në formën e një marrëveshjeje statusi për situatat kur anëtarët e ekipit të caktuar nga Agjencia do të kenë kompetenca ekzekutive në territorin e Republikës së Shqipërisë,

DUKE PASUR PARASYSH SE marrëveshja e statusit mund të parashikojë krijimin e Agjencisë së zyrave të antenave në territorin e Republikës së Shqipërisë për të lehtësuar dhe përmirësuar koordinimin e aktiviteteve operationale dhe për të garantuar menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike të Agjencisë,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË nivelin e lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimin Evropian,



DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës Nr.108, datë 28 janar 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollin shtesë të saj,

DUKE RIKUJTUAR SE respektimi i të drejtave të njeriut dhe parimeve demokratike janë parime themelore që rregullojnë bashkëpunimin ndërmjet Palëve,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950, të drejtat e renditura të cilat korrespondojnë me ato të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE të gjitha aktivitetet operacionale të Agjencisë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të respektojnë plotësisht të drejtat themelore dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat janë palë Bashkimi Evropian, Shtetet Anëtare të tij dhe/ose Republika e Shqipërisë,

DUKE MARRË NË KONSIDERATË SE të gjithë personat që marrin pjesë në një aktivitet operacional janë të detyruar të ruajnë standardet më të larta të integritetit, sjelljes etike dhe profesionalizmit, si dhe respektimin e të drejtave themelore dhe të përmbushin detyrimet e vendosura mbi ta nga dispozitat e planit operacional dhe kodit të sjelljes të Agjencisë,

KANË VENDOSUR TË LIDHIN KËTË MARRËVESHJE:

NENI 1

Objekti

1. Kjo Marrëveshje rregullon të gjitha çështjet e nevojshme për caktimin e ekipeve të menaxhimit të kufirit nga Trupa Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë, ku anëtarët e ekipit mund të ushtrojnë kompetenca ekzekutive.
2. Caktimi/dislokimi i përmendur në pikën 1 mund të bëhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë kufijtë e saj tokësorë, detarë dhe ajrorë me vende të tjera. Në bazë të detyrimeve të palëve sipas ligjit të detit, në veçanti Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit 1982, aktivitetet operacionale mund të zhvillohen edhe në zonat afër Republikës së Shqipërisë. Aktivitetet operacionale të zbatuara sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikojnë në detyrimet e kërkim-shpëtimit që rrjedhin nga ligji i detit, veçanërisht nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit 1982, Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det 1974 dhe Konventa Ndërkombëtare për Kërkim-Shpëtimin në Det.



NENI 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përdoren përkufizimet si më poshtë:

- (1) "Agjenci" nënkupton Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare të krijuar me Rregulloren (BE) 2019/1896 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹ ose çdo ndryshim të saj;
- (2) "kontroll kufitar" nënkupton aktivitetin e kryer në kufi, në përputhje me/dhe për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, në përgjigje ndaj synimit për të kaluar ose aktit të kalimit të atij kufiri, pavarësisht nga çdo konsideratë tjetër, kjo konsiston në kontrollet kufitare dhe mbikëqyrjen kufitare;
- (3) "ekipet e menaxhimit të kufirit" nënkupton ekipe të formuara nga Trupa Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare për t'u vendosur/dislokuar gjatë operacioneve të përbashkëta dhe ndërhyrjeve të shpejta kufitare në kufijtë e jashtëm në Shtetet Anëtare dhe në vendet e treta;
- (4) "forum konsultativ" nënkupton organin këshillues të krijuar nga Agjencia në përputhje me nenin 108 të Rregullores (BE) 2019/1896;
- (5) "Trupa e gatshme të Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane" nënkupton trupat e gatshme të Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane të parashikuar në nenin 54 të Rregullores (BE) 2019/1896;

¹ Rregullore (BE) 2019/1896 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 nëntor 2019 mbi Rojën Evropiane Bregdetare dhe Kufitare dhe që shfuqizon Rregulloret (BE) nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624 (FZ L 295, 14.11.2019, fq. 1)



- (6) “EUROSUR” nënkupton kuadrin për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Agjencisë;
- (7) “monitorues i të drejtave themelore” nënkupton monitoruesin e të drejtave themelore siç parashikohet në nenin 110 të Rregullores (BE) 2019/1896;
- (8) “Shtet Anëtar i origjinës” nënkupton shtetin anëtar nga i cili një anëtar i personelit është vendosur ose dërguar në Trupën e gatshme të Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane;
- (9) “incident” nënkupton një situatë që lidhet me emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar ose një rrezik për jetën e emigrantëve në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Evropian ose të Republikës së Shqipërisë, ose përgjatë apo në afërsi të tyre;
- (10) “operacion i përbashkët” është një veprim i koordinuar ose i organizuar nga Agjencia për të mbështetur autoritetet kombëtare të Republikës së Shqipërisë përgjegjëse për kontrollin kufitar që synon të adresojë sfida të tilla si emigracioni i paligjshëm, kërcënimet aktuale ose të ardhshme në kufijtë e Republikës së Shqipërisë ose krimi ndërkufitar ose ofrimin e asistencës së shtuar, teknike dhe operationale për kontrollin e këtyre kufijve;
- (11) “anëtar ekipi” nënkupton një anëtar të Trupës së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane, i dislokuar përmes një ekipi të menaxhimit të kufirit për të marrë pjesë në një aktivitet operacional;
- (12) “Shtet Anëtar” nënkupton një Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian;



- (13) "aktivitet operacional" nënkupton një operacion të përbashkët ose një ndërhyrje të shpejtë kufitare;
- (14) "zonë operationale" nënkupton zonën gjeografike ku do të zhvillohet një aktivitet operacional;
- (15) "Shtet Anëtar pjesëmarrës" nënkupton një Shtet Anëtar që merr pjesë në një aktivitet operacional, duke siguruar pajisje teknike ose staf të Trupës së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane;
- (16) "të dhëna personale" nënkupton çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"). Një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si emri, një numri identifikimi, të dhënave të vendndodhjes, një identifikuesi në internet ose duke iu referuar një ose më shumë faktorëve specifikë fizikë, fiziologjikë, identitetit gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;
- (17) "ndërhyrje e shpejtë kufitare" është një veprim që synon t'i përgjigjet një situatë, sfide specifike dhe joproporcionale në kufijtë e Republikës së Shqipërisë duke dislokuar ekipe të menaxhimit të kufirit në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të kufizuar kohore për ta. Ata duhet të kryejnë kontrollin kufitar së bashku me autoritetet kombëtare të Republikës së Shqipërisë përgjegjëse për kontrollin kufitar;
- (18) "Staf statutor" nënkupton personelin e punësuar nga Agjencia në përputhje me Rregulloren e Stafit të Zyrtarëve të Bashkimit Evropian dhe Kushtet e Punësimit të Zyrtarëve të tjerë të Bashkimit të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit (KEE, Euratom, ECSC) Nr. 259/681.

¹ FZ BE L 56, 4.3.1968, fq. 1



NENI 3

Nisja e aktiviteteve operacionale

1. Një aktivitet operacional sipas kësaj Marrëveshjeje do të nisë me vendim me shkrim të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë (“drejtori ekzekutiv”) me kërkesë me shkrim të autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë. Një kërkesë e tillë do të përfshijë një përshkrim të situatës, periudhën e parashikuar të zbatimit, qëllimet dhe nevojat e parashikuara dhe profilet e personelit të nevojshëm, duke përfshirë personelin që ka kompetenca ekzekutive, sipas rastit.
2. Nëse drejtori ekzekutiv çmon se aktiviteti operacional i kërkuar mund të sjellë ose shkaktojë shkelje serioze dhe/ose të vazhdueshme të të drejtave themelore ose detyrimeve të mbrojtjes ndërkombëtare, atëherë drejtori ekzekutiv nuk do të nisë aktivitetin operacional.
3. Nëse, pas marrjes së një kërkesë sipas paragrafit 1, drejtori ekzekutiv çmon se informacione të mëtejshme janë të nevojshme për të vendosur nëse do të nisë një aktivitet operacional, ai ose ajo mund të kërkojë informacione të mëtejshme ose të autorizojë ekspertët e Agjencisë për të udhëtuar në Republikën e Shqipërisë për të vlerësuar situatën atje. Republika e Shqipërisë do të lehtësojë një udhëtim të tillë.
4. Drejtori Ekzekutiv vendos të mos nisë një aktivitet operacional nëse ai ose ajo e konsideron të justifikuar pezullimin ose përfundimin e tij sipas nenit 18.

NENI 4

Plani operacional

1. Në planin operacional do të bihet dakord për çdo aktivitet operacional ndërmjet Agjencisë dhe Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenet 38 dhe 74 të Rregullores (BE) 2019/1896. Plani operacional do të jetë i detyrueshëm për Agjencinë, Republikën e Shqipërisë dhe Shtetet Anëtare pjesëmarrëse.
2. Plani operacional miratohet me shkrim nga drejtori ekzekutiv dhe përfaqësuesi i autoritetit kompetent të Republikës së Shqipërisë.
3. Plani operacional do të përcaktojë me detaje aspektet organizative dhe procedurale të aktivitetit operacional, duke përfshirë:
 - (a) një përshkrim të situatës, me modus operandi dhe objektivat e caktimit, duke përfshirë qëllimin operacional;
 - (b) kohën e parashikuar që aktiviteti operacional pritët të zgjasë për të arritur objektivat e tij;
 - (c) zonën operacionale;



- (d) një përshkrim të detyrave, duke përfshirë ato që kërkojnë kompetenca ekzekutive, përgjegjësi, duke përfshirë respektimin e të drejtave themelore dhe kërkesat për mbrojtjen e të dhënave, udhëzime të veçanta për menaxhimin e kufirit, ekipet, duke përfshirë konsultimin e lejuar me bazat e të dhënave dhe armët e lejueshme të shërbimit, municionit dhe pajisjeve në Republikën e Shqipërisë;
- (e) përbërjen e ekipit të menaxhimit të kufirit, si dhe dislokimin e personelit/ dhe prezencës përkatëse të anëtarëve të tjerë të stafit ligjor, duke përfshirë monitoruesit e të drejtave themelore;
- (f) masat e komandës dhe kontrollit, duke përfshirë emrat dhe gradat e rojeve kufitare ose personelit tjetër përkatës të Republikës së Shqipërisë, përgjegjës për bashkëpunimin me anëtarët e ekipit dhe Agjencinë, në veçanti emrat dhe gradat e këtyre rojeve kufitare ose personelit tjetër përkatës që komandohet gjatë periudhës së caktimit dhe vendin e anëtarëve të ekipit në zinxhirin komandues;
- (g) pajisjet teknike që do të përdoren gjatë aktivitetit operacional, duke përfshirë kërkesat specifike si kushtet për përdorim, ekuipazhin e kërkuar, transportin dhe logjistikat e tjera, si edhe masat financiare;
- (h) masat e detajuara për raportimin e menjëhershëm të incidentit nga Agjencia te bordi drejtues dhe tek autoritetet përkatëse të Shteteve Anëtare pjesëmarrëse dhe të Republikës së Shqipërisë për çdo incident të hasur gjatë një aktiviteti operacional të kryer sipas kësaj Marrëveshjeje;



- (i) një skemë raportimi dhe vlerësimi që përmban standarde për raportin e vlerësimit, duke pasur parasysh mbrojtjen e të drejtave themelore dhe datën përfundimtare të dorëzimit të raportit përfundimtar të vlerësimit;
- (j) në lidhje me operacionet detare, informacion specifik mbi zbatimin e juridiksionit përkatës dhe ligjit të zbatueshëm në zonën operationale, duke përfshirë referenca ndaj ligjit kombëtar, ndërkombëtar dhe të Bashkimit Evropian dhe legjislacionin kombëtar në lidhje me interceptimin, shpëtimin në det dhe zbarkimin;
- (k) kushtet e bashkëpunimit me organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, përveç Agjencisë, vendeve të tjera të treta ose organizatave ndërkombëtare;
- (l) udhëzime të përgjithshme sesi garantohet mbrojtja e të drejtave themelore gjatë aktivitetit operacional, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimet që rrjedhin nga instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- (m) procedurat sipas të cilave personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të miturit e pashoqëruar dhe personat e tjerë në situata vulnerabël u drejtohen autoriteteve kombëtare kompetente për ndihmën e duhur;
- (n) procedurat që përcaktojnë një mekanizëm për të marrë dhe dërguar në Agjenci dhe Republikën e Shqipërisë ankesat (duke përfshirë ato të depozituara sipas nenit 8, pika 5) kundër çdo personi që merr pjesë në një aktivitet operacional, duke përfshirë rojet kufitare ose personelin tjetër përkatës në Republikën e Shqipërisë dhe anëtarët e ekipit, me pretendime për shkelje të të drejtave themelore në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre në një aktivitet operacional të Agjencisë;



- (o) marrëveshjet logjistike, duke përfshirë informacionin mbi kushtet e punës dhe mjedisin e zonave në të cilat do të zhvillohet aktiviteti operacional; dhe
 - (p) masat në lidhje me një zyrë antenash, siç përcaktohet në përputhje me Nenin 6.
4. Planin operacional dhe çdo ndryshim ose përshtatje e tij do t'i nënshtrohet marrëveshjes së Agjencisë, Republikës së Shqipërisë dhe çdo shteti anëtar fqinj me Republikën e Shqipërisë ose në kufi me zonën operationale, pas konsultimit me Shtetet Anëtare pjesëmarrëse. Agjencia do të koordinojë me Shtetet Anëtare përkatëse për të konfirmuar marrëveshjen e tyre.
5. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi operacional për qëllimet e EUROSUR-it do të bëhet në përputhje me rregullat për krijimin dhe ndarjen e përshkrimeve specifike të situatës që do të përcaktohen në planin operacional për aktivitetin operacional në fjalë.
6. Vlerësimi i aktivitetit operacional në përputhje me pikën (i) të paragrafit 3 kryhet bashkërisht nga Republika e Shqipërisë dhe Agjencia.
7. Kushtet e bashkëpunimit me organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian në përputhje me paragrafin (3) pika (k) do të kryhen në përputhje me mandatet e tyre përkatëse dhe brenda burimeve të disponueshme.

NENI 5

Raportimi i incidenteve

1. Agjencia dhe Policia e Shtetit Shqiptar do të kenë secila një mekanizëm raportimi të incidenteve për të lejuar raportimin në kohë të çdo incidenti të hasur gjatë një aktiviteti operacional të kryer sipas kësaj Marrëveshjeje.
2. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë do të ndihmojnë njëra-tjetrën në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme për çdo incident të raportuar nëpërmjet një mekanizmi të referuar në paragrafin 1 si identifikimi i dëshmitarëve dhe mbledhja dhe prodhimi i provave, duke përfshirë kërkesat e marra dhe, nëse është e nevojshme, për të dorëzuar sende/objekte që lidhen me një incident të raportuar. Dorëzimi i çdo sendi/objekti të tillë mund t'i nënshtrohet kthimit të tyre brenda afateve të përcaktuara nga autoriteti kompetent që i dorëzon ato.



NENI 6

Zyrat e antenave

1. Agjencia, në konsultim me autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, mund të krijojë zyra antenash në territorin e Republikës së Shqipërisë për të lehtësuar dhe përmirësuar koordinimin e aktiviteteve operacionale dhe për të siguruar menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike të Agjencisë. Vendndodhja e zyrës së antenës përcaktohet nga Agjencia, duke marrë parasysh marrëveshjen e Republikës së Shqipërisë.
2. Zyrat e antenave krijohen në përputhje me nevojat operacionale dhe mbeten funksionale për periudhën kohore të nevojshme që Agjencia do të kryejë aktivitet operacional në Republikën e Shqipërisë dhe në rajonin fqinj. Në bazë të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë, kjo periudhë mund të zgjatet nga Agjencia.
3. Çdo zyrë antenash do të menaxhohet nga një përfaqësues i Agjencisë i emëruar nga drejtori ekzekutiv si drejtues i zyrës së antenës, i cili do të mbikëqyrë punën e përgjithshme të zyrës.
4. Në rastet kur është e zbatueshme, zyra e antenave:
 - (a) do të sigurojë mbështetje operacionale dhe logjistike dhe do të sigurojë koordinimin e aktiviteteve të Agjencisë në zonat operacionale në fjalë;



- (b) do të sigurojë mbështetje operationale për Republikën e Shqipërisë në zonat operationale në fjalë;
- (c) do të monitorojë aktivitetet e ekipeve të menaxhimit të kufirit dhe do të raportojë rregullisht në selinë e Agjencisë;
- (d) do të bashkëpunojë me Republikën e Shqipërisë për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin praktik të aktiviteteve operationale të organizuara nga Agjencia në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë çdo çështje shtesë që mund të ketë ndodhur gjatë këtyre aktiviteteve;
- (e) do të mbështesë zyrtarin koordinues në bashkëpunimin e tij ose të saj me Republikën e Shqipërisë për të gjitha çështjet që lidhen me kontributin e tyre në aktivitetet operationale të organizuara nga Agjencia dhe, kur është e nevojshme, do të ndërlihet me selinë qendrore të Agjencisë;
- (f) do të mbështesë zyrtarin koordinues dhe monitoruesin(it) e të drejtave themelore të caktuar për të monitoruar një aktivitet operational për të lehtësuar, kur është e nevojshme, koordinimin dhe komunikimin ndërmjet ekipeve të menaxhimit të kufirit dhe autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo detyrë përkatëse;
- (g) do të organizojë mbështetjen logjistike në lidhje me dislokimin e anëtarëve të ekipit dhe vendosjen dhe përdorimin e pajisjeve teknike;
- (h) do të sigurojë të gjithë mbështetjen logjistike në lidhje me zonën operationale për të cilën është përgjegjëse një zyrë e caktuar antenash, me synimin për të lehtësuar mbarëvajtjen e aktiviteteve operationale të organizuara nga Agjencia;



- (i) do të sigurojë menaxhimin efektiv të pajisjeve të vetë Agjencisë në fushat e mbuluara nga aktivitetet e saj, duke përfshirë regjistrimin e mundshëm dhe mirëmbajtjen afatgjatë të asaj pajisjeje dhe çdo mbështetje logjistike të nevojshme; dhe
 - (j) do të mbështesë stafin dhe/ose aktivitetet e tjera të Agjencisë në Republikën e Shqipërisë, siç është rënë dakord ndërmjet Agjencisë dhe Republikës së Shqipërisë.
5. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë sigurojnë kushtet më të mira të mundshme për përmbushjen e detyrave që i janë ngarkuar zyrës së antenës.
6. Republika e Shqipërisë do t'i ofrojë Agjencisë asistencën e arsyeshme për të siguruar kapacitetin operacional të zyrës(ave) të antenës.

NENI 7

Zyrtari koordinues

1 Pa cenuar rolin e zyrave të antenës siç përshkruhet në nenin 6, drejtori ekzekutiv do të caktojë një ose më shumë ekspertë nga stafi statutor që do të dislokohen si zyrtarë koordinues për çdo aktivitet operacional. Drejtori Ekzekutiv njofton Republikën e Shqipërisë për këtë emërim.

2. Roli i zyrtarit koordinues do të jetë:

- (a) të veprojë si ndërfaqe ndërmjet Agjencisë, Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të ekipit, duke ofruar ndihmë, në emër të Agjencisë, për të gjitha çështjet që lidhen me kushtet e caktimit të ekipeve të menaxhimit të kufirit;
- (b) të monitorojë zbatimin e saktë të planit operacional, duke përfshirë bashkëpunimin me monitoruesin(it) e të drejtave themelore për sa i përket mbrojtjes së të drejtave themelore, dhe t'i raportojë drejtorit ekzekutiv për këtë;
- (c) të veprojë në emër të Agjencisë në të gjitha aspektet e caktimit të ekipeve të menaxhimit të ekipit dhe t'i raportojë Agjencisë për të gjitha ato aspekte; dhe
- (d) të nxisë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare pjesëmarrëse.

3. Në kuadër të aktiviteteve operationale, drejtori ekzekutiv mund të autorizojë zyrtarin koordinues për të ndihmuar në zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje për zbatimin e planit operacional dhe vendosjen e ekipeve.



4. Republika e Shqipërisë u jep anëtarëve të ekipit vetëm udhëzime që janë në përputhje me planin operacional. Nëse zyrtari koordinues çmon se udhëzimet e dhëna anëtarëve të ekipit nuk janë në përputhje me planin operacional ose me detyrimet ligjore në fuqi, ai ose ajo ia komunikon këtë menjëherë zyrtarëve të Republikës së Shqipërisë që kryejnë rolin koordinues dhe drejtorit ekzekutiv. Drejtori ekzekutiv mund të marrë masat e duhura, duke përfshirë pezullimin ose përfundimin e aktivitetit operacional, në përputhje me nenin 18.

NENI 8

Të drejtat themelore

1. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, Palët angazhohen të veprojnë në përputhje me të gjitha instrumentet e të drejtave të njeriut në fuqi, duke përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës të vitit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e tij të vitit 1967, Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara të vitit 1965 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1979 për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese të vitit 1984, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006 dhe Kartën Themelore të të Drejtave të Bashkimit Evropian.



2. Anëtarët e ekipit, në kryerjen e detyrave të tyre dhe në ushtrimin e kompetencave të tyre, do të respektojnë plotësisht të drejtat themelore, duke përfshirë aksesin në procedurat e azilit dhe dinjitetin njerëzor, do t'u kushtojnë vëmendje të veçantë personave vulnerabël. Çdo masë e marrë në kryerjen e detyrave të tyre dhe në ushtrimin e kompetencave të tyre do të jetë në raport me objektivat e ndjekura nga këto masa. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, ata nuk duhet të diskriminojnë personat për shkak të arsyeve si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, veçoritë gjenetike, gjuha, feja ose besimi, bindja politike ose ndonjë bindje tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha ose orientimi seksual, në përputhje me nenin 21 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Masat që ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë themelore mund të merren nga anëtarët e ekipit në kryerjen e detyrave të tyre ose në ushtrimin e kompetencave të tyre vetëm kur është e nevojshme dhe në raport me objektivat e ndjekura nga këto masa, duhet të respektojnë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore në përputhje me legjislacionin në fuqi, të Bashkimit Evropian, ndërkombëtar dhe kombëtar.

Kjo dispozitë zbatohet mutatis mutandis për të gjithë personelin e autoriteteve kombëtare të Republikës së Shqipërisë që marrin pjesë në një aktivitet operacional.

3. Zyrtari për të drejtat themelore të Agjencisë do të monitorojë përputhshmërinë e çdo aktiviteti operacional me standardet e zbatueshme të të drejtave themelore. Zyrtari i të drejtave themelore, ose zëvendësi i tij ose i saj, mund të kryejë vizita në një vend të tretë. Ai ose ajo do të japë gjithashtu opinione për planet operationale dhe do të informojë drejtorin ekzekutiv për shkeljet e mundshme të të drejtave themelore në lidhje me një aktivitet operacional. Republika e Shqipërisë do të mbështesë përpjekjet monitoruese të zyrtarit të të drejtave themelore, sipas kërkesës.



4. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë bien dakord t'i ofrojnë forumit konsultativ akses efektiv në kohë për të gjithë informacionin në lidhje me respektimin e të drejtave themelore mbi çdo aktivitet operacional të kryer sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë vizitat në vend në zona operationale.
5. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë do të kenë secila një mekanizëm ankimimi për të trajtuar pretendimet për shkelje të të drejtave themelore të kryera nga stafi i tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare gjatë një aktiviteti operacional të kryer sipas kësaj Marrëveshjeje.
6. Anëtarët e ekipit gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe ushtrimit të kompetencave të tyre sipas kësaj marrëveshjeje, do t'i raportojnë pa vonesë të panevojshme Agjencisë çdo shkelje të kodeve të sjelljes së Agjencisë. Agjencia do të informojë autoritetet përkatëse shqiptare për këto raporte pa vonesa të panevojshme nëpërmjet një mekanizmi që do të përcaktohet në planin operacional.

NENI 9

Monitoruesit e të Drejtave Themelore

1. Zyrtari për të drejtat themelore të Agjencisë do të caktojë të paktën një monitorues të të drejtave themelore për çdo aktivitet operativ, ndër të tjera, të ndihmojë dhe këshillojë zyrtarin koordinues.



2. Monitoruesi i të drejtave themelore monitoron respektimin e të drejtave themelore dhe ofron këshilla dhe ndihmë për të drejtat themelore në përgatitjen, kryerjen dhe vlerësimin e aktivitetit përkatës operacional. Kjo do të përfshijë, në veçanti:

- (a) ndjekjen e përgatitjes së planeve operationale dhe raportimin te zyrtari i të drejtave themelore, për t'i mundësuar atij ose asaj të përmbushë detyrat e tij ose të saj siç parashikohet në Rregulloren (BE) 2019/1896;
- (b) kryerjen e vizitave, duke përfshirë vizitat afatgjata, ku zhvillohen aktivitete operationale;
- (c) bashkëpunimin, ndërlidhjen me zyrtarin koordinues dhe ofrimin e këshillave dhe ndihmës për të;
- (d) informimin e zyrtarit koordinues dhe raportimin tek zyrtari për të drejtat themelore për çdo shqetësim në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave themelore mbi aktivitetin operacional; dhe
- (e) kontributin në vlerësimin e aktivitetit operacional siç përmendet në nenin 4 (3) pika (i).

3. Monitoruesit e të drejtave themelore duhet të kenë akses në të gjitha fushat ku zhvillohet aktiviteti operacional dhe në të gjitha dokumentet kyçe për zbatimin e atij aktiviteti.

4. Ndërsa janë të pranishëm në zonën operationale, monitoruesit e të drejtave themelore duhet të mbajnë distinktivë që lejojnë qartë identifikimin e tyre si monitorues të të drejtave themelore.



NENI 10

Anëtarët e Ekipit

1. Anëtarët e ekipit do të kenë autoritetin për të kryer detyrat e përshkruara në planin operacional.
2. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, anëtarët e ekipit duhet të respektojnë ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin në fuqi ndërkombëtar dhe atë të Bashkimit Evropian.
3. Anëtarët e ekipit mund të kryejnë detyra dhe të ushtrojnë kompetenca në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm sipas udhëzimeve dhe në prani të autoriteteve të menaxhimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë anëtarët e ekipit për të kryer detyra specifike dhe për të ushtruar kompetenca specifike në territorin e saj në mungesë të autoriteteve të saj të menaxhimit të kufirit, me miratimin e Agjencisë ose të Shtetit Anëtar të origjinës, sipas rastit.
4. Anëtarët e ekipit, të cilët janë staf statutor, do të veshin uniformën e Trupës Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në planin operacional.

Anëtarët e ekipit që nuk janë staf statutor do të veshin uniformën e tyre kombëtare gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në planin operacional.

Gjatë detyrës, të gjithë anëtarët e ekipit duhet të mbajnë gjithashtu një identifikim personal të dukshëm dhe një shirit blu me shenjat e Bashkimit Evropian dhe të Agjencisë në uniformat e tyre.



5. Republika e Shqipërisë autorizon anëtarët përkatës të ekipit për të kryer detyra gjatë një aktiviteti operacional që kërkon përdorimin e forcës, duke përfshirë mbajtjen dhe përdorimin e armëve të shërbimit, municioneve dhe mjete të tjera shtrënguese, në përputhje me dispozitat përkatëse të planit operacional.

- (a) Anëtarët e ekipit të cilët janë staf statutor mund të mbajnë dhe përdorin armë shërbimi, municione dhe mjete të tjera shtrënguese, me pëlqimin e Agjencisë.
- (b) Anëtarët e ekipit që nuk janë staf statutor mund të mbajnë dhe përdorin armë shërbimi, municione dhe mjete të tjera shtrënguese, në bazë të pëlqimit të shtetit anëtar përkatës të origjinës.

6. Përdorimi i forcës, duke përfshirë mbajtjen dhe përdorimin e armëve të shërbimit, municionit dhe mjeteve të tjera shtrënguese, do të ushtrohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë dhe në prani të autoriteteve të menaxhimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë anëtarët e ekipit për të përdorur forcën në mungesë të autoriteteve përkatëse të menaxhimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

- a) Për anëtarët e ekipit që janë staf statutor, një autorizim i tillë për të përdorur forcën në mungesë të autoriteteve të menaxhimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë do të jetë objekt i pëlqimit të Agjencisë.
- b) Për anëtarët e ekipit që nuk janë staf statutor, një autorizim i tillë për të përdorur forcën në mungesë të autoriteteve të menaxhimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë, do të jetë objekt i pëlqimit të Shtetit Anëtar të origjinës.



Çdo përdorim i forcës nga anëtarët e ekipit duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional dhe të jetë plotësisht në përputhje me ligjin e zbatueshëm ndërkombëtar, të Bashkimit Evropian, dhe kombëtar, duke përfshirë, në veçanti, kërkesat e përcaktuara në Shtojcën V të Rregullores (BE) 2019/1896.

7. Agjencia, përpara dislokimit të anëtarëve të ekipit, informon Republikën e Shqipërisë për armët e shërbimit, municionet dhe pajisjet e tjera që anëtarët e ekipit mund të mbajnë sipas pikës 5. Republika e Shqipërisë mund të ndalojë mbajtjen e disa armëve të shërbimit, municioneve dhe pajisjeve të tjera, me kusht që ligji i saj të zbatojë të njëjtin ndalim për autoritetet e veta të menaxhimit të kufirit. Republika e Shqipërisë, përpara dislokimit të anëtarëve të ekipit, informon Agjencinë për armët, municionet dhe pajisjet e lejuara të shërbimit dhe për kushtet e përdorimit të tyre. Agjencia e vë këtë informacion në dispozicion të Shteteve Anëtare.

Republika e Shqipërisë do të marrë masat e nevojshme për lëshimin e çdo lejeje të nevojshme për armë dhe do të lehtësojë importin, eksportin, transportin dhe ruajtjen e armëve, municioneve dhe pajisjeve të tjera në dispozicion të anëtarëve të ekipit, siç kërkohet nga Agjencia. Procedura për dhënien e lejeve të armës do të përcaktohet në planin operacional.

8. Armët e shërbimit, municionet dhe pajisjet mund të përdoren për vetëmbrojtje legjitime dhe në mbrojtje legjitime të anëtarëve të ekipit ose të personave të tjerë në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve përkatëse të legjislacionit ndërkombëtar dhe atij të Bashkimit Evropian.



9. Republika e Shqipërisë mund të autorizojë anëtarët e ekipit të konsultojnë bazat e saj kombëtare të të dhënave, nëse është e nevojshme për përmbushjen e synimeve operacionale të përcaktuara në planin operacional. Republika e Shqipërisë garanton që ajo të sigurojë akses të tillë në bazën e të dhënave në mënyrë efikase dhe efektive.

Republika e Shqipërisë, përpara dislokimit të anëtarëve të ekipit, informon Agjencinë për bazat kombëtare të të dhënave që mund të konsultohen.

Anëtarët e ekipit duhet të konsultojnë vetëm të dhënat e nevojshme për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre. Ky konsultim do të kryhet në përputhje me ligjin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave të Republikës së Shqipërisë dhe këtë Marrëveshje.

10. Për zbatimin e aktiviteteve operacionale, Republika e Shqipërisë do të vendosë oficerë të Departamentit të Policisë së Kufirit dhe Migracionit, të cilët janë të aftë dhe të gatshëm të komunikojnë në gjuhën angleze për të kryer një rol koordinues në emër të Republikës së Shqipërisë.

NENI 11

Privilegjet dhe imunitetet e pronës, fondet,
pasuria dhe operacionet e Agjencisë

1. Çdo ambient dhe godinë e Agjencisë në Republikën e Shqipërisë është i paprekshëm. Ata do të përjashtohen nga kontrolli, rekuizimi, konfiskimi ose shpronësimi.



2. Pronat dhe asetet e Agjencisë, duke përfshirë mjetet e transportit, komunikimet, arkivat, çdo korrespondencë, dokumente, dokumente identiteti dhe pasuri financiare, janë të paprekshme.
3. Asetet e Agjencisë përfshijnë asete në pronësi, në bashkëpronësi, të marra me qira ose të dhëna me qira nga një shtet anëtar dhe që i ofrohen Agjencisë. Me hyrjen e përfaqësuesve të autoriteteve kombëtare kompetente, ato do të trajtohen si asete që janë në shërbimin e qeverisë dhe të autorizuar për këtë qëllim.
4. Asnjë masë përmbartimore nuk mund të merret në lidhje me Agjencinë. Pasuria dhe asetet e Agjencisë nuk do të jenë objekt i asnjë mase kufizimi administrativ ose ligjor. Pasuria e Agjencisë është e lirë nga sekuestrimi për plotësimin e aktgjykimit, vendimit ose urdhrit.
5. Republika e Shqipërisë do të lejojë hyrjen dhe heqjen e artikujve dhe pajisjeve të vendosura nga Agjencia në Republikën e Shqipërisë për qëllime operacionale.
6. Agjencia do të përjashtohet nga të gjitha detyrimet (duke përfshirë detyrimet doganore) dhe taksat, si dhe nga çdo ndalim dhe kufizim mbi importet dhe eksportet në lidhje me artikujt dhe pajisjet e synuara për përdorimin e saj zyrtar, duke përfshirë artikujt dhe pajisjet e importuara ose eksportuara nga një palë e tretë në emër të Agjencisë.

NENI 12

Privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të ekipit

1. Anëtarët e ekipit nuk do t'i nënshtrohen asnjë forme hetimi ose procedimi ligjor në Republikën e Shqipërisë ose nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rrethanave të përmendura në pikën 2 të këtij neni.
2. Anëtarët e ekipit gëzojnë imunitet nga juridiksioni penal, civil dhe administrativ i Republikës së Shqipërisë për të gjitha veprimet e kryera prej tyre në ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare, gjatë veprimeve të kryera në përputhje me planin operacional.

Kur autoritetet e Republikës së Shqipërisë synojnë të paraqesin procedime penale, civile ose administrative kundër një anëtari të ekipit përpara çdo gjykate të Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente njoftojnë menjëherë drejtorin ekzekutiv për këtë qëllim.

Pas marrjes së një njoftimi të tillë, drejtori ekzekutiv informon pa vonesa të panevojshme autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nëse akti në fjalë është kryer nga anëtari i ekipit në ushtrimin e funksioneve të tij zyrtare. Nëse akti është deklaruar i kryer gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare, procedimi nuk fillon. Nëse akti është deklaruar se nuk është kryer gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare, procedimi mund të fillohet. Kualifikimet nga drejtori ekzekutiv janë të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, e cila nuk mund ta kundërshtojë atë.



Në pritje të këtij kualifikimi, Agjencia do të përmbahet nga marrja e çdo mase që synon të rrezikojë ndjekjen penale të mundshme të mëvonshme të anëtarit të ekipit nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë lehtësimin e kthimit të anëtarit të ekipit përkatës nga Republika e Shqipërisë në Shtetin e tyre Anëtar të origjinës.

Privilegjet që u jepen anëtarëve të ekipit dhe imuniteti nga juridiksioni penal i Republikës së Shqipërisë nuk i përjashtojnë ata nga juridiksioni i shtetit anëtar të origjinës.

Fillimi i procedimit nga anëtarët e ekipit do t'i parandalojë ata të kërkojnë imunitet nga juridiksioni lidhur me çdo lloj kundërpretendimi të lidhur drejtpërdrejt me pretendimin kryesor.

3. Aktet e anëtarëve të ekipit që konsiderohen të jenë me rëndësi disiplinore, mund të referohen nga autoritetet shqiptare për Agjencinë.

4. Ambientet, banesat, mjetet e transportit dhe komunikimit, si dhe pasuritë, duke përfshirë çdo korrespondencë, dokument, dokument identiteti dhe pasuri të anëtarëve të ekipit, janë të paprekshme, me përjashtim të rasteve të masave të ekzekutimit të lejuara sipas paragrafit 8.

5. Republika e Shqipërisë është përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar nga anëtarët e ekipit ndaj palëve të treta gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

6. Në rast dëmi të shkaktuar nga pakujdesia e rëndë ose sjellje të papërshtatshme me dashje ose jo në ushtrimin e funksioneve zyrtare nga një anëtar i ekipit që është anëtar i personelit ligjor, Republika e Shqipërisë mund të kërkojë, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, që të paguhet kompensimi nga Agjencia.



Në rast dëmi të shkaktuar nga pakujdesia e rëndë ose shkelje të qëllimshme ose jo në ushtrimin e funksioneve zyrtare nga një anëtar ekipi që nuk është anëtar i personelit ligjor, Republika e Shqipërisë mund të kërkojë, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, që kompensimi të paguhet nga shteti anëtar në fjalë.

7. Anëtarët e ekipit nuk janë të detyruar të dëshmojnë si dëshmitarë në proceset gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

8. Asnjë masë ekzekutimi nuk mund të merret për anëtarët e ekipit, me përjashtim të rastit kur ndaj tyre niset procedim penal, civil ose administrativ që nuk lidhet me funksionet e tyre zyrtare. Pasuria e anëtarëve të ekipit, e cila vërtetohet nga drejtori ekzekutiv si e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare, do të përjashtohet nga sekuestrimi me aktgjykim, vendim ose urdhër.

Në procedimet penale, anëtarët e ekipit nuk do t'i nënshtrohen asnjë kufizimi në lirinë e tyre personale ose ndonjë mase tjetër shtrënguese, në pritje të kualifikimit nga drejtori ekzekutiv nëse veprimi në fjalë është kryer nga anëtar i ekipit në ushtrimin e funksionit të tij/të saj zyrtar.

Në procedimet civile, anëtarët e ekipit nuk do t'i nënshtrohen asnjë kufizimi në lirinë e tyre personale ose masave të tjera shtrënguese.

Në procedimet administrative, drejtori ekzekutiv informohet menjëherë nga Republika e Shqipërisë për çdo kufizim të lirisë personale ose çdo masë tjetër shtrënguese të marrë ndaj anëtarëve të ekipit.



9. Anëtarët e ekipit, për shërbimet e kryera për Agjencinë, përjashtohen nga dispozitat e sigurimeve shoqërore që mund të jenë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
10. Paga dhe shpërblimet e paguara për anëtarët e ekipit nga Agjencia dhe/ose Shtetet Anëtare të origjinës, si dhe çdo anëtar i ekipit me të ardhura që marrin nga jashtë Republikës së Shqipërisë, nuk tatohen në asnjë formë në Republikën e Shqipërisë.
11. Republika e Shqipërisë do të lejojë hyrjen e artikujve për përdorim personal të anëtarëve të ekipit dhe do të lirojë nga të gjitha detyrimet doganore, taksat dhe tarifatat përkatëse, përveç tarifave për magazinimin, transportin dhe shërbime të ngjashme, në lidhje me artikuj të tillë. Republika e Shqipërisë do të lejojë gjithashtu eksportin e këtyre artikujve.
12. Bagazhet personale të anëtarëve të ekipit do të përjashtohen nga inspektimi, vetëm nëse ka arsye serioze për të dyshuar se përmbajnë artikuj që nuk janë për përdorim personal të anëtarëve të ekipit, ose artikuj importi ose eksporti i të cilëve është i ndaluar me ligj ose i nënshtrohet karantinës me rregulloret e Republikës së Shqipërisë. Inspektimi i bagazheve të tilla personale do të kryhet vetëm në prani të anëtarëve të ekipit përkatës ose një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë.
13. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë caktojnë pika kontakti të disponueshme në çdo kohë, të cilat do të jenë përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit dhe veprimet e menjëhershme që duhen ndërmarrë në rast se një veprim i kryer nga një anëtar i ekipit mund të jetë në kundërshtim me kodin penal, si dhe për shkëmbimin e informacionit dhe aktivitetet operationale në lidhje me çdo procedim civil dhe administrativ kundër një anëtari të ekipit.



Derisa të merren masa nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, Agjencia dhe Republika e Shqipërisë do të ndihmojnë njëra-tjetrën në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme për çdo vepër penale të dyshuar në lidhje me të cilën Agjencia ose Republika e Shqipërisë ose të dyja kanë interes, në identifikimin e dëshmitarëve dhe në mbledhjen dhe prodhimin e provave, duke përfshirë kërkesën për marrjen dhe, nëse është e nevojshme, dorëzimin e artikujve që lidhen me një vepër penale të supozuar. Dorëzimi i çdo artikulli të tillë mund t'i nënshtrohet kthimit të tyre brenda afateve të përcaktuara nga autoriteti kompetent që i dorëzon ato.

NENI 13

Anëtarët e ekipit të lënduar ose të vdekur

1. Pa cenuar nenin 12, drejtori ekzekutiv ka të drejtë të marrë përsipër dhe të marrë masat e duhura për riatdhesimin e çdo anëtari të ekipit të lënduar ose të vdekur, si dhe të pronës së tyre personale.
2. Një autopsi do të kryhet mbi një anëtar të vdekur të ekipit vetëm me pëlqimin e shprehur të Shtetit Anëtar të origjinës në fjalë dhe në prani të një përfaqësuesi të Agjencisë ose të Shtetit Anëtar të origjinës.
3. Republika e Shqipërisë dhe Agjencia do të bashkëpunojnë në masën më të plotë të mundshme për të mundësuar riatdhesimin e shpejtë të anëtarëve të ekipit të lënduar ose të vdekur.



NENI 14

Dokumenti i akreditimit

1. Agjencia do t'i lëshojë çdo anëtar të ekipit një dokument në shqip dhe anglisht për qëllime identifikimi kundrejt autoriteteve kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe si dëshmi të të drejtave të mbajtësit për të kryer detyrat dhe për të ushtruar kompetencat e përmendura në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje dhe në planin operacional ("dokumenti i akreditimit").
2. Dokumenti i akreditimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm për anëtarin e personelit: emrin dhe kombësinë, gradën ose titullin e punës, një fotografi të dixhitalizuar së fundi dhe detyrat e autorizuar për t'u kryer gjatë dislokimit.
3. Për qëllime identifikimi kundrejt autoriteteve kombëtare të Republikës së Shqipërisë, anëtarët e ekipit janë të detyruar ta mbajnë me vete dokumentin personal të akreditimit gjatë gjithë kohës.
4. Republika e Shqipërisë do të njohë dokumentin e akreditimit, në kombinim me një dokument udhëtimi të vlefshëm. Ky dokument i garanton anëtarit të ekipit përkatës, personelit të dislokuar në Republikën e Shqipërisë sipas kësaj marrëveshjeje ose një plani operacional në bazë të saj, hyrjen dhe qëndrimin në Republikën e Shqipëria pa pasur nevojë për vizë, autorizim paraprak apo ndonjë dokument tjetër deri në ditën e skadimit të saj.
5. Dokumenti i akreditimit i kthehet Agjencisë në fund të dislokimit. Për këtë informohen autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.



NENI 15

Aplikimi për stafin e Agjencisë që nuk është dislokuar si anëtar i ekipit

Nenet 12, 13 dhe 14 do të zbatohen mutatis mutandis për të gjithë personelin e Agjencisë të dislokuar në Republikën e Shqipërisë sipas kësaj marrëveshjeje ose të një plani operacional në bazë të saj, të cilët nuk janë anëtarë të ekipit, duke përfshirë monitoruesit e të drejtave themelore dhe stafin statutor të dislokuar në zyrat e antenave.

NENI 16

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Komunikimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm nëse një komunikim i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose Agjencia. Përpunimi i të dhënave personale nga një autoritet në një rast të veçantë, duke përfshirë transferimin e këtyre të dhënave personale te Pala tjetër, do t'i nënshtrohet rregullave të mbrojtjes së të dhënave të zbatueshme për atë autoritet. Palët do të sigurojnë garancitë minimale të mëposhtme si parakusht për çdo transferim të dhënave:

- (a) të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe në mënyrë transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;



- (b) të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllimin e specifikuar, të qartë dhe legjitim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të mos përpunohen më tej nga autoriteti komunikues apo autoriteti marrës në një mënyrë të papajtueshme me atë qëllim;
- (c) të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme në lidhje me qëllimin për të cilin mblidhen ose përpunohen më tej. Në veçanti, të dhënat personale të komunikuara në përputhje me ligjin e zbatueshëm për autoritetin komunikues mund të lidhen vetëm me një ose më shumë nga sa vijon:
- Emri;
 - Mbiemri;
 - Data e lindjes;
 - Kombësia;
 - Grada;
 - Dokumentit i udhëtimit, faqja e të dhënave;
 - Dokumenti i akreditimit;
 - Foto e dokumentit të identitetit ID/pasaportës/akreditimit;



- Adresa e postës elektronike;
- Numri i telefonit celular;
- Detajet e armës;
- Kohëzgjatja e dislokimit;
- Vendndodhja e dislokimit;
- Numrat e identifikimit të avionëve ose anijeve;
- Data e mbërritjes;
- Aeroporti i mbërritjes/pika e kalimit kufitar;
- Numri i fluturimit të mbërritjes;
- Data e nisjes;
- Aeroporti i nisjes/pika e kalimit kufitar;
- Numri i fluturimit të nisjes;
- Shteti Anëtar/vendi i tretë;



- Autoriteti i dislokimit;
- Detyrat/profili operacional;
- Mjetet e transportit;
- Itinerari

të anëtarëve të ekipit, stafit të Agjencisë, vëzhguesve përkatës ose anëtarëve të programeve të shkëmbimit të stafit;

- (d) të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësohen;
- (e) të dhënat personale duhet të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur të dhënat ose për të cilin përpunohen më tej;
- (f) të dhënat personale duhet të përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale, duke marrë parasysh rreziqet specifike të përpunimit, duke përfshirë mbrojtjen kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur teknika të përshtatshme, masat organizative (cenim i të dhënave personale). Pala pritëse do të marrë masat e duhura për të adresuar çdo cenim të të dhënave dhe do të njoftojë Palën që komunikon për një shkelje të tillë pa vonesë të panevojshme dhe brenda 72 orëve;



- (g) si autoriteti komunikues ashtu edhe autoriteti marrës do të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të siguruar pa vonesë korrigjimin ose fshirjen, sipas rastit, të të dhënave personale kur përpunimi nuk është në përputhje me këtë nen. Në veçanti, për shkak se ato të dhëna nuk janë të përshtatshme, relevante ose të sakta ose sepse janë të tepërta në lidhje me qëllimin e përpunimit, kjo përfshin njoftimin për çdo korrigjim ose fshirje të Palës tjetër;
- (h) sipas kërkesës, autoriteti marrës do të informojë autoritetin komunikues për përdorimin e të dhënave të komunikuar;
- (i) të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente të mëposhtme:

- Agjencia, dhe
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin,

Komunikimi i mëtejshëm me organet e tjera kërkon autorizimin paraprak të autoritetit komunikues;

- (j) autoritetet komunikuese dhe marrëse janë të detyruara të përgatisin një procesverbal me shkrim të komunikimit dhe marrjes së të dhënave personale;
- (k) do të ekzistojë mbikëqyrja e pavarur për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me mbrojtjen e të dhënave, duke përfshirë inspektimin e të dhënave të tilla; subjektet e të dhënave kanë të drejtë të paraqesin ankesa në organin mbikëqyrës dhe të marrin përgjigje pa vonesa të panevojshme;
- (l) subjektet e të dhënave do të kenë të drejtën të marrin informacion mbi përpunimin e të dhënave të tyre personale, aksesin në këto të dhëna dhe korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të pasakta ose të përpunuara në mënyrë të paligjshme, në bazë të kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale për arsye të rëndësishme të interesit publik; dhe
- (m) subjektet e të dhënave do të kenë të drejtën për kompensim efektiv administrativ dhe gjyqësor për shkeljen e masave mbrojtëse të lartpërmendura.

2. Çdo Palë do të kryejë rishikime periodike të politikave dhe procedurave të veta që zbatojnë këtë nen. Me kërkesë të Palës tjetër, Pala që ka marrë kërkesën do të rishikojë politikat dhe procedurat e saj të përpunimit të të dhënave personale për të vërtetuar dhe konfirmuar se masat mbrojtëse në këtë nen janë zbatuar në mënyrë efektive. Rezultatet e rishikimit do t'i komunikohen Palës që ka kërkuar rishikimin brenda një kohe të arsyeshme.

3. Masat e mbrojtjes së të dhënave sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë.



4. Palët do të bashkëpunojnë me Mbikëqyrësin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave, si autoritet mbikëqyrës i Agjencisë.
5. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë hartojnë një raport të përbashkët për zbatimin e këtij neni në përfundim të çdo aktiviteti operacional. Ky raport i dërgohet zyrtarit të të drejtave themelore të Agjencisë dhe zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave, si dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
6. Agjencia dhe Republika e Shqipërisë do të përcaktojnë rregulla të detajuara për komunikimin dhe përpunimin e të dhënave personale për qëllime të aktiviteteve operationale sipas kësaj Marrëveshjeje në dispozita të veçanta të planeve operationale përkatëse. Këto dispozita duhet të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse të ligjit të Bashkimit Evropian dhe ligjit të Republikës së Shqipërisë. Ato do të përshkruajnë, ndër të tjera, qëllimin e komunikimit, kontrolluesin(it) dhe të gjitha rolet dhe përgjegjësitë, kategoritë e të dhënave të komunikuar, periudhat specifike të ruajtjes së të dhënave dhe të gjitha masat mbrojtëse minimale. Në interes të transparencës dhe parashikueshmërisë, këto dispozita do të vihen në dispozicion të publikut në përputhje me udhëzimet përkatëse të Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave.



NENI 17

Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar dhe sensitiv të paklasifikuar

1. Çdo shkëmbim ose përhapje e informacionit të klasifikuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të mbulohet nga një marrëveshje e veçantë administrative e lidhur ndërmjet Agjencisë dhe autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë, e cila do t'i nënshtrohet miratimit paraprak të Komisionit Evropian.
2. Çdo shkëmbim i informacionit sensitiv të paklasifikuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje:
 - (a) do të trajtohet nga Agjencia në përputhje me nenin 9(5) të Vendimit të Komisionit (BE, Euratom) 2015/443¹;
 - (b) do të marrë një nivel mbrojtjeje nga Pala pritëse që është ekuivalent me nivelin e mbrojtjes të ofruar nga masat e zbatuara ndaj atij informacioni nga Pala që komunikon për sa i përket konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë; dhe
 - (c) do të kryhet nëpërmjet një sistemi shkëmbimi informacioni që plotëson kriteret e disponueshmërisë, konfidencialitetit dhe integritetit për informacione sensitive të paklasifikuara, siç është rrjeti i komunikimit i përmendur në nenin 14 të Rregullores (BE) 2019/1896.
3. Palët do të respektojnë të drejtat e pronësisë intelektuale në lidhje me çdo të dhënë të përpunuar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

¹ Vendimi i Komisionit (BE, Euratom) 2015/443 , datë 13 mars 2015 mbi Sigurinë në Komision (FZ BE L 72, 17.3.2015, fq. 41).



NENI 18

Vendimi për pezullimin, ndërprerjen dhe/ose tërheqjen e
financimit për një aktivitet operacional

1. Nëse kushtet për të kryer një aktivitet operacional nuk plotësohen më, drejtori ekzekutiv e ndërpret atë aktivitet operacional pasi të ketë informuar me shkrim Republikën e Shqipërisë.
2. Nëse kjo Marrëveshje ose një plan operacional nuk është respektuar nga Republika e Shqipërisë, drejtori ekzekutiv mund të tërheqë financimin e aktivitetit përkatës operacional dhe/ose ta pezullojë ose përfundojë atë, pasi të ketë informuar me shkrim Republikën e Shqipërisë.
3. Nëse nuk mund të garantohet siguria e ndonjë pjesëmarrësi të një aktiviteti operacional të dislokuar në Republikën e Shqipërisë, drejtori ekzekutiv mund të pezullojë ose ndërpresë aktivitetin ose aspektet përkatëse operationale.
4. Nëse drejtori ekzekutiv çmon se shkelje të të drejtave themelore ose detyrimeve të mbrojtjes ndërkombëtare që janë të një natyre serioze ose mund të vazhdojnë, kanë ndodhur ose mund të ndodhin në lidhje me një aktivitet operacional të kryer sipas kësaj Marrëveshjeje, ai ose ajo e tërheq financimin e aktivitetit operacional përkatës dhe/ose e pezullon ose ndërpret atë, pasi të ketë vënë në dijeni Republikën e Shqipërisë.
5. Republika e Shqipërisë mund t'i kërkojë drejtorit ekzekutiv pezullimin ose përfundimin e një aktiviteti operacional. Një kërkesë e tillë do të bëhet me shkrim dhe do të përfshijë arsyet për këtë qëllim.



6. Pezullimi, përfundimi ose tërheqja e financimit sipas këtij neni hyn në fuqi nga data e njoftimit në Republikën e Shqipërisë. Ai nuk do të ndikojë në asnjë të drejtë ose detyrim që rrjedh nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ose plani operacional përpara një pezullimi, përfundimi ose tërheqjeje të financimit.

7. Republika e Shqipërisë mund të kërkojë ndërprerjen e caktimit të çdo anëtari të ekipit ose personelit tjetër të dislokuar në Republikën e Shqipërisë sipas kësaj marrëveshjeje ose të një plani operacional sipas saj, i cili nuk respekton këtë Marrëveshje ose planin operacional ose që kryen shkelje të rënda të legjislacionit shqiptar. Vendimi për përfundimin e dislokimit do të merret nga drejtori ekzekutiv ose shteti anëtar përkatës i origjinës sipas rastit dhe do t'u njoftohet autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

NENI 19

Luftimi i mashtrimit

1. Republika e Shqipërisë do të njoftojë menjëherë Agjencinë, Prokurorinë Publike Evropiane dhe/ose Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit nëse merr dijeni për ekzistencën e pretendimeve të besueshme për mashtrim, korrupsion ose çdo aktivitet tjetër të paligjshëm që mund të cenojë interesat e Bashkimit Evropian.

2. Kur këto pretendime lidhen me fondet e Bashkimit Evropian të disbursuara në lidhje me këtë Marrëveshje, Republika e Shqipërisë do t'i ofrojë të gjithë ndihmën e nevojshme Prokurorisë Publike Evropiane dhe/ose Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit në lidhje me aktivitetet hetimore në territorin e saj, duke përfshirë lehtësimin e intervistave, kontrollet dhe inspektimet në vend (duke përfshirë aksesin në sistemet e informacionit dhe bazat e të dhënave në Republikën e Shqipërisë). Do të lehtësojë aksesin në çdo informacion përkatës në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të çështjeve të financuara pjesërisht ose tërësisht nga Bashkimi Evropian.

NENI 20

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje

1. Për Republikën e Shqipërisë, kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Ministria e Brendshme.
2. Për Bashkimin Evropian, kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Agjencia.



NENI 21

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të shqyrtohet bashkërisht nga përfaqësues të Agjencisë dhe autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.
2. Nëse nuk arrihen zgjidhje paraprake, mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen ekskluzivisht me negociata ndërmjet Palëve.

NENI 22

Hyrja në fuqi, zbatimi i përkohshëm, ndryshimi, kohëzgjatja,
pezullimi dhe përfundimi i Marrëveshjes dhe përfundimi i Marrëveshjes paraardhëse

1. Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit nga Palët, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme ligjore. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të nevojshme për këtë qëllim.
2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore në përputhje me paragrafin 1.

Në pritje të përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi, kjo Marrëveshje mund të zbatohet mbi baza provizore, që nga data e njoftimit të përfundimit të procedurave të brendshme nga Palët për këtë qëllim.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve.
4. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar. Ajo mund të pezullohet ose ndërpritet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve ose në mënyrë të njëanshme nga secila palë.

Në rast të një pezullimi ose përfundimi të njëanshëm, Pala që dëshiron të pezullojë ose përfundojë Marrëveshjen, do të njoftojë Palën tjetër me shkrim. Përfundimi ose pezullimi i njëanshëm i kësaj Marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas muajit gjatë të cilit është dhënë njoftimi.

5. Marrëveshja Statusore ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për veprimet e kryera nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë, e nënshkruar në Tiranë më 5 tetor 2018, shfuqizohet dhe zëvendësohet me këtë Marrëveshje.



Çdo aktivitet operacional i nisur në bazë të Marrëveshjes Statusore ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për veprimet e kryera nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë, e nënshkruar në Tiranë më 5 tetor 2018, që janë në vazhdim nga koha e zbatimit të përkohshëm ose e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, mund të vazhdojë, duke iu nënshtruar ndryshimit ose përshtatjes së planit operacional përkatës në përputhje me këtë Marrëveshje.

6. Njoftimet e bëra në përputhje me këtë nen i dërgohen, në rastin e Bashkimit Evropian, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe, në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bërë në dy kopje në gjuhën shqipe, bullgare, kroate, çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, frënge, gjermane, greke, hungareze, irlandeze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, rumune, sllovake, sllovene, spanjolle dhe suedeze, ku secili prej këtyre teksteve është njëllë autentiq.

Në dëshmi të kësaj, Fuqiplotët e nënshkruar, të autorizuar sipas rregullave për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

DEKRET**Nr. 41, datë 6.2.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 2/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për aktivitetet operationale të kryera nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 3/2024**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË
14.12.2023, “PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË LIGJIN NR. 84/2022, ‘PËR
BUXHETIN E VITIT 2023’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 14.12.2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”, të ndryshuar.

Miraturar në datën 25.1.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 46, datë 7.2.2024, të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**DEKRET**
Nr. 46, datë 7.2.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 3/2024, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 14.12.2023, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022, ‘Për buxhetin e vitit 2023’”, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 4/2024

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË
14.12.2023, “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 29/2023,
‘PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT’”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 14.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar.

Miraturar në datën 25.1.2024.

Shpallur me dekretin nr. 42, datë 6.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 42, datë 6.2.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 4/2024, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 14.12.2023, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 29/2023, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 5/2024

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8, DATË
28.12.2023, “PËR MARRJEN E MASAVE
URGJENTE PËR MBROJTJEN
DHE PËRMIRËSIMIN E
INFRASTRUKTURËS PËR TRAJTIMIN E
UJËRAVE TË NDOTURA QË
SHKARKOHEN PRANË OSE
NË UJËRA LARËSE”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.

Miraturar në datën 25.1.2024.

Shpallur me dekretin nr. 43, datë 6.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET****Nr. 43, datë 6.2.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 5/2024, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 28.12.2023, ‘Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse””.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ**Nr. 7/2024****PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR.
115/2017, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË DIASPORËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:**Neni 1**

Ligji nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 2**Dispozita kalimtare dhe të fundit**

1. Funksionet, kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara për Agjencinë Kombëtare të Diasporës do të vijnë në kryhen nga kjo agjenci deri në krijimin/organizimin e institucionit/strukturës përkatëse përgjegjëse për to.

¹ Ky udhëzim përaftron pjesërisht vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2018/1986, i datës 13 dhjetor 2018, për krijimin e programeve specifike të kontrollit dhe inspektimit për forma të Faqe | 2668

2. Nëpunësit civilë aktualë, punonjësit aktualë marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Agjencisë Kombëtare të Diasporës trajtohen përkatësisht sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe Kodit të Punës në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

Neni 3**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.1.2024.

Shpallur me dekretin nr. 47, datë 7.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 47, datë 7.2.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 7/2024, “Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017, ‘Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës’, të ndryshuar”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM**Nr. 2, datë 30.1.2024****PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË
KONTROLLIT DHE INSPEKTIMIT TË
DISA FORMAVE TË PESHKIMIT¹**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe shkronjës “h”, pika 4, të kreut III, të vendimit nr. 826, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe

caktuara peshkimi dhe shfuqizimin e vendimeve zbatuese 2012/807/BE, 2013/328/EU, 20514/EU, 205013/EU.



funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton programe kontrolli dhe inspektimi për ato forma peshkimi që shfrytëzojnë:

a) rezervat peshkore ose speciet e përfshira në planet shumëvjeçare të përmendura në pikat 2-10, të vendimit nr. 283, datë 29.4.2022, “Për masat menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore dhe përfshirjen e institucioneve në marrjen dhe zbatimin e tyre”;

b) specie për të cilat është përcaktuar një detyrim zbarkimi në përputhje me shkronjën “dh” të pikës 3, të vendimit nr. 283, datë 29.4.2022, “Për masat menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore dhe përfshirjen e institucioneve në marrjen dhe zbatimin e tyre”;

c) rezerva peshkore ose specie që u nënshtrohen masave të ruajtjes dhe menaxhimit të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, siç përcaktohet në shtojcën I, të këtij udhëzimi.

2. Programet e kontrollit dhe inspektimit, që përcaktohen në shtojcën I, zbatohen nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në vijim “DSHPA”.

3. Programet e kontrollit dhe inspektimit mbulojnë:

a) aktivitetet e peshkimit;

b) aktivitetet e lidhura me peshkimin, duke përfshirë peshimin, përpunimin, tregtimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve të peshkimit;

c) importin direkt dhe indirekt të produkteve të peshkimit;

d) eksportin dhe rieksporin e produkteve të peshkimit;

e) peshkimin çlodhës argëtues;

f) masat emergjente në rast të një kërcënimi serioz ndaj burimeve të gjalla ujore.

4. Programet e kontrollit dhe inspektimit sigurojnë një zbatim uniform dhe efektiv të masave të ruajtjes dhe kontrollit për rezervat dhe format kryesore të peshkimit, të parashikuara në shtojcën I.

5. Aktivitetet e kontrollit dhe inspektimit synojnë në veçanti:

a) menaxhimin e sforcove të peshkimit dhe çdo kusht specifik që lidhet me to, duke përfshirë monitorimin e shfrytëzimit të kuotave, sforcon e

peshkimit dhe masat teknike të zbatuara në zonat në fjalë;

b) detyrimet e raportimit të aktiviteteve të peshkimit, në veçanti, saktësinë e informacionit të regjistruar dhe raportuar;

c) detyrimin për të zbarkuar të gjitha zëniet e specieve që i nënshtrohen detyrimit të zbarkimit;

d) masat specifike të miratuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit në lidhje me stoqet dhe zonat në fjalë.

6. DSHPA-ja kryen kontrolle dhe inspektime për aktivitetet e peshkimit dhe aktivitetet e lidhura me peshkimin për rezervat peshkore sipas shtojcës I të këtij udhëzimi, në bazë të menaxhimit të riskut dhe në përputhje me pikat 6, 111 dhe 112, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar.

7. DSHPA-ja përcakton një nivel prioriteti për aktivitetet e kontrollit dhe inspektimit në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut të kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara në kreun II të këtij udhëzimi.

8. Çdo anije peshkimi ose segment i flotës i nënshtrohet kontrollit dhe inspektimit sipas nivelit të prioritetit, duke siguruar që të gjitha rezervat peshkore, të parashikuara në shtojcën I, të jenë të përfshira në mënyrë të përshtatshme.

9. Inspektimet për subjektet që ushtrojnë aktivitete të lidhura me peshkimin, kryhen kur këto aktivitete lidhen me zinxhirin e peshkimit dhe tregtimit, dhe kur këto inspektime janë pjesë e planit të menaxhimit të riskut.

II. PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E RISKUT

1. Inspektorati i peshkimit vlerëson, të paktën një herë në vit, rreziqet në lidhje me peshkimin, në shtojcën I, në përputhje me metodologjinë e hartuar nga DSHPA-ja sipas treguesve të matjes së përputhshmërisë në peshkim të Agjencisë Evropiane të Kontrollit të Peshkimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të peshkimit.

2. Metodologjia e vlerësimit të riskut parashikon që Inspektorati i Peshkimit:

a) shqyrton, duke përdorur të gjithë informacionin e disponueshëm, mundësitë për mospërputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi të peshkimit dhe ndikimet e mundshme të tyre, nëse ka;



b) përcakton nivelin e riskut sipas resurseve peshkore, veglave të peshkimit, zonës së ushtrimit të aktivitetit sipas “segmentit të flotës” dhe periudhës së vitit, bazuar në mundësitë për mospërputhshmëri dhe ndikimet e mundshme;

c) nivelin e vlerësuar të riskut si “shumë i lartë”, “i lartë”, “mesatar” ose “i ulët”.

3. Inspektorati i Peshkimit i komunikon DSHPA-së rezultatet e vlerësimit të riskut dhe mospërputhjet e identifikuara me legjislacionin e peshkimit.

4. DSHPA-ja përdor informacionin e marrë nga Inspektorati i Peshkimit për koordinimin e vlerësimit të riskut për sektorin e peshkimit në nivel kombëtar.

5. Inspektorati krijon një listë të anijeve duke përcaktuar, të paktën anijet me rrezik të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë. Lista e anijeve përditësohet rregullisht sipas informacionit të mbledhur gjatë aktiviteteve të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë kontrollin dhe inspektimin e përbashkët dhe çdo informacion përkatës të dhënë nga autoritetet kompetente të organizatave ndërkombëtare të peshkimit dhe të vendeve të tjera sipas detyrimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura.

6. DSHPA-ja i komunikon Ministrisë listën e anijeve të përcaktuara në përputhje me pikën 5 të këtij kreu, sipas nivelit të riskut dhe çdo ndryshim pas përditësimit të kësaj liste.

III. PLANI PËR MENAXHIMIN E RISKUT DHE TREGUESIT E VLERËSIMIT

1. DSHPA-ja, mbi bazën e rezultateve të vlerësimeve të riskut, harton, të paktën një herë në vit, një plan pune për menaxhimin e riskut në përputhje me legjislacionin e peshkimit.

2. Plan i punës përfshin identifikimin, përcaktimin e burimeve, instrumenteve të kontrollit dhe mjeteve të duhura të inspektimit, sipas nivelit të identifikuar të riskut, natyrën e kërcënimit të mospërputhjes me legjislacionin e peshkimit dhe arritjen e standardeve të synuara.

3. Treguesit e vlerësimit për inspektimet e anijeve të peshkimit janë të përcaktuara në pikën 4 të shtojcës I të këtij udhëzimi.

4. Me përjashtim të pikës 3 të këtij kreu, Inspektorati i Peshkimit zbaton tregues të ndryshëm, me synim përmirësimin e niveleve të përputhshmërisë sipas metodologjisë të hartuar nga

DSHPA-ja dhe përmbushjen e objektivave të këtij udhëzimi, me kusht që:

a) analiza e detajuar e aktiviteteve të peshkimit ose aktiviteteve të lidhura me peshkimin dhe çështjet e lidhura me zbatimin justifikojnë nevojën për vendosjen e standardeve të tjera;

b) Inspektorati i Peshkimit përcakton mënyrën e kontrollit dhe inspektimit, si dhe mënyrën për të arritur rezultatet e synuara;

c) treguesit nuk ndikojnë negativisht në objektivat, prioritetet dhe procedurat e bazuara në risk, të përcaktuara nga programet e kontrollit dhe inspektimit.

5. Të gjithë treguesit e synuar vlerësohen çdo vit në bazë të raporteve të vlerësimit dhe, sipas rastit, rishikohen në përputhje me rrethanat në kuadrin e vlerësimit.

6. Planet e përbashkëta të kontrollit dhe inspektimit me autoritetet kompetente kombëtare dhe rajonale zbatohen sipas rastit treguesit sipas këtij kreu.

IV. BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

1. Inspektorati i peshkimit bashkëpunon me autoritetet e tjera shtetërore të përfshira për zbatimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit.

2. Në raste të veçanta, për të arritur objektivat e planeve të përbashkëta dhe për zbatimin e programeve specifike të kontrollit dhe inspektimit, DSHPA-ja bashkëpunon me autoritetet kompetente të organizatave ndërkombëtare të peshkimit dhe të vendeve të tjera sipas detyrimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura.

3. Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të kontrollit të peshkimit Inspektorati i Peshkimit kryen, sipas rastit, aktivitete të përbashkëta inspektimi dhe kontrolli në territorin dhe në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë dhe sipas nevojës në ujërat ndërkombëtare.

4. Për qëllime të aktiviteteve të përbashkëta të inspektimit dhe kontrollit, DSHPA-ja:

a) siguron që inspektorët të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta të inspektimit dhe kontrollit;

b) vendosin procedura të përbashkëta operacionale të zbatueshme për mjetet e tyre të vëzhgimit;

c) përdor procedura standarde në kuadrin e një plani të përbashkët inspektimi;



d) cakton pikat e kontaktit për inspektimet e përbashkëta.

5. Inspektorati i Peshkimit siguron shkëmbimin elektronik të të dhënave në lidhje me aktivitetet e peshkimit dhe aktivitetet e lidhura me peshkimin që mbulohen nga programet e kontrollit dhe inspektimit me Ministrinë dhe autoritetet e tjera kompetente bashkëpunuese. Shkëmbimi i të dhënave kryhet në përputhje me nenin 95, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

6. Inspektorati i Peshkimit siguron ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Të dhënat personale, të përfshira në informacionin e shkëmbyer, ruhen për një periudhë deri në 10 vjet.

8. Të dhënat personale, të nevojshme për të lejuar ndjekjen e një shkeljeje, një inspektimi ose procedimi gjyqësor ose administrativ, ruhen deri në 20 vjet.

9. Nëse të dhënat personale, të përfshira në informacionin e shkëmbyer, ruhen për një periudhë më të gjatë kohore, të dhënat mbeten anonime.

10. Të dhënat personale, të përfshira në informacionin e shkëmbyer, ruhen për një periudhë që tejkalon periudhat e përcaktuara në këtë krye, vetëm për qëllime të kërkimit shkencor dhe ofrimit të këshillave shkencorë.

11. DSHPA-ja merr masa për të siguruar mbrojtjen e duhur të konfidencialitetit të informacionit të marrë në përputhje me nenin 96, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

12. DSHPA-ja brenda datës 31 mars të çdo viti, i dërgon Ministrisë një raport në lidhje me aktivitetet e kontrollit dhe inspektimit, të kryera sipas programeve të kontrollit dhe inspektimit të vitit kalendarik paraardhës, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij udhëzimi.

13. Informacioni periodik për shkeljet e zbuluara, sipas shtojcës II, përditësohet në çdo raport derisa inspektimi të përfundojë dhe kur nuk ndërmerret asnjë veprim pas konstatimit të një shkeljeje të rëndë, duhet të arsyetohet.

14. Për aktivitetet e peshkimit, të parashikuara në shtojcën I, informacioni periodik për shkeljet e zbuluara i transmetohet elektronikisht Ministrisë deri më 15 shtator dhe përditësohet deri më 31 mars të vitit pasardhës.

15. Në vlerësimin vjetor të efektivitetit të programeve të kontrollit dhe inspektimit, DSHPA-ja bazohet në raportet e parashikuara në pikën 12 të këtij kreu.

16. Ministria mbledh të paktën çdo dy vjet një mbledhje të Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën për të vlerësuar zbatimin dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të programeve të kontrollit dhe inspektimit dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm te subjektet dhe anijet e peshkimit.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

SHTOJCA I DETAJE MBI PROGRAMET E KONTROLLIT DHE INSPEKTIMIT PËR PESHKIMIN E SPECIEVE TË MBULUARA NGA ICCAT-I NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE DHE PËR DISA SPECIE FUNDORE DHE PELAGJIKE PËR TË CILAT JANË VENDOSUR KUFIZIME

1. Programet e kontrollit dhe inspektimit mbulojnë zonat gjeografike të përcaktuara si më poshtë:

a) “Atlantiku Lindor” nënkupton ndarjen e FAO-s 34.1.2;

b) “Deti Mesdhe” nënkupton nënzonat 37.1, 37.2 dhe 37.3 të FAO-s ose nënzonat gjeografike 1 deri në 27 sipas shtojcës VI, të vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të ndryshuar;

c) “Adriatiku Verior” dhe “Adriatiku i Jugut” nënkupton nënzonat gjeografike 17 dhe 18 sipas shtojcës VI, të vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të ndryshuar.

2. Format e peshkimit që merren në konsideratë, janë:

- peshkimi i tonit të kuq në Atlantikun Lindor dhe detin Mesdhe;



- peshkimi i peshkut shtizë në Mesdhe;
- peshkimi i sardeles dhe açugës në detin Adriatik Verior dhe Jugor;

- peshkimi i ngjalës evropiane (*anguilla anguilla*) në detin Mesdhe dhe në ujërat e brendshme;

- peshkimi i specieve nën detyrimin e zbarkimit.

3. Treguesit e vlerësimit për inspektimet zbatohen gjatë aktivitetit të:

a) Inspektimit në det dhe në zbarkim (inspektimet në porte dhe para shitjes së parë).

Në bazë vjetore, të paktën 60% e inspektimeve totale në det dhe në zbarkim do të kryhen në anijet e peshkimit që u përkasin segmenteve të flotës në dy kategoritë e nivelit më të lartë të riskut të identifikuar, sipas nenit 5(1) dhe 5(2), duke siguruar që të dy këto segmente të flotës të mbulohen në mënyrë proporcionale.

b) Inspektimit në kosha dhe instalimet e fermave për rritjen e tonit të kuq.

Në baza vjetore do të inspektohen 100% e operacioneve të futjes dhe transferimit të tonit të kuq në kosha, duke përfshirë edhe lëshimet.

SHTOJCA II PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VLERËSIMIT

Raportet e vlerësimit duhet të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

I. *Analizë e përgjithshme e aktiviteteve të kontrollit, inspektimit dhe zbatimit të kryera*

Inspektorati i Peshkimit raporton informacionin e mëposhtëm sipas përcaktimeve të shtojcës I:

- rezultatet e vlerësimit të riskut, me përshkrimin e rreziqeve të identifikuar, për ato forma peshkimi që mbulohen nga programet e kontrollit dhe inspektimit (duke dhënë informacion mbi rishikimin dhe përditësimin, kur është e nevojshme);

- tabela përmbledhëse e segmenteve të flotës së identifikuar dhe niveli i riskut përkatës;

- përmbajtja e detajuar e strategjisë së menaxhimit të riskut.

II. *Analizë të detajuar të aktiviteteve të kontrollit, inspektimit dhe zbatimit të kryera*

Inspektorati i Peshkimit raporton informacionin e mëposhtëm sipas përcaktimeve të shtojcës I.

Tabela 1. Të dhëna përmbledhëse të inspektimeve në det

Ditët e patrullimit (ditët)	
Numri i inspektimeve totale në det	
Numri total i shkeljeve të rënda të dyshuara	
Numri i inspektimeve në det për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë”	
Numri i inspektimeve në det për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë”	
Numri i inspektimeve në det për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë”	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë”	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut	
Raporti total i shkeljeve të rënda* [%]	
Raporti i shkeljeve të rënda* për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë” [%]	
Raporti i shkeljeve të rënda* për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë” [%]	
Raporti i shkeljeve të rënda* për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut [%]	
* Raporti i shkeljeve të rënda nënkupton raportin midis numrit të shkeljeve të rënda të konstatuara me numrin total të inspektimeve të kryera, shprehur në %.	

Tabela 2. Të dhëna përmbledhëse të vëzhgimit në det

Numri i vëzhgimeve ajrore (orë)	
Numri i vrojtimeve totale nga vëzhgimi ajror	
Numri i vrojtimeve totale nga anijet patrulluese	
Numri i totalit të shkeljeve të rënda të dyshuara	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë”	



Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë”	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut	

Tabela 3. Të dhëna përmblledhëse të aktiviteteve të inspektimit në zbarkim (inspektimet në porte dhe para shitjes së parë)

Inspektimet (inspektor/ditë)	
Numri i inspektimeve totale në zbarkim	
Numri i totalit të shkeljeve të rënda të dyshuara	
Numri i inspektimeve në anijet e peshkimit në kategoritë e segmentit të flotës me rrezik më të lartë	
Numri i inspektimeve për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë”	
Numri i inspektimeve për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë”	
Numri i inspektimeve për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë”	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë”	
Numri i shkeljeve të rënda të dyshuara për anijet e peshkimit të segmentit të flotës për kategoritë e tjera të riskut	
Raporti total i shkeljeve të rënda (*) mesataren [%]	
Raporti i shkeljeve të rënda (*) për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “shumë të lartë” [%]	
Raporti i shkeljeve të rënda (*) për anijet e peshkimit të segmentit të flotës me risk “të lartë” [%]	
*Raporti i shkeljeve të rënda nënkupton raportin midis numrit të shkeljeve të rënda të konstatuara me numrin total të inspektimeve të kryera, shprehur në %.	

Tabela 4. Të dhëna përmblledhëse të aktiviteteve të inspektimit në bregdet dhe në tokë për operatorët (duke përfshirë inspektimet në porte dhe para shitjes së parë të raportuara në tabelën 3)

Inspektimet (inspektor/ditë)	
Numri i inspektimeve totale	
Numri i totalit të shkeljeve të rënda të dyshuara	
Raporti i shkeljeve të rënda (*)	
*Raporti i shkeljeve të rënda nënkupton raportin midis numrit të shkeljeve të rënda të konstatuara me numrin total të inspektimeve të kryera, shprehur në %.	

III. Kontrolli mbi detyrimin e zbarkimit

Raportet e kontrollit mbi detyrimin e zbarkimit përmbajnë detaje specifike mbi burimet, instrumentet dhe mjetet e përdorur gjatë aktivitetet e kontrollin, si dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve.

Në veçanti, nevojitet informacioni i mëposhtëm:

1. Numri total i anijeve me vëzhgues në bord;
2. Numri i inspektimeve në det, të kryera mbi zëniet;
3. Mënyrat e tjera të kontrollit të përdorura, të cilat nuk janë të parashikuara në pikat 1 dhe 2, duke i specifikuar ato (p.sh. vëzhgimi ajror nga avionët, dron etj.);
4. Numri total i shkeljeve, duke specifikuar numrin e tyre.

IV. Informacion periodik për shkeljet e zbuluara



Tabela 5. Formati i komunikimit të informacionit sipas përcaktimeve të nenit 11

Emri i elementit	Kodi	Përshkrimi dhe përmbajtja
Nr. identifikues i inspektimit	II	Kodi ISO alfa2 i shtetit + 9 shifra, p.sh. AL000000001
Data e inspektimit	DA	YYYY-MM-DD
Lloji i inspektimit ose kontrollit	IT	Në det, gjatë zbarkimit, transportit, shitjes së parë, magazinimit, marketingut, transferimit, futjes në kosha, transbordimit, lëshimi, kontroll dokumentacioni (të specifikohet)
Nr. identifikimi i anijes së peshkimit, automjetit ose operatorit	ID	Numri i regjistrimit të flotës (NFR) dhe emri i anijes së peshkimit, nr. i regjistrimit ICCAT (nëse aplikohet). Nr. i koshit ose nr. i identifikimit të automjetit dhe/ose emri i kompanisë, duke përfshirë edhe instalimet e fermës.
Vegla e peshkimit	GE	Kodi i veglës i bazuar në Klasifikimin Statistikor Ndërkombëtar Standard të FAO-s për veglat e peshkimit
Lloji i shkeljes	TS	Përshkrimi i shkeljes me tregues të dispozitave ligjore në fjalë. Nëse është e aplikueshme, tregoni llojin e shkeljes, duke përdorur kodet përkatëse
Sasia e peshkut e konstatuar gjatë shkeljes, sipas specieve	AF	Të përcaktohet sasia e peshkut sipas specieve gjetur në bord (në kg) ose në kosha (për BFT: pesha dhe numri i individëve).
Statusi i çështjes	FU	Të përcaktohet statusi i çështjes: në pritje, ankesë në pritje, pranuar ose refuzuar.
Vlera e gjobës	SF	Vlera në lekë
Konfiskimi	SC	ZËNIET/VEGLAT/ TË TJERA për konfiskim fizik. Vlera e konfiskuar në lekë, në rastin e ZËNIEVE/VEGLËS, p.sh. 100 000 lekë;
Të tjera	SO	Në rast të tërheqjes së licencës (LI) /autorizimit (AU), të shënohet: LI ose AU + numrin e ditëve, p.sh. AU30
Pikët	SP	Numri i pikëve sipas nenit 130, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin” i ndryshuar, p.sh. 12;
Shënime/komente	RM	Në rastin e mos marrjes së masave, pas konstatimit të një shkelje të rëndë, të jepen shpjegime/komente.

Tabela 6. Arritjet në procesin e përmirësimit të nivelit të përputhshmërisë

Përshkrimi i aktiviteteve kërcënuese/riskut/segmentit të flotës	Niveli i riskut [shumë i lartë / i lartë / i mesëm / i ulët]
	- Niveli i riskut në fillim të vitit. - Objektivi për përmirësimin nivelit të përputhshmërisë. - Niveli i riskut në fund të vitit. - Numri i inspektimeve për çdo nivel risku. - Numri i shkeljeve të rënda të konstatuara për çdo nivel rrezik, duke përfshirë shkallën dhe trendin e shkeljeve të rënda (në krahasim me dy vitet e mëparshme). -Përqindja e inspektimeve në anijet e peshkimit/operatorët që rezultojnë në një ose më shumë shkelje të rënda. - Analiza përfundimtare, duke përfshirë vlerësimin e efekteve parandaluese dhe shpjegime, në rast se niveli i përputhshmërisë së synuar nuk është arritur.

V. Analiza e aktiviteteve të tjera të inspektimit dhe kontrollit, si: transbordimi, vrojtimi ajror, gjatë import/eksportit

VI. Aktivitete të tjera si trajnime ose sesione informative të me synim rritjen e përputhshmërisë nga anijet dhe operatorët e peshkimit

VII. Propozime për përmirësimin e efektivitetit të aktiviteteve të kontrollit, inspektimit dhe zbatimit

**URDHËR****Nr. 670, datë 7.11.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Suzana Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyqimit të kësaj çështjeje, si edhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga znj. Suzana Hoxha, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

d) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

e) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

f) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

g) të ndjekë procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA), për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

h) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca të ushtrohen nga znj. Suzana Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 3.11.2023.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

4. Ngarkohet znj. Suzana Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm, dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 603, datë 19.9.2023, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçi

URDHËR**Nr. 43, datë 1.2.2024****PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT,
KOPSHTI “SHPRESA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”,



URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”, të subjektit juridik shoqata “Varka”, i licencuar me urdhrin nr. 114, datë 16.5.2002, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Shpresa”, me kërkesën e tij, regjistruar në MAS me nr. 7304 prot., datë 20.11.2023.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”, ka për detyrë:

a) të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lushnjë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

b) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Lushnjë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer;

c) të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës për pjesën e papërfunduar të arsimit parashkollor, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur, nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnjë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”;

b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Fier, të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Lushnjë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Lushnjë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 114, datë 16.5.2002, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së

funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, kopshti “Shpresa”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Lushnjë, institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Shpresa”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga

VENDIM
Nr. 70, datë 27.12.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;

me sekretare Enina Kotoni dhe Blerina Basha, në datat 17.10.2023, 8.11.2023, 14.11.2023 dhe 7.12.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 1 (Dh) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari Maksim Haxhia dhe avokatët Edmond Konini e Drilon Cami, me autorizim; Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Erida Skëndaj, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Besmir Beja dhe avokatja e shtetit Irma Qosja, me autorizim; Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar nga Qemal Zaimi dhe gjyqtarët Florjan Kalaja dhe Engert Pëllumbi, me autorizim; Këshilli i Lartë i



Prokurorisë, përfaqësuar nga Danja Hobdari, me autorizim; Prokurori i Përgjithshëm, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i VKM-së nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 18, 48, pika 2, 49, 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, pika 3, shkronja “d”, 50 dhe 51, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë (*Dhoma e Avokatisë*) dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit (*KSHH*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KL Gj*), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*) dhe Prokurorit të Përgjithshëm, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimet e Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (*DNJF*) në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ligji nr. 98/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*), ka përcaktuar parimet e përgjithshme dhe rregullat në lidhje me: a) organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë; b) kompetencat dhe madhësitë e gjykatave; c) organizimin e brendshëm të gjykatave; ç) funksionimin e administratës së gjykatës; d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Në nenin 13 të ligjit parashikohet procesi për caktimin e rretheve gjyqësore dhe organet kompetente për vlerësimin dhe hartimin e propozimit për organizimin e

rretheve gjyqësore, kurse në nenet 14 dhe 15 të tij përcaktohen objektivat që synohen të përmbushen dhe parimet e kriteret për përcaktimin e kompetencave tokësore, ashtu si edhe numri minimal i gjyqtarëve, me qëllim rritjen e eficiencës dhe sigurimin e specializimit në gjykata.

2. Në zbatim të këtij ligji, me urdhrin nr. 78, datë 18.2.2019, të ndryshuar, KL Gj-ja ka miratuar ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, të përbërë nga anëtarë të KL Gj-së, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe përfaqësues nga gjykatat e juridiksioneve dhe shkallëve të ndryshme të gjykimin. Në grupin e punës kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të misionit EURALIUS, USAID, Këshillit të Evropës etj.

3. Në datat 29.9.2020 dhe 12.10.2021, KL Gj-ja i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë raportin e përgatitur nga grupi i punës për hartën e re gjyqësore. Me qëllim konsultimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, janë zhvilluar takime me KLP-në, Prokurorin e Përgjithshëm, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, si edhe me gjykatat, grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

4. Me vendimin e datës 10.6.2022, KL Gj-ja ka miratuar raportin vlerësues përfundimtar të grupit ndërinstitucional të punës për riorganizimin e rretheve gjyqësore.

5. Në datën 13.7.2022, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni i Ligjeve*) ka zhvilluar seancë dëgjimore, bazuar në kërkesën e datës 13.6.2022, të paraqitur nga 1/3-ta e deputetëve të opozitës parlamentare, për dëgjuesë në lidhje me projektin e hartës së re gjyqësore, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të disa institucioneve dhe organizmave ndërkombëtarë, si dhe përfaqësues të grupeve të interesit.

6. Në datën 19.7.2022, Ministria e Drejtësisë i ka dërguar KL Gj-së projektvendimin “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave” së bashku me relacionin shpjegues.

7. Në datën 21.7.2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 495, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” (*VKM nr. 495/2022*). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107, datë 21.7.2022 dhe sipas nenit 5 të tij ka hyrë në fuqi sipas këtyre



përcaktimeve: a) riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, më 1.5.2023; b) riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 2 të këtij vendimi, më 1.2.2023; c) riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, më 1.7.2023.

8. Në datën 2.2.2023, Dhoma e Avokatisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e VKM-së nr. 495/2022, si të papajtueshme me Kushtetutën.

9. Kolegji i Gjykatës, në mbledhjen e datës 23.3.2023, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare publike, duke përcaktuar subjektet e interesuara që do të thirren në gjykim, si dhe kërkimin e mendimit me shkrim nga Avokati i Popullit dhe DNJF-ja.

10. Mbi kërkesën e datës 3.5.2023, të paraqitur nga KSHH-ja, për pjesëmarrje në këtë gjykim kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 39, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin e datës 9.5.2023, duke pasur parasysh misionin e kësaj organizate dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, ka vlerësuar se thirrja e saj për t'u dëgjuar në cilësinë e subjektit të interesuar është në interes të këtij gjykimi kushtetues.

11. Në datën 10.10.2023, disa banorë të rrethit Mat i janë drejtuar Gjykatës me "Parashtrime, ankim popullor", ku kanë parashtruar se bashkimi i gjykatave të shkallës së parë të qyteteve Mat dhe Dibër nuk garanton aksesin fizik të qytetarëve të këtyre zonave, duke paraqitur edhe argumentet e tyre. Në datën 12.10.2023, ky peticion u është komunikuar palëve në gjykim, duke lënë në vlerësimin e tyre paraqitjen e tij në mbështetje të qëndrimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.

12. Në seancën plenare të datës 17.11.2023, subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka paraqitur kërkesë për thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjektit të interesuar, të Prokurorit të Përgjithshëm, si subjekt që ka qenë drejtpërdrejt i përfshirë në procesin e riorganizimit të rretheve gjyqësore. Pasi dëgjoi edhe palët në gjykim, Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se Prokurori i Përgjithshëm ka pasur mundësi të paraqesë kërkesë për pjesëmarrjen në gjykim si subjekt i interesuar, por nuk e ka ushtruar këtë mjet, duke treguar mungesën e interesit të tij. Nga ana tjetër, në këtë fazë të

shqyrtimit të çështjes, informacionet shtesë nga ky subjekt nuk do të sillnin ndonjë vlerë të shtuar për gjykimin. Në përfundim të kësaj seance Gjykata vendosi shtyrjen e saj për t'u lënë palëve kohën e mjaftueshme për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara dhe përgjigjeve me shkrim.

13. Në datën 2.11.2023, KSHH-ja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të VKM-së nr. 495/2022, duke kërkuar edhe bashkimin e çështjeve. Në seancën plenare të datës 8.11.2023, Gjykata, pasi informoi palët në gjykim në lidhje me kërkesën, vendosi shtyrjen e saj, me qëllim paraqitjen prej tyre të mendimit me shkrim.

14. Në datën 13.11.2023, Kolegji i Gjykatës vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Në zbatim të nenit 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 57 të Kodit të Procedurës Civile, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 13.11.2023, vendosi bashkimin e çështjeve në një çështje të vetme, si dhe thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjektit të interesuar, të Prokurorit të Përgjithshëm.

15. Në seancën plenare të datës 14.11.2023, Gjykata informoi palët në lidhje me vendimet e mësipërme dhe riçeljen e hetimit gjyqësor, për shkak të bashkimit të këtyre çështjeve, duke u lënë edhe kohën e mjaftueshme për përgatitjen e parashtrimeve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. **Kërkuesit, Dhoma e Avokatisë dhe KSHH-ja**, kanë pretenduar se VKM-ja nr. 495/2022 cenon disa liri dhe të drejta kushtetuese. Për shkak se disa nga shkaqet mbi të cilat janë mbështetur këto kërkesa janë të ndryshme, ato do të paraqiten në vijim veçmas:

16.1. Kërkuesja, Dhoma e Avokatisë, ka pretenduar se cenohet:

16.1.1. Liria e veprimtarisë ekonomike, në kundërshtim me kriteret e kufizimit sipas neneve 11 dhe 17 të Kushtetutës, sepse VKM-ja vendos kufizim të të ardhurave që mbrojtësit ligjorë mund të përfitojnë në rastet e ofrimit të shërbimit të avokatisë. Ndarja e re gjyqësore do të krijojë fenomenin e monopolizimit të tregut drejt qyteteve ku veprojnë gjykatat dhe do të cenojë veprimtarinë



e avokatëve që ushtrojnë profesionin në ato rrethe gjyqësore ku është vendosur mbyllja e tyre. Cenimi lidhet si me rritjen e kostos së shërbimit të avokatisë, për shkak të largësive të gjykatave nga njësitë administrative ku kanë vendbanimin dhe ushtrojnë aktivitetin, ashtu edhe me uljen e interesit të publikut të këtyre njësive administrative për t'iu drejtuar gjykatave për shkak të distancave. Kufizimi është i paarsyeshëm, i panevojshëm dhe disproporcional, pasi nuk është arritur të argumentohet interesi shoqëror ose publik që është synuar. Harta e re është në konflikt me parimet dhe kriteret e ligjit, veçanërisht me atë të proporcionalitetit, pasi nuk merr parasysh ndarjen administrativo-territoriale, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave etj. dhe ka eliminuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenet 17 e vijues të ligjit, që lidhet me krijimin e degëve të gjykatave. Ekzistenca e një gjykate të vetme të apelit, sikurse është ajo e apelit administrativ, ka rezultuar joefektive dhe ka shkaktuar pasoja negative afatgjata në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve në atë gjykatë.

16.1.2. Parimi i barazisë përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit, pasi avokatët që ushtrojnë profesionin në dhomat vendore të avokatisë (14 të tilla, me përjashtim të Tiranës), për të përballuar pasojat duhet të rrisin tarifat e shërbimit, ndërkohë që avokatët e dhomës së Tiranës mbajnë të njëjtat tarifa, duke hyrë kështu në një treg të pabarabartë.

16.1.3. E drejta e publikut për akses në gjykatë e lidhur me parimin e barazisë së armëve, si elemente të së drejtës për proces të rregullt. Referuar standardeve ndërkombëtare, aksesit përfshin disponueshmërinë lidhur edhe me largësinë geografike të gjykatës, nëse vendndodhja e saj pengon palën të marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin gjyqësor. Aksesit në drejtësi nuk është thjesht e drejta e palëve për të kërkuar zgjidhjen e konflikteve nga ana e gjykatës nëpërmjet një vendimi gjyqësor, por, para së gjithash, krijimi i kushteve dhe mundësive për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve në seancat gjyqësore. Metodot e përdorura për llogaritjen e largësisë mes qendrës së banimit dhe gjykatës nuk janë korrekte edhe nga pikëpamja shkencore dhe vënë në dyshim besueshmërinë e tyre. Aplikacionet e përdorura për këtë qëllim japin indikacione teorike dhe jo kohën reale për të mbërritur në destinacion. Po kështu, në lidhje me personat që përfitojnë ndihmë juridike falas nga shteti, shërbim që kryhet ekskluzivisht nga avokatët aktivë dhe mbi bazën e

një vendimi gjyqësor juridiksional të gjykatave të shkallës së parë për përfitim të ndihmës juridike, me hyrjen në fuqi të hartës së re përfaqësimi bëhet absolutisht i pamundur, për shkak të disafishimit të kostove të transportit.

16.2. Kërkuesja, KSHH-ja, ka pretenduar se cenohet e drejta e aksesit në gjykatë në kundërshtim me kriteret e kufizimit sipas nenit 17 të Kushtetutës, duke parashtruar, përveç sa ka pretenduar Dhoma e Avokatisë, edhe këto shkaqe:

16.2.1. Harta e re nuk plotëson kriterin e kufizimit me ligj që parashikon se kufizimet e të drejtave kushtetuese nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit të miratuar nga Kuvendi. Ligji nr. 98/2016, ka parashikuar se riorganizimi duhet të kryhet në një klimë konsultuese dhe transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës (*neni 13*) dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të tij. Në procesin e zhvilluar nga grupi i punës është vërejtur: mungesa e transparencës së mbledhjeve, të cilat nuk kanë qenë të hapura për publikun dhe të interesuarit; mungesa e procesit konsultues gjithëpërfshirës; mungesa e një studimi ose vlerësimi objektiv e të plotë, me avantazhet dhe disavantazhet e riorganizimit; cikli i konsultimeve i dha ngjyrimet formale procesit dhe pamundësoi zhbërjen e metodologjisë së ndjekur për vlerësimin e nevojave të hartës, si dhe nuk pati përgjigje për sa i përket reflektimeve të komenteve dhe sugjerimeve të aktorëve të shoqërisë civile; mungesa e procesit të konsultimit me takime të dedikuara me qytetarët dhe njerëzit në nevojë, në mënyrë të veçantë me përdoruesit e gjykatave.

16.2.2. Në lidhje me distancën, si një nga kriteret e aksesit në gjykatë, edhe pse praktika ndërkombëtare jep shembuj konkretë në lidhje me kohën dhe largësinë e individit nga gjykata, hartuesit e hartës nuk kanë aplikuar asnjë referencë të tillë. Treguesi i kohës maksimale të përlllogaritur nuk është llogaritur mbi baza realiste, pasi nuk merr parasysh kohën që duhet për udhëtimin me mjete të transportit publik. Aplikacionet “ORSM” dhe “Google Map” japin të dhëna teorike për kohën dhe distancën dhe jo kohën reale. Nuk është analizuar varfëria në vend, as cilësia e rrugëve dhe e transportit rrugor, as aksesit i grupeve të disavantazuara ekonomikisht. Nuk është analizuar mjaftueshëm ngarkesa në gjykata në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe ato në shqyrtim. Argumentet në



lidhje me kufijtë e gjykimit në apel në raportin e vlerësimit janë kundërshtuar si jorealiste dhe se nuk i përgjigjen së drejtës për mbrojtje efektive. Është në diskrecion të palëve ndërgjyqëse të vlerësojnë nëse dëshirojnë të jenë të pranishme në seancë gjyqësore, pavarësisht nëse kanë ose jo mbrojtës.

16.2.3. Ndërhyrja në të drejtën e aksesit nuk *respekton parimin e proporcionalitetit*, pasi nuk është një masë e përshtatshme dhe e domosdoshme për arritjen e objektivit të dëshiruar, por synon në mënyrë jo të ekuilibruar rritjen e eficiencës së sistemit gjyqësor dhe shpejtësisë së gjykimit, duke mos peshuar me kujdesin e duhur aksesin në drejtësi, që kërkon, mes të tjerash, afërsinë e qytetarit me gjykatën. Në lidhje me proporcionalitetin *stricto sensu*, nga monitorimi i kryer, që ka konsistuar në intervistimin e qytetarëve përdorues të gjykatave në qytetet që janë qendrat e katër prej qarqeve që preken nga riorganizimi, në përgjithësi ai nuk është mirëpritur. Qytetarët kanë vlerësuar se harta duhej të ishte produkt i konsultimit edhe me ta, ndërkohë që është shtuar zvarritja e proceseve gjyqësore dhe kostot. Efektet shqetësuese të hartës së re reflektohen edhe në peticionin e banorëve të Matit.

16.2.4. *Kufizimet tejkalojnë ato të parashikuara nga Komventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)*, pasi objektivat dhe kriteret e ndjekura për riorganizimin gjyqësor nuk respektojnë plotësisht garancitë e ligjit nr. 98/2016, duke vënë në pikëpyetje standardet e gjykatës së caktuar me ligj dhe duke cenuar thelbin e së drejtës së aksesit për njerëzit dhe grupet në nevojë ose në pamundësi ekonomike. Harta ka sjellë vonesa dhe efekte të ngadalshme në drejtëm të ofrimit të ndihmës juridike dytësore ndaj kategorive përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” (ligji nr. 111/2017). Referuar të dhënave të INSTAT-it ka shumë familje në pamundësi ekonomike, që edhe pse nuk janë pjesë e kësaj fashe, nuk janë në gjendje të paguajnë kostot e shtuara të përfaqësimit me avokat. Me hyrjen në fuqi të hartës së re përfaqësimi për këta persona bëhet absolutisht i pamundur, për shkak të disafishimit të kostove të transportit.

17. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar si vijon:

A) *Për juridiksionin e Gjykatës:*

17.1. Lënda e referuar për shqyrtim nga KSHH-ja nuk prek probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të ketë gjatë zbatimit VKM-ja me

ligjin nr. 98/2016, të cilat zgjidhen nga organet administrative zbatuese dhe më tej nga gjykatat e zakonshme. Pretendimet janë me natyrë ligjore ndaj ato hyjnë në juridiksionin e gjykatës administrative.

B) *Për legjitimitimin:*

17.2. Në aspektin substancial Dhoma e Avokatisë nuk legjitimohet për pretendimin e cenimit të së drejtës për akses në gjykatë, pasi referuar aktit të themelimit dhe statutit ajo nuk ka mision mbrojtjen e të drejtave të individëve, por vetëm të avokatëve. Në aspektin procedural kërkesa është paraqitur nga kryetari i Dhomës, por mungon vendimmarrja e Këshillit të Përgjithshëm të saj, sipas nenit 27, shkronja “F”, të ligjit nr. 55/2018, datë 23.7.2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 55/2018).

C) *Për themelin e pretendimeve:*

17.3. *Pretendimi se procesi i konsultimit ka qenë formal dhe jo real* është i pabazuar, pasi KLGJ-ja dhe Ministria e Drejtësisë kanë kryer një proces të gjatë diskutimi, prezantimi dhe konsultimi të projektit të hartës së re gjyqësore. Në fillim të vitit 2022 është kryer cikli i konsultimeve publike, përmes tetë takimeve me grupet e interesit që ushtronin veprimtarinë në juridiksionet e gjykatave të apeleve dhe dy takimeve me përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetin e biznesit. Po kështu është zhvilluar edhe seanca dëgjimore në Komisionin e Ligjeve. Opinionet dhe sugjerimet e këtyre takimeve i janë nënshtruar një procesi vlerësimi, për të vijuar më pas me rishikimin e projektpropozimit dhe finalizimin e hartës. Megjithatë, në thelb, ky pretendim ka natyrë ligjore.

17.4. Në lidhje me *pretendimin për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike*, VKM-ja nr. 495/2022 nuk prek rregullimet që lidhen me ushtrimin e profesionit të avokatit, të parashikuara në ligjin nr. 55/2018 dhe statutin e Dhomës së Avokatisë dhe as të drejtën për të lidhur kontrata e për të ndërtuar marrëdhënien avokat-klient. Sipas nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 55/2018, avokati e ushtron profesionin në të gjithë territorin, pavarësisht se cilës dhomë vendore i përket. Harta e re nuk ndikon në licencat e fituara, as nuk ndalon ushtrimin e së drejtës së mbrojtësve për të lidhur marrëveshje sipas ligjit për shpërblimin e tyre. *Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit* në drejtëm të mungesës së interesit shoqëror ose publik nuk gjen mbështetje në parashikimet kushtetuese. Nisma është ndërmarrë në një kohë kur harta gjyqësore në fuqi nuk



përmbushte objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 98/2016. Parimi “*një gjykatë një qark*”, aty ku është e mundur, ka siguruar balancimin e kriterëve, duke shërbyer si garanci për ndarjen e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore. Akti ndjek një qëllim legjitim, është proporcional dhe është hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare.

17.5. Në lidhje me *pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit* Dhoma e Avokatisë nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të nivelit kushtetues. Profesia e avokatit është publik, i rregulluar me ligj dhe nuk mund të konsiderohet një veprimtari e mirëfilltë ekonomike dhe fitimprurëse, pra veprimtari tregtare. Kërkuesja duhet të argumentojë dëmin real dhe të drejtpërdrejtë që VKM-ja sjell në veprimtarinë e anëtarëve të saj dhe në çfarë mënyre e mase preken ata. Në lidhje me pretendimin se duhet të aplikohen tarifa të ndryshme, ato përcaktohen në marrëveshjen avokat–klient, ndërsa VKM-ja nuk ndërhyr në diskrecionin e avokatëve dhe nuk mund të krijojë diferencim tek ata. Por edhe nëse konkludohet se ka diferencim, nuk ka diskriminim, pasi arsyet objektive, qëllimet dhe efektet në drejtim të interesit publik për një shërbim cilësor në dhënien e drejtësisë përbëjnë arsye legjitime dhe objektive për konfigurimin e hartës së re gjyqësore.

17.6. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë* nuk mund të reduktohet vetëm në elementin e distancës me gjykatën, por lidhet edhe me elemente të tjera, si afati i arsyeshëm, cilësia dhe profesionalizmi, efienca e gjykatave etj. Propozimi për hartën e re, parë në këndvështrimin financiar dhe të uljes së kostove, nga njëra anë, dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve gjyqësore, nga ana tjetër, përbën zgjidhjen më të ekuilibruar që i përgjigjet realitetit shqiptar. Juridiksioni rishikues është i ndryshëm nga ai fillestar, pasi ndryshimet procedurale kanë rikonceptuar kufijtë e gjykimit në gjykatën e apelit, duke e kufizuar vetëm për shkaqet e ankimit. Për më tepër, gjykimi në atë gjykatë, si rregull, përfundon me një seancë, pasi kërkon përfaqësim të specializuar, duke mos e bërë të domosdoshme praninë e vetë palës. Për të garantuar akses të barabartë të qytetarëve, në gjykata funksionojnë zyrat e shërbimit gjyqësor që garantojnë vijimësinë e marrjes së shërbimeve në të njëjtin vend.

17.7. VKM-ja plotëson kriteret e nenit 118, pika 1, të Kushtetutës, pasi autorizimi buron nga pika 5, e nenit 13, të ligjit nr. 98/2016 dhe në çështjet e rregulluara nga akti nënligjor përfshihen vetëm ato që lidhen me autorizimin ligjor. Në lidhje me *parimin e proporcionalitetit*, harta e re ka pasur qëllim shmangien e problematikave, pasi harta në fuqi nuk përmbushte objektivat, kriteret dhe parimet e parashikuara nga ligji nr. 98/2016. Ajo ka një qëllim të përligjur, që është riorganizimi i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore për të krijuar një ekuilibër të objektivave të përcaktuara në nenin 14 të ligjit.

17.8. Në lidhje me *ndihmën juridike falas nga shteti*, referuar informacionit të DNJF-së, interesi i avokatëve për të qenë pjesë e listës së ndihmës juridike dytësore është rritur, sipas të dhënave për vitet 2022–2023. Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit dhe shpërblimi e shpenzimet mbulohen nga buxheti i shtetit. Për rrjedhojë, ky pretendim jo vetëm nuk është ngritur në nivel kushtetues, por nuk është bazuar mbi asnjë fakt, studim ose statistikë.

18. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, ka prapësuar si vijon:

A) Për legjitimitetin:

18.1. Dhoma e Avokatisë nuk ka legjitimitet aktiv për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi referuar statutit të saj dhe ligjit nr. 55/2018 asnjë prej rregullave të përcaktuara në VKM-në nr. 495/2022 nuk lidhet me cenimin e pavarësisë së këtij subjekti përballë shtetit, lirinë e ushtrimit të profesionit etj., pra nuk prek ose cenon asnjë prej qëllimeve publike dhe ligjore që ai është ngarkuar apo angazhuar të mbrojë. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 2.2.2023, kohë në të cilën VKM-ja kishte prodhuar pasoja vetëm pjesërisht, ndaj për atë pjesë që lidhet me organizimin e gjykatave të shkallës së parë kërkuesja nuk provon interesin e saj aktual. Edhe në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë, kërkuesja nuk ka interes të drejtpërdrejtë dhe vetjak, pasi nuk mund të bëjë të vlefshme, në emër dhe për llogari të saj, të drejta kushtetuese të qytetarëve. *Pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit* do të përbënin lëndë gjykimi vetëm nëse Dhoma e Avokatisë do të kishte legjitimitet aktiv. Kjo kërkuese nuk ka as legjitimitet procedural, pasi kërkesa është ushtruar përmes vendimarrjes së



kryetarit dhe jo të Këshillit të Përgjithshëm të saj, në kuptim të nenit 27, shkronja “P”, të ligjit nr. 55/2018.

B) Për themelin e pretendimeve.

18.2. *Pretendimi për mungesën e konsultimit* është i pabazuar, pasi KLGJ-ja është konsultuar jo vetëm me organet shtetërore, por edhe me palët e interesuara. Në gjashtë takimet publike të zhvilluara në nivel gjykate apeli, Dhoma e Avokatise ka qenë e pranishme dhe është ftuar të marrë pjesë aktivisht në diskutime, por ajo jo vetëm nuk ka qenë e harmonizuar dhe e unifikuar në qëndrimin e saj, por nuk ka bërë ndonjë propozim serioz, me qëllim rishikimin e aspekteve të caktuara të riorganizimit. Edhe KSHH-ja është ftuar në tryezat konsultative, por përveç vlerësimeve negative, nuk ka kontribuar për përmirësimin e hartës në aspektet që konsideronte negative. Edhe gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, kërkuarit kanë përsëritur pretendime me natyrë të përgjithshme dhe nuk kanë paraqitur propozime për ato pretendime. Bërja e dëgjësive publike nuk nënkupton se çdo pretendim duhet të gjejë patjetër pasqyrim në formën e ndryshimeve të projektit, por synon thithjen e mendimeve ndryshme që u nënshtrohen vlerësimit nga organet përgjegjëse. Ky pretendim, në thelb, ka natyrë ligjore, ndaj del jashtë juridiksionit kushtetues.

18.3. *Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike* është i pabazuar dhe pjesërisht nuk ka të bëjë me parashikimet e VKM-së nr. 495/2022, por të ligjit nr. 98/2016. Kufizimet në këtë liri mund të bëhen me ligj dhe për interes publik dhe një nga arsyet është mirëmenaxhimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet ofrimit të një drejtësie efektive dhe profesionale. Rritja e kostove financiare për ofrimin e shërbimit nuk përballohet nga avokati, por çon në rritjen e tarifave të shërbimit që paguhen nga klienti. Në lidhje me pretendimin për rritjen e kohës për shkak të distancave, në shërbimin e avokatisë kostoja përcaktohet nga disa faktorë, që në fund përkthehen në një vlerë të caktuar. Edhe kohëzgjatja e çështjes dhe distanca mund të çojnë në një kosto të caktuar për klientin, por kjo nuk ka të bëjë me lirinë e veprimtarisë ekonomike. I pabazuar është edhe pretendimi i lidhur me ndihmën juridike falas, pasi ndikimi, edhe nëse do të provohej, për sa kohë mbetet teorik, nuk do të jetë mbi avokatët, por përfituesit e kësaj ndihme.

18.4. *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit* është i pabazuar dhe

pretendimi se avokatët që ushtrojnë aktivitetin në Tiranë do të jenë me të avantazhuar është teorik dhe nuk mban në konsideratë shumë faktorë. Gjykimi në apel nuk kërkon domosdoshmëri pjesëmarrjen e palës ose të përfaqësuesit, duke qenë se përqendrohet në shkaqet e ankimit. Gjykimi rishikues, si rregull, përfundon me një seancë, çka nuk përbën rritje të ndjeshme të kostos së mbrojtjes. Veprimtaria gjyqësore nuk është shërbim primar, por fundor për qytetarin dhe mjeti i fundit kur mjetet e tjera janë shteruar dhe nuk kanë dhënë rezultatin e kërkuar. Afërsia e shërbimit duhet të jetë në balancë të drejtë me eficiencën dhe profesionalizmin e ofrimit të tij. Edhe nëse do të kishte disa gjykata apeli, sërish do të kishte qytetarë që nuk do kishin gjykatë në njësinë e tyre administrative dhe do të kishte avokatë që do duhej të përshkonin distanca gjeografike. Përcaktimi i kostos, duke u bazuar vetëm në distancën fizike të gjykatës, është i pasaktë, pasi ajo varet nga faktorë të tjerë si kompleksiteti i çështjes, kohëzgjatja e saj, kualifikimi i avokatit etj.

18.5. Në lidhje me *pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë*, kufizimi është bërë me ligj, pasi VKM-ja nr. 495/2022, ka dalë në zbatim të ligjit nr. 98/2016 dhe ai ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, që është ofrimi i një drejtësie efektive dhe profesionale, që do të sjellë edhe uljen e numrit të mosmarrëveshjeve në gjykatë për shkak të konsolidimit të praktikave dhe krijimit të pritshmërive të individëve për mënyrën e zgjidhjes. Kufizimi është proporcional me gjendjen që e ka ndikuar, nevojën për të krijuar barazi në standardin e trajtimit të çështjeve nga gjykatat, dhe ai nuk tejkalon kufizimet që parashikon KEDNJ-ja. Në lidhje me gjykatat e shkallës së parë, në numrin e tyre Këshilli i Ministrave ka zbatuar kriteret e ligjit, të cilat më pas janë zbërthyer në shifra konkrete nga studimi i KLGJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim edhe me partnerët ndërkombëtarë. Bazuar në nenet 17–20, të ligjit nr. 98/2016, me normalizimin e situatës KLGJ-ja mund të vendosë hapjen e degëve të gjykatave, të përhershme ose të përkohshme, ku përparësi do të kenë njësitë administrative në të cilat ka pasur më parë gjykatë të shkallës së parë. Për sa i përket aksesit në gjykatën e apelit, ky gjykim, në dallim nga ai fillestar, është rishikues dhe mbrojtja kufizohet vetëm në shkaqet e ankimit. Prania e individit ose e mbrojtësit në atë gjykim nuk është e domosdoshme dhe mosparaqitja



nuk sjell pasoja procedurale dhe as cenim të së drejtës së mbrojtjes, pasi të gjitha parashtimet mund të depozitohen me shkrim. Po kështu, një pjesë e çështjeve shqyrtohen në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Edhe pse nuk është argumenti kryesor, me mungesat e theksuara të gjyqtarëve të apelit zgjidhja e vetme e pranueshme ishte krijimi i një gjykate të vetme për të çuar në reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe për të sjellë barazi në dhënien e drejtësisë. Harta gjyqësore nuk është përfundimtare dhe e parikthyeshme, pasi sipas nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, KLGJ-ja bën vlerësimin të paktën çdo 5 vjet, ndaj nëse ajo nuk do t'u përgjigjet pritshmërive mund të rishikohet.

19. **Subjekti i interesuar, KLP-ja**, ka prapësuar si vijon:

19.1. *Në lidhje me pretendimin për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike*, VKM-ja nr. 495/2022 nuk cenon të drejtën e avokatëve për të lidhur kontrata me klientët e tyre në asnjë aspekt dhe riorganizimi nuk e bën të pamundur ushtrimin e profesionit të avokatit. Në lidhje me *pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit*, sipas nenit 17 të Kushtetutës, harta e re merr në konsideratë kriteret e ligjit nr. 98/2016, që kanë të bëjnë me zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, ndarjen administrativo-territoriale, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykatë dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike, ngarkesën në gjykata, eficiencën e gjykatave dhe gjyqtarëve, burimet njerëzore, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Krijimi i degëve të gjykatave, sipas nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, nuk është kriter ligjor, por një mundësi alternative nëse shihet e domosdoshme.

19.2. *Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi VKM-ja nr. 495/2022 nuk ka përcaktuar trajtim të diferencuar të avokatëve të Dhomës Vendore Tiranë në raport me ata të dhomave të tjera, sepse të gjithë avokatët janë në kushtet që mund ta ushtrojnë lirisht profesionin e tyre. Por edhe nëse Gjykata konsideron se ka kufizim, qëllimet që synon harta e re dhe mjeti i përdorur justifikojnë diferencimin për arsye legjitime dhe objektive.

19.3. *Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit*, VKM-ja nr. 495/2022 ka vlerësuar situatën aktuale dhe ka marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 14 dhe 15 të ligjit nr.

98/2016, si dhe nevojën për vazhdimësinë e shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logistikës. E drejta e aksesit nuk u mohohet dhe as nuk u kufizohet qytetarëve. Veprimtaria e vetme që largon deri diku qytetarin nga vendbanimi është seanca gjyqësore, që përgjithësisht ndiqet nga përfaqësuesi ligjor, kurse në raste të tjera prania e palëve nuk është e domosdoshme, pasi një pjesë e madhe e çështjeve, sidomos në gjykatën e apelit, zhvillohen mbi bazën e dokumenteve, pasi juridiksioni rishikues është rikonceptuar vetëm për shkaqet e ngritura në ankim. Harta e re është në përputhje dhe përshtatet me qëllimin e ligjit dhe me nevojën që e ka diktuar atë.

20. **Subjekti i interesuar, Prokurori i Përgjithshëm**, ka paraqitur, në thelb, të njëjtat prapësime që ka parashtruar edhe subjekti i interesuar, KLGJ-ja, në lidhje me legjitimitimin e kërkuësës, Dhomës së Avokatisë, si dhe thelbin e pretendimeve të kërkuësve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit dhe të drejtës së aksesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

21. Gjykata vëren se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës ajo vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, të Kushtetutës, vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, po në drejtim të juridiksionit të saj për kontrollin e akteve normative, Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje konkrete (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket natyrës së aktit të kundërshtuar, Gjykata, edhe pse palët në proces nuk kanë ngritur pretendime në këtë drejtim, vlerëson të



ndalet paraprakisht në vlerësimin e juridiksionit të saj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të VKM-së nr. 495/2022.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se akti normativ vendos norma të përgjithshme sjelljeje me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre për një kategori të pacaktuar subjektesh. Ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij. Kurse akti individual është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 59, datë 23.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka identifikuar tre kriterë që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: i. sipas subjekteve të cilave u drejtohet akti - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktuar në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii. sipas objektit - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; iii. sipas karakterit shterues/joshterues - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njehershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke iu referuar kriterëve të mësipërme, Gjykata vlerëson se VKM-ja nr. 495/2022: i. zbatohet në të gjithë territorin dhe u drejtohet të gjithë përdoruesve të sistemit gjyqësor, qoftë aktualë ose potencialë, pra një kategori që nuk është e përcaktuar dhe e përcaktueshme nominalisht, por që shihet në mënyrë abstrakte dhe në tërësinë e saj; ii. ajo përcakton kompetencat territoriale të gjykatave, duke parashikuar kështu rregulla të përgjithshme me karakter normativ; iii. efektet e saj nuk janë

shteruese. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se KLGJ-ja ka miratuar aktet e nevojshme për zbatimin e hartës së re gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se VKM-ja nr. 495/2022 ka karakter normativ dhe, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, shqyrtimi i pajtueshmërisë së saj me Kushtetutën përfshihet në juridiksionin kushtetues.

25. Për sa i përket natyrës së pretendimeve të parashtruara, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se lënda e referuar për shqyrtim nga kërkuesja, KSHH-ja, nuk prek probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë gjatë zbatimit VKM-ja dhe një akt me fuqi më të lartë juridike (ligji nr. 98/2016), çështje të cilat zgjidhen nga organet administrative zbatuese dhe më tej nga gjykatat e zakonshme. Sipas këtij subjekti, pretendimet e ngritura nga KSHH-ja janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 98/2016 dhe jo me kushtetutshmërinë e aktit, ndaj ajo duhej t'i drejtohej Gjykatës Administrative të Apelit në kuptim të neneve 7 dhe 10, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Edhe subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka vënë në dyshim juridiksionin e Gjykatës për shkak të natyrës ligjore të pretendimeve që kanë të bëjnë, në thelb, me respektimin e parashikimeve të ligjit nr. 98/2016.

26. Gjykata, referuar natyrës dhe përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, vëren se ato kanë të bëjnë me respektimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë përpara ligjit dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, për rrjedhojë, si pretendime me natyrë kushtetuese, i nënshtrohen kontrollit të kësaj Gjykate. Në përfundim, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i VKM-së nr. 495/2022 bën pjesë në juridiksionin kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

B. Për legjitimitimin e kërkesësve

27. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën për pajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe organizatat, të cilat, si subjekte të



kushtëzuara, duhet të justifikojnë interesin e tyre për çështjen e parashtruar.

28. Vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti i kushtëzuar që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së tij dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që përfshihen në qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 37, datë 1.12.2022; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Kërkuesja, Dhoma e Avokatisë, ka pretenduar se është e vetmja organizatë ku marrin pjesë detyrimisht të gjithë personat që ushtrojnë profesionin e avokatit. Duke qenë se harta gjyqësore ka krijuar pabarazi sociale jo vetëm ndaj publikut lidhur me aksesin në drejtësi, por edhe në raportet midis avokatit dhe klientit, ajo justifikon interesin e saj për t'iu drejtuar Gjykatës. Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë, me vendim unanim, por edhe pas konsultimeve me anëtarët në të gjitha dhomat vendore, ka vendosur bojkotin total të seancave gjyqësore dhe protestë paqësore para godinës ku ushtron veprimtarinë KLGJ-ja. Në këtë kuptim, kërkuesja ka pretenduar se ajo ka shteruar edhe mjetet juridike në dispozicion dhe në momentin që VKM-ja ka hyrë në fuqi i është drejtuar Gjykatës.

30. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave, KLGJ-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm, kanë kundërshtuar si legjitimitimin procedural, ashtu edhe atë substancial të kërkueses, Dhomës së Avokatisë. Sipas tyre, kërkesa është paraqitur nga kryetari, por mungon vendimmarrja e Këshillit të Përgjithshëm sipas nenit 27, shkronja "P", të ligjit nr. 55/2018. Në lidhje me legjitimitimin substancial ato kanë

pretenduar se referuar statutit dhe ligjit nr. 55/2018, VKM-ja nr. 495/2022 nuk lidhet drejtpërdrejt dhe as domosdoshmërisht me ndonjë prej detyrave ligjore ose statutore që ushtron ky subjekt dhe ky akt nuk ka vendosur asnjë rregull për mënyrën se si duhet të organizohen dhomat e avokatisë. Po kështu, kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 2.2.2023, kohë në të cilën VKM-ja nr. 495/2022 kishte prodhuar pasoja vetëm pjesërisht, ndaj për atë pjesë që lidhet me organizimin e gjykatave të shkallës së parë, kërkuesja nuk ka provuar interesin e saj aktual. Edhe në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë, sipas këtyre subjekteve të interesuara, Dhoma e Avokatisë nuk ka interes të drejtpërdrejtë dhe vetjak, pasi nuk mund të bëjë të vlefshme në emër dhe për llogari të saj të drejta kushtetuese të qytetarëve.

31. Gjykata vëren se kërkuesja, Dhoma e Avokatisë, është subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1, datë 8.5.2008. Sipas statutit, ajo është bashkim i anëtarëve aktivë dhe pasivë të dhomave vendore të avokatisë (*neni 1*) dhe ka për objekt të veprimtarisë garantimin e ushtrimit të profesionit dhe forcimin e pavarësisë së avokatit si një profesionist i lirë etj. Sipas nenit 26, të ligjit nr. 55/2018, organet drejtuese të Dhomës janë Këshilli i Përgjithshëm, Komiteti Drejtues dhe Kryetari. Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë vendimmarrës i Dhomës dhe, mes të tjerash, sipas nenit 27, pika 3, shkronja "P", të ligjit ushtron kompetencat për garantimin dhe mbrojtjen me të gjitha mjetet ligjore të të drejtave dhe interesave të avokatëve dhe të dhomave vendore të avokatisë, në raport me njëra-tjetrën dhe ndërmjet tyre e gjykatave, prokurorive dhe organeve publike. Kurse sipas nenit 29 të po këtij ligji, kryetari i Dhomës është autoriteti më i lartë përfaqësues në marrëdhëniet me të tretët, brenda dhe jashtë vendit, si edhe midis dhomave vendore të avokatisë dhe është njëkohësisht edhe kryetar i organeve drejtuese të saj. Referuar dispozitave të statutit, neni 30, pika 1, i tij parashikon se kryetari, përveç kompetencave që i jep ligji, ka të drejtë të përfaqësojë subjektin përpara çdo organi publik ose privat, si dhe përpara organeve gjyqësore apo proceduese që operojnë në të gjithë territorin, kurse sipas nenit 31, pika 2, kryetari detyrohet të ushtrojë të drejtën e përfaqësimit të avokatëve përpara të gjitha organeve shtetërore dhe atyre gjyqësore e proceduese, me



qëllim krijimin e raporteve të drejta e ligjore midis tyre dhe avokatëve në ushtrimin e profesionit.

32. Bazuar në këto parashikime, kryetari i Dhomës së Avokatisë, si një nga organet drejtuese të saj, është ai që e përfaqëson në marrëdhënie me të tretët, ndërkohë që këto akte nuk përmbajnë ndonjë parashikim të shprehur në lidhje me mënyrën ose formën për kundërshtimin e akteve në Gjykatën Kushtetuese. Edhe në praktikën e saj Gjykata nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin procedural të këtij subjekti, pavarësisht se cili nga organet drejtuese ka marrë nismën për t'iu drejtuar asaj (*shih vendimin nr. 37, datë 1.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Gjykata vlerëson se në aspektin formal kryetari i Dhomës legjitimohet t'i drejtohet asaj pa qenë e nevojshme paraqitja e ndonjë akti të organeve të tjera të këtij subjekti për të provuar vullnetin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

33. Në lidhje me legjitimitimin substancial të Dhomës së Avokatisë, Gjykata vëren se ajo i ka lidhur pretendimet për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të parimit të barazisë përpara ligjit me pasojat që sjell zbatimi i hartës së re gjyqësore në ushtrimin e veprimtarisë së avokatëve, duke e kufizuar deri në pamundësinë e ushtrimit të saj, të cilat përfshihen në ato çështje që ajo legjitimohet të mbrojë në gjykimin kushtetues. Për sa i përket pretendimit për cenimin e aksesit në drejtësi, sipas kërkuës, ai nuk ka të bëjë thjesht me të drejtën e palëve për të kërkuar zgjidhjen e konflikteve nga gjykata, por edhe me krijimin e kushteve dhe mundësive për t'u dëgjuar pala vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor në seancat gjyqësore. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se ushtrimi i veprimtarisë së avokatit është i lidhur drejtpërdrejt me aksesin e individit në gjykatë, duke qenë se ai vepron me kërkesë dhe për llogari të palëve që vënë në lëvizje gjykatën. Në këto kushte, për sa kohë që aksesit i individit në gjykatë prek në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe veprimtarinë e avokatëve, Dhoma e Avokatisë legjitimohet edhe në lidhje me këtë pretendim.² Për rrjedhojë, çështja e parashtruar përpara Gjykatës përfshihet në qëllimet e veprimtarisë së kërkuës, Dhomës së Avokatisë.

34. Subjekti i interesuar, KLGG-ja, ka pretenduar se në momentin e paraqitjes së kërkesës nga Dhoma e Avokatisë, VKM-ja nr. 495/2022 kishte prodhuar pasoja vetëm pjesërisht.

35. Gjykata vëren se VKM nr. 495/2022 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107, datë 21.7.2022, dhe sipas nenit 5 të saj ka hyrë në fuqi sipas këtyre përcaktimeve: a) riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 1, të këtij vendimi, më 1.5.2023; b) riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, sipas pikës 2 të këtij vendimi, më 1.2.2023; c) riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, më 1.7.2023. Gjykata vëren se pas miratimit të VKM-së nr. 495/2022 organet e përcaktuara prej saj, konkretisht KLGG-ja dhe KLP-ja, kanë filluar të marrin masat për zbatimin e hartës së re gjyqësore, duke miratuar aktet e nevojshme nënligjore, ndaj VKM-ja është pjesë e rendit juridik për sa kohë ka filluar të zbatohet dhe të sjellë efekte në këtë drejtim, duke bërë të sigurt edhe ardhjen e pasojave të tjera të pritshme.

36. Kërkuësja tjetër, KSHH-ja, është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 17/1, datë 12.1.1991, të ministrit të Drejtësisë dhe më pas me vendimin nr. 2/1, datë 19.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtyre vendimeve dhe përmbajtjes së nenit 2 të statutit, KSHH-ja është një organizatë jofitimprurëse që ka për qëllim dhe objekt të veprimtarisë, mes të tjerash, vëzhgimin e gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të minoriteteve dhe të komuniteteve të tjera, zbatimin e parimeve të shtetit ligjor, denoncimin e çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht etj. Për rrjedhojë, pretendimi i parashtruar nga ky subjekt në drejtim të kufizimit të së drejtës së aksesit të individit në gjykatë ka të bëjë me ato çështje që përfshihen në objektin e veprimtarisë së tij, ndaj provon interesin për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

37. Kërkuësit legjitimohen edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pasi kërkesa është paraqitur brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e VKM-së nr. 495/2022.

² Gjyqtarët Elsa Toska, Genti Ibrahimit dhe Marjana Semini votuan kundër legjitimitetit të kërkuës, Dhomës së Avokatisë, për pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë.



38. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, për sa i përket pretendimit për procesin e konsultimit publik për shkak se nuk plotësohet kushti ligjor i këshillimit, kërkesit e kanë lidhur me mosrespektimin e nenit 13, pika 3, të ligjit nr. 98/2016, por pa arritur të provojnë në nivel kushtetues cenimin për shkak të mënyrës se si është zbatuar ky kriter ligjor nga organet zbatuese të tij, në këtë rast KLGJ-ja dhe Ministria e Drejtësisë, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të hartës së re. Në lidhje me pretendimet e tjera për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuara respektivisht nga nenet 11 dhe 18 të Kushtetutës, si dhe së drejtës së aksesit, si element i së drejtës për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve kushtetues që lejojnë kufizimin e tyre, Gjykata vlerëson se hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike

39. Sipas kërkeses, Dhomës së Avokatisë, harta e re vendos kufizim të të ardhurave që mbrojtësit ligjorë mund të përfitojnë në rastet e ofrimit të shërbimit të avokatisë, krijon fenomenin e monopolizimit të tregut drejt qyteteve ku veprojnë gjykatat, si dhe cenon veprimtarinë e avokatëve që ushtrojnë profesionin në ato rrethe gjyqësore ku është vendosur mbyllja e tyre. Cenimi lidhet si me rritjen e kostos së shërbimit të avokatisë për shkak të largësive të gjykatave nga njësitë administrative ku kanë vendbanimin dhe ushtrojnë aktivitetin, ashtu edhe me uljen e interesit të publikut të këtyre njësive administrative për t'iu drejtuar gjykatave po për shkak të këtyre distancave. Ekzistenca e një gjykate të vetme të apelit, sikurse është ajo e apelit administrativ, ka rezultuar joefektive dhe ka shkaktuar pasoja negative afatgjata në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve në atë gjykatë. Draftimi është bërë në kushtet e emergjencës dhe nuk merr në konsideratë asnjë prej kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 98/2016, ndërkohë që ndarja e re gjyqësore ka eliminuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 17 e vijues të ligjit, që lidhet me krijimin e degëve të gjykatave. Zbatimi i këtij kriteri do të ruante balancat proporcionale të trajtimit të çështjeve gjyqësore, do të lehtësonte problemet sociale dhe shoqërore që ka krijuar hartimi i reformës ligjore dhe do të bënte të

mundur zhvillimin e proceseve gjyqësore pranë qendrave të qyteteve që nuk kanë gjykata të përhershme nëpërmjet trupave gjyqësore/gjyqtarëve me seli të përhershme pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

40. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se VKM-ja nr. 495/2022 nuk prek rregullimet në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit që parashikohen në ligjin nr. 55/2018 dhe statutin e Dhomës, pasi ajo nuk prek të drejtën për të lidhur kontrata dhe për të ndërtuar marrëdhënien avokat-klient. Avokatët e kanë zgjedhur tashmë profesionin dhe harta e re nuk ka asnjë ndikim në licencat e fituara dhe as nuk ndalon ushtrimin e së drejtës së mbrojtësve për të lidhur marrëveshje sipas ligjit për shpërbimin e caktuar, i cili mund të vendoset lirisht nga palët. Kufizimet në lirinë e veprimtarisë ekonomike mund të bëhen me ligj dhe për interes publik dhe një nga arsyet është mirëmenaxhimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet ofrimit të një drejtësie efektive dhe profesionale. Riorganizimi nuk e bën të pamundur ushtrimin e profesionit të avokatit, por ai synon garantimin e ngarkesës së barabartë në punë të gjyqtarëve që i përkasin të njëjtit juridiksion dhe nivel. Argumenti për rritjen e kostove është i pabazuar, pasi kostot e avokatit nuk përballohen prej tij dhe me rritjen e tyre do të rritet tarifa, por ky është një pretendim që nuk mund ta ngrenë avokatët.

41. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kjo liri nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo përfshin edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas saj të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët (*shih vendimet nr. 37, datë 1.12.2022; nr. 60, datë 31.7.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas pikës 3 të nenit 11 të Kushtetutës, kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Po ashtu, duke qenë se liria e



veprimtarisë ekonomike është sa parim themelor kushtetues, aq edhe e drejtë subjektive e individëve, i nënshtrohet edhe testit kushtetues të kufizimeve sipas nenit 17 të Kushtetutës.

42. Profesioni i avokatit është i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar në funksion të mbrojtjes së interesave individualë dhe kolektivë të subjekteve që ai përfaqëson. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 55/2018, ky profesion udhëhiqet nga parimet bazë të profesionalizmit, etikës, besnikërisë, integritetit dhe konfidencialitetit. Avokati ushtron veprimtarinë e tij, mes të tjerash, përmes përfaqësimit në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mos përfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare (*neni 4*). Për sa u përket mënyrave të shpërblimit të avokatit, neni 16 i ligjit parashikon se ato caktohen, mes të tjerash, edhe me marrëveshje ndërmjet avokatit dhe klientit. Në drejtim të respektimit të parimit të vetërregullimit ligjvënës i ka dhënë të drejtën Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë që, mes të tjerash, të përcaktojnë numrin e dhomave vendore të avokatisë dhe shpërndarjen territoriale të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në raport me numrin e avokatëve që bëjnë pjesë në to.

43. Gjykata vëren se me hartën e re gjyqësore, të miratuar me VKM-në nr. 495/2022, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë ulur në 13, nga numri i mëparshëm i tyre që ishte 22, gjykatat e apelit, gjashtë të tilla, janë bashkuar në një të vetme me seli në Tiranë, ndërsa gjykatat administrative të shkallës së parë, nga gjashtë të tilla, janë riorganizuar në dy gjykata me seli në Tiranë dhe Lushnjë. Ky riorganizim është një masë që ka sjellë një ulje të konsiderueshme të numrit të gjykatave. Sipas mendimit me shkrim të paraqitur nga Avokati i Popullit, kjo është ulja më e thellë në vitet e fundit, e parë edhe në raport me situatën në vendet e tjera të rajonit.

44. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 495/2022, *prima facie*, nuk ka për qëllim të përcaktojë ose ndryshojë rregullat për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe as të rregullojë apo ndryshojë rregullat e funksionimit të tregut ku veprojnë këto profesione të lira. Gjykata vlerëson të theksojë se në parim, në lidhje me profesionet e lira, shteti nuk ka detyrimin të sigurojë vendet e punës, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë, por duhet të mbetet garant i premisave që sigurojnë aksesin e tyre në një treg të lirë, duke

minimizuar barrierat kufizuese dhe penguese. Pavarësisht sa më sipër, për nga masa dhe shtrirja e tyre, ndryshimet që ka sjellë riorganizimi janë të tilla që kanë sjellë kufizim në ushtrimin e veprimtarisë nga ana e avokatëve, pavarësisht mënyrës se si janë organizuar ata në dhomat vendore të avokatisë. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse ky kufizim respekton kriteret kushtetuese të ndërhyrjes, pra nëse është bërë vetëm me ligj, për interes publik ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.

45. Në lidhje me *kriterin e parë të kufizimit*, “*vetëm me ligj*”, qëllimi i tij është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe për këtë shkak kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht organi më i lartë ligjvënës. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në çmim vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera. Rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është vetëm Kuvendi (*shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson nëse kufizimi është bërë me ligj dhe, në këtë kuptim, nëse materializimi në VKM-në nr. 495/2022 është bërë në përputhje me rezervën ligjore relative, sipas nenit 118 të Kushtetutës, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, rezerva ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 60, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në rastet kur objekt i kontrollit kushtetues janë akte nënligjore vlerësohet nëse vetë ligji e ka kufizuar të drejtën dhe, më pas, nëse këto akte nënligjore e kanë detajuar kufizimin sipas kushteve dhe parashikimeve të nenit 118 të Kushtetutës.



48. Ligji nr. 98/2016 ka parashikuar objektivat, parimet dhe kriteret për përcaktimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Sipas nenit 15 të tij këto kriterë kanë të bëjnë me ndarjen administrativo-territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit, si dhe ngarkesën në gjykata, eficiencën e tyre dhe të gjyqtarëve, burimet njerëzore, vendndodhjen e përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Bazuar në këto kriterë, ligji ka parashikuar se KLGJ-ja bën vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet dhe së bashku me ministrin e Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët, që miratohet më pas me vendim të Këshillit të Ministrave (*neni 13*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kufizimi në ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është vendosur nga ligji nr. 98/2016 dhe se VKM-ja nr. 495/2022 është miratuar në përputhje me delegimin ligjor për të bërë të zbatueshme parashikimet e mësipërme të ligjit nr. 98/2016. Në këto kushte është respektuar kriteri i parë i kufizimit, “vetëm me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

49. Për sa i përket *kriterit të dytë të kufizimit, për interes publik ose arsye të rëndësishme publike*, Gjykata ka theksuar se është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyeshme publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Gjykata vëren se sipas raportit të vlerësimit të grupit të punës të ngritur nga KLGJ-ja, si edhe referuar parashkrimeve të subjekteve të interesuara, harta e re ka synuar të japë zgjidhjen më të mirë në situatën me të cilën përballëj sistemi, veçanërisht në drejtim të kohëzgjatjes së proceseve tej afateve të arsyeshme, ngarkesës jo të barabartë në punë të gjyqtarëve dhe mungesës së specializimit të tyre në fushat përkatëse të së drejtës, për t’u përgjigjur

nevojave të qytetarëve për një drejtësi efektive dhe profesionale. Mungesa e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në gjykata, si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, solli nevojën e ndërhyrjes për shfrytëzimin eficient dhe maksimal të burimeve njerëzore. Qëllimi i miratimit të hartës së re ishte përballja me situatën aktuale, duke zgjidhur problematikat e evidentuara, si dhe sigurimi i një sistemi gjyqësor eficient që ofron drejtësi brenda afateve të arsyeshme. Krijimi i gjykatave me numër më të madh gjyqtarësh është konsideruar se do të sjellë normalizimin e ngarkesës së punës në gjykata, shpërndarjen e drejtë të çështjeve dhe rritjen e produktivitetit dhe eficiencës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se përmbushet edhe kriteri i dytë i kufizimit, ai për interes publik ose arsye të rëndësishme publike, që në rastin konkret qëndron në rritjen e efikasitetit dhe eficiencës së sistemit të drejtësisë dhe cilësisë së gjykimeve, si dhe garantimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore.

51. Në kushtet kur janë përmbushur dy kriteret e mësipërme të kufizimit, Gjykata vlerëson të analizojë edhe kriterin tjetër, atë të *proporcionalitetit të ndërhyrjes*, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t’i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Masat mund të jenë të shumëllojshme, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimet nr. 37, datë 1.12.2022; nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 18, datë 14.5.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Parimi i proporcionalitetit imponon evidentimin e nevojës reale të ndërhyrjes në të



drejtat individuale në një situatë konkrete (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Po kështu, ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Gjykata ka evidentuar se për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa nënkritere: i. nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Gjykata konstaton se sipas kërkuësës, Dhomës së Avokatisë, liria e veprimtarisë ekonomike është kufizuar për shkak të rritjes së kostove dhe shpenzimeve, çka ka sjellë edhe rritjen e tarifave të shërbimit, duke e bërë të vështirë, thuajse të pamundur, vijimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie për një pjesë të avokatëve, veçanërisht të atyre në qytetet ku janë shkrirë gjykatat.

55. Gjykata, për të vlerësuar proporcionalitetin e kësaj ndërhyrjeje çmon se duhet të vihen në balancë interesat e avokatëve, të përfaqësuar nga Dhoma e Avokatisë, nga njëra anë, dhe interesat për të siguruar, për individin, dhënien e një drejtësie eficiente dhe profesionale, nga ana tjetër. Në këtë drejtim duhet të vlerësohet nëse këto subjekte janë ngarkuar me një barrë ose peshë individuale tej masës apo shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi publik apo arsyeja publike.

56. Në analizë të nënkritereve të sipërcituara, Gjykata vëren se objektivat e përcaktuar nga ligjvënësi në ligjin nr. 98/2016, për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave janë garantimi i

aksesit në drejtësi, ulja e kostove, si dhe rritja e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimit. Ligji ka ngarkuar KLGJ-në si organin përgjegjës për vlerësimin e situatës aktuale, rivlerësim që kryhet çdo pesë vjet dhe ky organ propozon edhe rishikimin e organizimit gjyqësor nëse është i nevojshëm, pra nëse ai nuk respekton objektivat dhe parimet e përcaktuar nga ligjvënësi. Bazuar në këto parashikime ligjore, organet kompetente sipas këtij ligji kanë synuar që përmes hartës së re gjyqësore të zgjidhin problematikat e evidentuara në situatën aktuale në vendin tonë. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës, objektivi i synuar ka krijuar një nevojë mjaftueshmërisht të rëndësishme për të justifikuar kufizimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike.

57. Duke e lidhur riorganizimin me objektivin e synuar, Gjykata vlerëson se masa e marrë në rastin konkret është e domosdoshme. Referuar provave të paraqitura nga palët në gjykim dhe parashtrimeve të subjekteve të interesuara, organizimi i ri gjyqësor rezulton të jetë mjeti me të cilin mund të arrihet përmbushja e kërkesës për efikasitet dhe efikasitet të sistemit të drejtësisë. Gjykata çmon të theksojë se kërkuësja, Dhoma e Avokatisë, nuk ofroi ndonjë alternativë masash që të ishte më efikase, por edhe e mundshme dhe e arritshme, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin e propozimeve të bëra gjatë procesit të hartimit të hartës gjyqësore.

58. Po në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se u arrit të provohej në këtë gjykim se qëllimi i synuar nuk mund të arrihej me mjete të tjera. Për sa i përket ashpërsisë së këtyre mjeteve, Gjykata vëren se sipas nenit 6, të ligjit nr. 55/2018, avokati ushtron profesionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga dhoma vendore e avokatisë në të cilën bën pjesë, përpara çdo gjykate, prokurorie, gjykate arbitrazhi apo organi publik, në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me avokatë të tjerë të organizuar në studio avokatie. Gjykata konstaton se pavarësisht organizimit të avokatisë në dhoma rajonale, çdo avokati i njihet e drejta që të ofrojë shërbimin, të përfaqësojë e mbrojë çështje edhe jashtë dhomës rajonale në të cilën ai bën pjesë dhe ushtron veprimtarinë. Hapësirat ligjore dhe mënyra e organizimit dhe funksionit të shërbimit të avokatisë ndikojnë në zbutjen e efekteve që vijnë nga riorganizimi i gjykatave në një numër më të vogël se sa ai që ka qenë më parë. Për më tepër, zhvillimet e infrastrukturës rrugore, digjitalizimi dhe thjeshtimi i procedurave ligjore, si edhe mënyra e



caktimit të tarifave të përfaqësimit që bëhet me vullnetin e lirë të palëve, janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në zbutjen e pasojave të kësaj mase në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë së avokatit. Kjo mënyrë organizimi në 13 gjykata të shkallës së parë dhe një gjykatë apeli të juridiksionit të zakonshëm, si dhe dy gjykata të shkallës së parë të juridiksionit administrativ nuk duket si një masë më e ashpër se sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të synuar.

59. Ndërsa për sa i përket nënkriterit të përshtatshmërisë, Gjykata vlerëson se, sikundër u theksua edhe më sipër, në gjykim nuk u paraqitën argumente në drejtim të mosefektivitetit të riorganizimit gjyqësor si masë kufizuese. Për më tepër, Gjykata do ta analizojë në vijim këtë nënkriter të lidhur me pretendimin për kufizimin e së drejtës së aksesit të individit në gjykatë.

60. Për sa i përket pretendimit për ofrimin e shërbimit nga avokatët që përfshihen në skemën e ndihmës juridike falas, sipas mendimit me shkrim të paraqitur nga DNJF-ja, ata kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve të shërbimit dhe kompensimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u trajtuar me tarifa të njëjta si punonjësit e administratës publike kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës. Sipas këtij institucioni, për shkak të riorganizimit synohet hapja edhe e disa qendrave të reja të ndihmës juridike falas me qëllim lehtësimin e aksesit dhe të shërbimit.

61. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pavarësisht se për shkak të reduktimit të numrit të gjykatave ushtrimi i veprimtarisë ekonomike nga avokatët mund të bëhet më i vështirë, e lidhur kjo me rritjen e distancave fizike dhe të kohës, çka ndikon në rritjen e shpenzimeve dhe tarifave të shërbimit, këto pasoja nuk janë të tilla që të vendosin një barrë të tepruar për këto subjekte. Ndërhyrja në rastin konkret nuk cenon në mënyrë joproporcionale ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike.

62. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në kushtet që kufizimi në lirinë e veprimtarisë ekonomike është bërë në përputhje me kriteret e kufizimit, pra është bërë me ligj, për interes publik, si dhe nuk ka cenuar parimin e proporcionalitetit të

ndërhyrjes, pretendimi i kërkuarës, Dhomës së Avokatisë, është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e parimit të barazisë para ligjit³

63. Sipas kërkuarës, Dhomës së Avokatisë, avokatët që ushtrojnë profesionin në dhomat vendore të avokatisë (14 të tilla, me përjashtim të Tiranës) për të përballuar pasojat duhet të rrisin tarifat e shërbimit, ndërkohë që avokatët e dhomës së Tiranës mbajnë të njëjtat tarifa, duke hyrë kështu në një treg të pabarabartë. Për shkak të ndryshimit të tarifave ata do të përballen edhe me humbjen e klientelës dhe të besimit të këtyre të fundit, i cili është parimi bazë i një marrëdhënieje avokat-klient.

64. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se nuk është provuar dëmi real dhe i drejtpërdrejtë që VKM-ja sjell në veprimtarinë tregtare të anëtarëve të Dhomës së Avokatisë dhe se në çfarë mënyre dhe mase preken ata. Në lidhje me pretendimin se duhet të aplikohen tarifa të ndryshme, që aktualisht përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat, ato përcaktohen në marrëveshjen avokat-klient dhe jo nga akti i kundërshtuar, i cili nuk ndërhyr në diskrecionin e avokatëve dhe nuk ka se si të krijojë diferencim tek ata. Po kështu, gjykimi në apel nuk kërkon domosdoshmëri pjesëmarrjen e palës ose përfaqësuesit dhe gjykimi rishikues në apel, si rregull, përfundon me një seancë, çka nuk përbën rritje të ndjeshme të kostos së mbrojtjes. Veprimtaria gjyqësore nuk është shërbim primar, por fundor për qytetarin dhe mjeti i fundit kur mjetet e tjera janë shteruar dhe nuk ka marrë rezultatit e kërkuar. Ndaj afërsia e shërbimit duhet të jetë në balancë të drejtë me eficiencën dhe profesionalizmin e ofrimit të tij. Përcaktimi i kostos duke u bazuar vetëm në distancën fizike të gjykatës është i pasaktë, pasi kostoja varet nga faktorë të tjerë, si kompleksiteti i çështjes, kohëzgjatja e saj, kualifikimi i avokatit etj. VKM-ja nr. 495/2022, nuk ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve, pra të avokatëve të Dhomës Vendore Tiranë në raport me ata të dhomave të tjera, pasi të gjithë janë në kushtet kur mund ta ushtrojnë lirisht profesionin. Sipas subjekteve të interesuara, edhe nëse Gjykata konsideron se ka diferencim, përsëri nuk ka diskriminim, pasi arsyet objektive, qëllimet dhe

³ Gjyqtarja Marsida Xhaferllari votoi që ky pretendim të shihet i lidhur me pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike.



efektet në drejtim të interesit publik për një shërbim cilësor në dhënien e drejtësisë përbëjnë arsye legjitime dhe objektive për konfigurimin e hartës së re gjyqësore.

65. Sipas jurisprudencës kushtetuese parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata shqyrton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se e konstaton këtë fakt, vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Me qëllim që të arrijë në një përfundim të drejtë në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren, së pari, se në rastin konkret interesat që vihen përballë janë ato të avokatëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ato qytete ku gjykatat janë shkrirë sipas hartës së re, me të avokatëve në qytetet e tjera ku ka ende gjykata të shkallëve dhe juridiksioneve të ndryshme, veçanërisht me ata që ushtrojnë veprimtarinë në qytetin e Tiranës, ku ka tashmë selinë gjykata e vetme e apelit. Harta e re gjyqësore, e miratuar me VKM-në nr. 495/2022, ka riorganizuar gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në 13 të tilla, ato administrative të shkallës së parë në vetëm 2 të tilla, si dhe gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm në vetëm një të tillë, me seli në qytetin e Tiranës. Në këtë mënyrë, për shkak të shkrirjes së disa gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, ashtu edhe për shkak të shkrirjes së gjykatave të apeleve të juridiksionit të përgjithshëm në një të

vetme, avokatët që ushtrojnë veprimtarinë në ato qytete/bashki vendosen në një situatë të ndryshme nga avokatët e tjerë që ushtrojnë veprimtarinë në qytetet/bashkitë ku ndodhen selitë e gjykatave, për shkak të largësisë mes tyre dhe gjykatave, çka sjell pasoja në rritjen e shpenzimeve të përfaqësimit, pra në kostot dhe tarifat e shërbimit. Këto grupime, që para miratimit të hartës së re kanë qenë në kushte të njëjta, aktualisht janë vendosur në kushte jo të barabarta, çka ka krijuar një trajtim të diferencuar mes tyre, i bazuar mbi shkaqe ekonomike, që lidhet me vështirësitë ose situatën ekonomike me të cilën përballen ata avokatë që ushtrojnë profesionin dhe organizohen në qytetet ku janë shkrirë gjykatat. Për rrjedhojë, duhet të vlerësohet nëse në rastin konkret ka një përligje të arsyeshme dhe objektive që justifikon këtë trajtim të diferencuar të këtyre subjekteve.

67. Gjykata ka theksuar më sipër, në drejtim të pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, se harta e re gjyqësore është miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave dhe kriterëve të ligjit nr. 98/2016 dhe për interes publik, i identifikuar në nevojën për të garantuar eficiencën e sistemit të drejtësisë. Pavarësisht se kjo masë sjell një diferencim mes avokatëve, në varësi të qytetit ku ata ushtrojnë veprimtarinë, duke e parë atë të lidhur me qëllimin që synohet të arrihet, konsiderohet se në rastin konkret ka një përligje të arsyeshme dhe objektive, që ka si qëllim garantimin jo vetëm të rritjes së cilësisë, por edhe respektimin e afateve ligjore të shqyrtimit të çështjeve, në përputhje me të drejtën për proces të rregullt, çka ka qenë nga problematikat kryesore që ka synuar të zgjidhë harta e re gjyqësore. Kjo masë është objektivisht e justifikuar, për sa kohë që diferenca në trajtim ndjek edhe një raport të drejtë mes mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe respektimit të lirisë individuale, dhe mjetet e përdorura në këtë rast janë proporcionale me qëllimin që është synuar të arrihet.

68. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarës, Dhomës së Avokatisë, për cenimin e parimit të barazisë para ligjit është i pabazuar.

C.3. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

69. Sipas kërkuarësve, është cenuar e drejta e aksesit në kundërshtim me kriteret e ndërhyrjes sipas nenit 17 të Kushtetutës. Në rastin konkret nuk respektohet kriteri i kufizimit me ligj, pasi edhe pse VKM-ja ka dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.



98/2016, nuk ka respektuar garancitë e parashikuara në nenet 13–15 të tij. Vlerësimi i hartës së re nuk analizon varfërinë në vend, cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, aksesin e grupeve të disavantazhuara ekonomikisht dhe as ngarkesën në gjykata në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe ato në shqyrtim. Gjykata e apelit vepron në raste të caktuara edhe si gjykatë e shkallës së parë, ndërkohë që mungojnë statistikak për numrin e çështjeve që janë shqyrtuar vetëm në dhomën e këshillimit ose bazuar në një ose disa seanca apo për pjesëmarrjen e palëve. Është në diskrecion të palëve ndërgjyqëse të vlerësojnë nëse dëshirojnë të jenë të pranishme në seancë gjyqësore, pavarësisht nëse kanë ose jo mbrojtës. Kufizimi nuk respekton parimin e proporcionalitetit, pasi nuk është një masë e përshtatshme dhe e domosdoshme për arritjen e objektivit të dëshiruar. Ajo synon në mënyrë jo të ekuilibruar rritjen e efciencës së sistemit gjyqësor dhe shpejtësisë së gjykimit, duke mos peshuar me kujdesin e duhur aksesin në drejtësi, që kërkon, mes të tjerash, afërsinë e qytetarit me gjykatën. Harta e re bazohet në numrin faktik të gjyqtarëve, ndërkohë që neni 15, pika 4, i ligjit nr. 98/2016, vendos kufij minimalë të numrit të gjyqtarëve, të kushtëzuar nga nevoja për efciencë dhe specializim në gjykata. Ajo ka sjellë vonesa dhe efekte të ngadalshme në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike dytësore ndaj kategorive përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017. Po kështu, kufizimet e së drejtës së aksesit tejkalojnë ato të parashikuara nga KEDNJ-ja, pasi objektivat dhe kriteret e ndjekura nga KLGJ-ja dhe Ministria e Drejtësisë për riorganizimin gjyqësor nuk respektojnë plotësisht garancitë e ligjit nr. 98/2016, duke vënë në pikëpyetje standardet e gjykatës së caktuar me ligj dhe duke sjellë cenimin e thelbit të së drejtës së aksesit për njerëzit dhe grupet në nevojë apo pamundësi ekonomike.

70. KSHH-ja ka paraqitur edhe një dokument që përmban të dhënat e monitorimit të kryer prej saj në disa qytete ku më parë ka pasur gjykata të apelit, sipas të cilit, nga analiza e të dhënave statistikore ka rezultuar se kostot e proceseve gjyqësore janë rritur ndjeshëm. Sipas këtij monitorimi, reformimi nuk është mirëpritur nga qytetarët për shkak të pasojave negative si në plan financiar, në rritjen e ndjeshme të kostove, ashtu edhe për shkak të distancës, kushteve infrastrukturore të papërshtatshme dhe një sërë efektesh të tjera negative që ndikojnë në mungesën

e aksesit në drejtësi. Në vijim të ankesës së paraqitur nga disa banorë të rrethit të Matit, KSHH-ja ka ndërmarrë një mision monitorimi në këtë zonë, ku ka evidentuar problematikat e transportit për mbulimin e të gjithë zonës, nga fshatrat dhe njësitë administrative në drejtim të qendrës së qytetit dhe anasjelltas, mungesën e infrastrukturës së përshtatshme rrugore, kostot e larta të transportit, si dhe problematikat me demokracinë sociale dhe çështjet e rendit e sigurisë publike. Kërkuesja ka konstatuar, nga verifikimi në terren i distancës dhe kohës së udhëtimit, kushteve dhe mjeteve të transportit, se përlllogaritja për distancat dhe kohën maksimale të udhëtimit nuk është e saktë.

71. Gjykata vëren, gjithashtu, se Avokati i Popullit në mendimin e tij me shkrim është shprehur se zbatimi i hartës së re nuk e përmirëson aksesin, por e cenon atë, duke sjellë rritjen e kostove për qytetarët dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Harta e re nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka adresuar nevojat e qytetarëve, veçanërisht të kategorive vulnerabël, shtetasve të privuar nga liria etj., për të garantuar aksesin e tyre në drejtësi, çka do të ndikojë në uljen e mëtejshme të besimit në drejtësi, ndaj duhet të rishikohet.

72. Subjektet e interesuara, kanë prapësuar mbi të njëjtat argumente, se aksesin në drejtësi nuk mund të reduktohet vetëm në një element që lidhet me distancën me gjykatën, por ai lidhet edhe me elemente të tjera, si afati i arsyeshem, cilësia dhe profesionalizmi, efienca e gjykatave etj. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit, harta e re ka pasur qëllim shmangien e problematikave të hasura, pasi harta në fuqi nuk përmbushte objektivat, kriteret dhe parimet e parashikuara nga nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 98/2016. Ajo ka një qëllim të përligjur, që është riorganizimi i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore për të krijuar një ekuilibër të objektivave të përcaktuar në nenin 14 të ligjit. Krijimi i një gjykate apeli mundëson evadimin sa më të shpejtë të çështjeve gjyqësore dhe trajtimin me profesionalizëm, çka do të sjellë edhe unifikim të praktikave gjyqësore. Edhe pse nuk është argumenti kryesor, me mungesat e theksuara të gjyqtarëve të apelit zgjidhja e vetme e pranueshme ishte krijimi i një gjykate të vetme për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe për të sjellë barazi në dhënien e drejtësisë. Në gjykatat e mëparshme të apelit do të funksionojnë zyrat e shërbimit për qytetarët, në mënyrë që ata të marrin informacion, të paraqesin



kërkesa me shkrim dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për gjykimin, si dhe të marrin kopje të vendimeve dhe akteve gjyqësore. Sipas subjekteve të interesuara, harta gjyqësore nuk është përfundimtare dhe e parikthyeshme, pasi sipas nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, KLGJ-ja bën vlerësimin e organizimit të paktën çdo 5 vjet, ndaj nëse ajo nuk do t'u përgjigjet pritshmërive mund të rishikohet. Kurse në lidhje me ndihmën juridike falas nga shteti, interesi i avokatëve për të qenë pjesë e listës së ndihmës juridike dytësore është rritur, sipas të dhënave për vitet 2022 dhe 2023.

73. Gjykata thekson se, sipas standardeve të saj jurisprudenciale, ajo mban në konsideratë prezumimin e pajtueshmërisë së aktit normativ me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar argumentet e parashtruara duhet të jenë bindëse, për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet e aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Gjykata vëren se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Rregullat që disiplinojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj barriere që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente. Çështja e administrimit të duhur të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në shqyrtimin e proporcionalitetit të një kufizimi të aksesit në gjykatë merret në konsideratë nëse rregullat

procedurale e pengojnë individin të gëzojë një akses të tillë dhe nëse për këtë shkak ai është detyruar të mbajë një barrë të tepruar.

75. Sipas GJEDNJ-së, natyra praktike dhe efektive e së drejtës së aksesit mund të cenohet, mes të tjerash, nga kostot e procedurave të lidhura me aftësinë financiare të individit (*shih García Manibardo kundër Spanjës, datë 15 shkurt 2000, §§ 38–45*); tarifat gjyqësore të larta (*shih Georgel dhe Georgeta Stoicescu kundër Rumanisë, datë 26 korrik 2011, §§ 69–70*); çështjet që kanë të bëjnë me afatet kohore (*shih Melnyk kundër Ukrainës, datë 28 mars 2006, § 26*); çështjet që kanë të bëjnë me juridiksionin (*shih Association Burestop 55 dhe të tjerë kundër Francës, datë 1 korrik 2021, § 71*); pengesat procedurale që ndalojnë ose kufizojnë mundësitë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih Lupaş dhe të tjerë kundër Rumanisë, datë 14 dhjetor 2006, §§ 64–67*).

76. Gjykata vlerëson, fillimisht, nëse në rastin konkret riorganizimi gjyqësor ka sjellë një kufizim në të drejtën e aksesit të individit në gjykatë.

77. Gjykata konstaton se riorganizimi i rretheve gjyqësore, duke ulur numrin e gjykatave të juridiksionit të zakonshtëm dhe atij administrativ të shkallës së parë dhe duke shkrië gjykatat e apelit në një të vetme, është një masë që sjellë pasoja të drejtpërdrejta edhe në drejtëm të së drejtës për akses në gjykatë. Kjo reflektohet si në drejtëm të rritjes së distancës mes gjykatës dhe individit, ashtu edhe në drejtëm të mundësisë së tij për të vënë në lëvizje gjykatën, për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe kostove të përfaqësimit me avokat, pra të procesit gjyqësor, të cilat u ngarkohen palëve në proces. Në këtë mënyrë harta e re gjyqësore përbën kufizim të aksesit të individit në gjykatë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përmes përfaqësuesit ligjor të zgjedhur ose të caktuar.

78. Për rrjedhojë, Gjykata do të ndalet, në vijim, në vlerësimin nëse ky kufizim plotëson kriteret kushtetuese të ndërhyrjes, sipas nenit 17 të Kushtetutës, duke iu referuar të njëjtave standarde kushtetuese të cituara më sipër në analizën e pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Në këtë drejtëm, për sa kohë që më sipër është arritur në përfundimin se masa e kundërshtuar plotëson kriteret e kufizimit vetëm me ligj dhe të interesit publik që justifikon ndërhyrjen, Gjykata do e vlerësojë çështjen vetëm në drejtëm të respektimit të parimit të proporcionalitetit.



79. Duke pasur parasysh testin që analizohet sipas jurisprudencës kushtetuese për të vlerësuar proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata do të ndalet në vijim në vlerësimin e nënkritereve të nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së kësaj mase në drejtim të së drejtës së aksesit. Gjithsesi, Gjykata thekson se ajo nuk ka kompetencë të analizojë nëse masa e ndërhyrjes është më e drejta dhe më e duhura për arritjen e qëllimit të synuar, por detyrë e saj është të vlerësojë nëse kufijtë e jashtëm të hapësirës vlerësuese të ekzekutivit janë kapërcyer ose jo në nxjerrjen e aktit normativ nënligjor.

80. Për sa i përket nënkriterit të nevojës, në rastin konkret duhet të ketë një lidhje të arsyeshme mes kufizimit dhe gjendjes që kërkon ndërhyrje. Gjykata ka konstatuar edhe më sipër se efektet e reformës në drejtësi sollën një problematikë të përgjithshme të lidhur me uljen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar, ashtu edhe vonesave të paarsyeshme në gjykim, në tejkalim të çdo afati ligjor dhe në mungesë të mekanizmave zhblllokues të kësaj situatë. Kjo solli nevojën e ndërhyrjes për të siguruar një sistem funksional, rritjen e efikasitetit përmes menaxhimit dhe shpërndarjes së burimeve, ashtu si edhe garantimin e aksesit në gjykatë, që, mes të tjerash, në aspektin substancial, i garanton individit edhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura. Për rrjedhojë, situata faktike e evidentuar në kohën e miratimit të kësaj mase bën të qartë ekzistencën e nevojës për të vepruar edhe me një lloj urgjence për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të evidentuar tashmë prej saj. Riorganizimi gjyqësor ka qenë dhe i diktuar nga rrethana të jashtëzakonshme, situatë që kishte nevojë të rregullohej dhe zgjidhej me një masë të po kësaj natyre.

81. Gjykata vlerëson se organizimi i ri i rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale ka synuar arritjen e objektivave të ligjit nr. 98/2016, që nuk arriheshin nga organizimi i mëparshëm dhe që kanë të bëjnë me garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat, uljen e kostove, me qëllim përdorimin efikas të burimeve, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe performancës së duhur të shërbimeve. Sipas raportit të vlerësimit të grupit të punës, harta e re është propozuar bazuar mbi të dhëna statistikore dhe metodologjia e ndjekur ka konsistuar në studimin e popullsisë, ngarkesës së

çështjeve për gjyqtarë dhe distancës midis qytetarëve dhe gjykatave. Ajo është vlerësuar se përmbush objektivat e synuar në drejtim të uljes së numrit të çështjeve të pashqyrtuara, përfundimin e proceseve gjyqësore në kohë më të shpejtë, ngarkesën e njëjtë mes gjyqtarëve, specializimin e gjyqtarëve, si dhe unifikimin e praktikave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe në lidhje me të drejtën e aksesit, ky objektiv ka krijuar nevojën mjaftueshmërisht të rëndësishme për të justifikuar kufizimin.

82. Në drejtim të kriterit të domosdoshmërisë, në vlerësimin e Gjykatës kufizimi është jokushtetues nëse provohet se ka mjete të tjera të disponueshme që do të ishin në mënyrë të qartë efektive për arritjen e qëllimit, por, në të njëjtën kohë, edhe më pak kufizuese të të drejtave dhe lirive themelore. Gjatë gjykimit, subjektet e interesuara arritën të provojnë se morën në konsideratë disa alternativa dhe, në analizë përfundimtare, kjo formë organizimi gjyqësor ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur situatën me të cilën po përballlej sistemi dhe vetë përdoruesit e tij, nga njëra anë, dhe për të garantuar objektivat dhe parimet e ligjit, nga ana tjetër. Në lidhje me mundësitë reale për të miratuar modele të tjera të organizimit, siç janë trupat lëvizës/shëtitës apo krijimi i më shumë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga subjekti i interesuar, KLGJ-ja, u parashtrua para Gjykatës se jo vetëm që burimet njerëzore e bënë të pamundur një zgjidhje të ndryshme nga ajo e miratuar, por kjo nuk do të ishte as një masë e eficiente dhe nuk do të garantonte përmbushjen e objektivave që synoheshin të arriheshin. Për rrjedhojë, referuar akteve të administruara në proces dhe të dhënave e informacioneve që ato përmbajnë, nuk u evidentua ndonjë zgjidhje tjetër e organizimit gjyqësor që të mund të ishte në të njëjtën mënyrë efektive për përmbushjen e qëllimit të synuar. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se masa e kundërshtuar plotëson edhe kërkesën e të qenit e domosdoshme.

83. Ndërsa për sa i përket nënkriterit të përshtatshmërisë, masa e ndërmarrë si kufizuese e së drejtës duhet të sjellë efektin e duhur dhe të realizojë synimin për të cilin është përzgjedhur. Në këtë kontekst merr rëndësi analiza e procesit në tërësi dhe e fakteve konkrete. Gjykata, referuar të dhënave të disponueshme nga palët në gjykim, vlerëson se nuk vërehet dekurajimi i përdoruesve për t'iu drejtuar sistemit gjyqësor dhe nuk është provuar që



riorganizimi i rretheve gjyqësore të ketë qenë barrierë në këtë drejtim, pavarësisht pretendimit të kërkuesve për rritjen e tarifave në atë masë që e cenon në thelb aksesin e qytetarit në gjykatë. Të dhënat statistikore të paraqitura në gjykim nga subjekti i interesuar, KLGJ-ja, që i referohen së njëjtës periudhë kohore përpara dhe pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, janë të krahasueshme dhe tregojnë se nuk ka pasur regres në drejtim të aksesit në gjykatë, pra në drejtim të kërkesave të paraqitura (padi apo ankime në gjykatat më të larta). Këto të dhëna janë tregues të faktit se kjo mënyrë organizimi, pavarësisht kohës së nevojshme për ristrukturimin, nuk ka sjellë pengesa në drejtim të aksesit efektiv, ashtu edhe në drejtim të zhvillimit të proceseve gjyqësore dhe gjykimit të çështjeve. Edhe pse koha së cilës i referohen këto të dhëna statistikore nuk është shumë e gjatë, ato janë të mjaftueshme për Gjykatën për të arritur në përfundimin se nuk ka të dhëna për dekurajimin e individit për t'iu drejtuar sistemit gjyqësor.

84. Për më tepër, Gjykata vëren se, me qëllim sigurimin e aksesit, janë parashikuar edhe masa lehtësuese, të tilla si: krijimi i degëve të gjykatave, që sipas nenit 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 98/2016, i referohet nënndarjes gjeografike të gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, e cila përbën një njësi administrative me gjykatën; funksionimi i Zyrave të Shërbimit. Degët e përhershme e ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme jashtë selive kryesore të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, kurse ato të përkohshme në intervale kohore të rregullta jashtë selive kryesore të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Ndonëse këto degë të gjykatave ende nuk janë funksionale dhe sipas subjektit të interesuar, KLGJ-së, me normalizimin e situatës mund të vendoset hapja e tyre me përparësi në ato njësi administrative në të cilat ka pasur më parë gjykatë të shkallës së parë, parashikimi ligjor për krijimin e tyre është një element që vlerësohet se rrit aksesin në gjykatë. Ndërkohë, Zyrat e Shërbimit janë struktura të ngritura dhe që funksionojnë pranë godinave të disa prej gjykatave të suprimuara, me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative. Pranë tyre mund të paraqiten kërkesa të ndryshme, si kërkesëpadi dhe akte të tjera procedurale, ankime e kundërankime, rekurse e kundërrekurse, kërkesa për

informacion për çështjet e regjistruara në gjykatë, kërkesa për përshpejtim etj. Përdorimi i godinave ekzistuese dhe detyrat që ushtrojnë nëpunësit e këtyre zyrave, që janë ato të sekretarit gjyqësor për veprime që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore, i kanë mundësuar individit qasje më të lehtë drejt informacionit dhe marrje të ndihmës së nevojshme për këto veprime administrative.

85. Në drejtim të ndihmës juridike falas, Gjykata vëren se sipas DNJF-së interesi i avokatëve që të jenë pjesë e listës së ndihmës juridike falas nuk ka rënë, përkundrazi është në rritje vit pas viti. Kurse për sa u përket viktimave të dhunës, Gjykata vëren se ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ka parashikuar hapësirat dhe mundësitë në drejtim të mjeteve ligjore, përfshirë edhe kërkesëpadinë, që sigurojnë mbrojtjen e viktimave të kësaj kategorie, ashtu edhe aksesin në çdo organ/institucion, përfshirë gjykatën, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të vetë viktimës.

86. Në lidhje me aksesin në gjykatën e apelit, Gjykata vëren se edhe pse sipas organizimit të ri gjyqësor gjykatat e apelit janë shkërrë nga gjashtë ekzistuese në një të vetme, ajo e gjen të drejtë pretendimin e subjekteve të interesuara se në këtë gjykim, sipas parashikimeve të reja procedurale, kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë vetëm brenda kufijve të ankimit dhe në të nuk mund të paraqiten kërtime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementet e padisë (*neni 465, pikat 1 dhe 4, i KPC-së*). Ankimi i njoftohet palës tjetër në mënyrë që ajo të paraqesë kundërankim, ndërkohë që referuar dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin në apel, paraqitja e palëve është fakultative dhe gjykata mund ta shqyrtojë çështjen në mungesë të tyre, përveç rasteve të parashikuara nga neni 461 i KPC-së, pa sjellë mosparaqitja pasoja që kufizojnë aksesin në gjykim. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se aksesin e individit në këtë gjykim, për shkak të natyrës së tij, mund të sigurohet edhe përmes paraqitjes së dokumenteve.

87. Gjykata vlerëson të theksojë se sistemi gjyqësor ka nevojë për më shumë kohë për të mundësuar evidentimin e efekteve të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Në këtë situatë, një qëndrim i ndryshëm, në mungesë të të dhënave që provojnë se kufizimi në të drejtën e aksesit është më negativ se sa pasojat pozitive të pritshme, do të sillte efekte më të rënda në të drejtat e qytetarëve, pasi do i përballte



ata sërish me një sistem drejtësie jo funksional të shkaktuar nga periudha tranzitore e nevojshme për riorganizimin. Edhe kërkesja KSHH-ja, e pyetur nga Gjykata në seancë plenare për hipotezën e shfuqizimit të hartës në këtë moment që ajo ka filluar të zbatohet tërësisht dhe ka sjellë efekte, është shprehur se me qëllim që të mos përkeqësohet situata si rezultat i shfuqizimit tërësor, do të duhej të parashikohej që vendimi të mos prodhojë pasoja në mënyrë të menjëhershme, por të hyjë në fuqi në një datë të mëvonshme.

88. Gjykata vëren se ligji ka parashikuar edhe mekanizma mbrojtës për të evituar impaktin e kundërt me atë që kërkohet të arrihet dhe që ka të bëjë me shtrirjen e kufizimeve që mund të sjellë organizimi i rretheve gjyqësore. Ligji e ka kufizuar kohëzgjatjen e masës duke lejuar rishikimin e saj, duke lejuar ndryshimin në varësi të analizës dhe kritereve mbi të cilat miratohet ajo. Për rrjedhojë, harta e re gjyqësore ka në vetvete efekte të kufizuara në kohë. Sipas pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, KLGJ-ja bën vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet. Afati dhe mundësia e rishikimit të saj të paktën çdo pesë vjet bën që vendimi për organizimin gjyqësor të mos konsiderohet i pandryshueshëm. I takon KLGJ-së, si organi që bën vlerësimin sipas ligjit, që pas kalimit të afatit të nevojshëm për evidentimin e efekteve të riorganizimit të gjykatave, të verifikojë dhe analizojë mundësinë e kalimit në një skemë jo me një gjykatë të vetme apeli ose me më shumë gjykata administrative të shkallës së parë, ose për vendosjet e tyre nga pikëpamja gjeografike, duke marrë masat e nevojshme që kjo të mos afektojë dhe prejë situatën e të drejtave të individëve. KLGJ-ja ka detyrën të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme pasojat dhe efektet e këtij riorganizimi, duke vlerësuar mundësinë e riformatimit të hartës gjyqësore edhe në një afat më të shpejtë, nëse kjo konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme.

89. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në balancimin e interesave është respektuar interesi publik i së mirës së përgjithshme, nga njëra anë, me kufizimin e së drejtës së aksesit, nga ana tjetër. Duke vënë në balancë pasojat që synon zbatimi i hartës së re gjyqësore, që lidhen me të drejtën e individit për efikasitet, efikasitet dhe cilësi në dhënien e shërbimit të drejtësisë, me pasojat në të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, Gjykata arrin në përfundimin se kjo

ndërhyrje nuk cenon parimin e proporcionalitetit. Në krahasimin e këtyre pasojave është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se individët kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën kushtetuese për akses në gjykatë pavarësisht efekteve të riorganizimit gjyqësor, të cilat, në thelb, nuk e kanë bërë të pamundur ushtrimin e kësaj të drejte.

90. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar.

91. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë para ligjit dhe së drejtës së aksesit në gjykatë janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.12.2023.

Shpallur më 6.2.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Anëtarë pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes me kërkesë Dhomën e Avokatisë dhe KSHH-në, me objekt shfuqizimin e VKM-së nr. 495/2022, si të papajtueshme me Kushtetutën, edhe pse ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, qasja ime është e ndryshme nga shumica,



pasi në vlerësimin tim kërkesa duhet të ishte rrëzuar për shkak të mungesës së juridiksionit të Gjykatës për gjykimin e saj. Për rrjedhojë, në vijim, do të parashtroj argumentet mbi të cilat mbështes qëndrimin tim.

2. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se një akt me karakter normativ vendos norma të përgjithshme sjelljeje me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh. Akti normativ është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij. Për sa i përket aktit individual, ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 59, datë 23.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Shumica ka vlerësuar se Gjykata ka juridiksion për shqyrtimin e këtij akti, pasi VKM-ja nr. 495/2022: i. zbatohet në të gjithë territorin dhe u drejtohet të gjithë përdoruesve të sistemit gjyqësor, qoftë aktualë ose potencialë, pra një kategorie që nuk është e përcaktuar dhe e përcaktueshme nominalisht, por që shihet në mënyrë abstrakte dhe në tërësinë e saj; ii. ajo përcakton kompetencat territoriale të gjykatave, duke parashikuar kështu rregulla të përgjithshme me karakter normativ; iii. efektet e kësaj VKM-je nuk janë shteruese dhe në këtë kuptim, KLGJ-ja ka miratuar aktet e nevojshme për zbatimin e hartës së re gjyqësore (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

4. Në ndryshim nga qëndrimi i arritur nga shumica vlerësoj se VKM-ja nr. 495/2022, nuk plotëson kriteret që përcaktojnë natyrën normative të aktit, përkundrazi është një akt me karakter individual, shqyrtimi i të cilit nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

5. Fillimisht dua të vë në dukje se deri në miratimin e ligjit nr. 98/2016, i cili ka parashikuar se organizimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave bëhet me vendim të Këshillit

të Ministrave mbi propozimin e përbashkët të KLGJ-së dhe ministrit të Drejtësisë, organizimi i gjykatave dhe i kompetencave tokësore të tyre caktoheshin me dekret të Presidentit të Presidentit të Republikës. Vetëm fakti që kjo kompetencë i është kaluar tashmë Këshillit të Ministrave, për shkak të mënyrës se si është konceptuar dhe organizuar sistemi i drejtësisë dhe organet e tij, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar natyrën e aktit. Edhe Gjykata ka theksuar se në shqyrtimin e natyrës së aktit nuk duhet ta analizojë atë duke iu referuar thjesht emërimit zyrtar (VKM, VKB, urdhër apo udhëzim) ose bazës juridike të referuar, por duke shqyrtuar objektin dhe përmbajtjen e aktit (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për sa u përket kriterëve që përcaktojnë natyrën e aktit të kundërshtuar, vlerësoj se VKM-ja nr. 495/2022, për nga objekti dhe çështjet që rregullon, nuk përmban rregulla të përgjithshme me natyrë normative, por synon të rregullojë një situatë konkrete, që është mënyra e organizimit të rretheve gjyqësore, duke qenë shteruese edhe në drejtim të efekteve të saj. Ajo rregullon një marrëdhënie konkrete (riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave) dhe ka qëllim krijimin e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës dhe jo përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt. Riorganizimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave nuk përcakton subjektet të cilave u drejtohet, por përcakton vetëm aspektet organizative të pushtetit gjyqësor për të ardhmen. Pavarësisht se rrethet gjyqësore janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, ajo nuk sjell rregulla të përgjithshme të sjelljes, të cilat rregullohen nga aktet ligjore në fuqi që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e çdo personi që synon dhe që vendos t'i drejtohet gjykatës, pavarësisht se ku ndodhet ajo, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete. Edhe në drejtim të efekteve VKM-ja nr. 495/2022 ka karakter shterues, pasi efektet e saj kanë përfunduar tashmë dhe ajo nuk sjell më pasoja. Fakti që për shkak të kësaj VKM-je për organe të tjera si KLGJ-ja apo KLP-ja kanë lindur detyrime për miratimin e akteve përkatëse nuk lidhet me natyrën normative të aktit të kundërshtuar, por me detyrimet që këto organe, secili prej tyre, kanë nga ligji nr. 98/2016.

7. Në vlerësimin tim, VKM-ja nr. 495/2022 i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm disa



subjekteve individualisht të përcaktuara; i referohet një fakti konkret dhe jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, pra i jep zgjidhje një çështjeje konkrete dhe përbën bazë për një veprimtari specifike/konkrete; efektet e saj janë shteruese me rregullimin e çështjes konkrete që ka për objekt.

8. Një argument tjetër po kaq i rëndësishëm ka të bëjë me natyrën e përkohshme të hartës gjyqësore, në kushtet që sipas nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, parashikohet se vlerësimi i organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave bëhet nga KLGJ-ja të paktën çdo pesë vjet. Edhe vetë shumica ka pranuar jo vetëm karakterin e përkohshëm të hartës gjyqësore, por ka vënë theksin në detyrimin e KLGJ-së që të ndjekë zbatimin e saj dhe të marrë masa për rishikim edhe para përfundimit të këtij afati (*shih paragrafin 88 të vendimit*). Parimi i sigurisë juridike, si një ndër elementet më thelbësore të parimit të shtetit të së drejtës, kërkon që rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të këtij parimi, Gjykata nuk mund të niset nga prezumimi se një rregullim me karakter normativ është i paqëndrueshëm dhe të pranojë rishikimin e tij periodikisht, përkundrazi ajo niset nga prezumimi i pandryshueshmërisë së akteve normative dhe stabilitetit të sistemit, ndërkohë që ndryshimet janë të pranueshme vetëm nëse arrihet të argumentohet në nivel kushtetues se ato kanë synuar përmirësimin e gjendjes juridike.

9. Për sa më sipër, VKM-ja nr. 495/2022 është një akt individual dhe, si i tillë, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ndaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës për këtë shkak.

Anëtar: Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga Dhoma e Avokatisë dhe KSHH-ja, me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të VKM-së nr. 495/2022, jam kundër qëndrimit të shumicës për atë pjesë që ka vlerësuar se është i pabazuar pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të qytetarit në gjykatë. Në mbështetje të nenit

132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tim.

2. Shumica ka pranuar se VKM-ja nr. 495/2022 ka kufizuar aksesin e individit në gjykatë, ndaj është ndalur në vlerësimin nëse ky kufizim plotëson kriteret kushtetuese të ndërhyrjes sipas nenit 17 të Kushtetutës. Duke qenë se kriteret e kufizimit vetëm me ligj dhe të ekzistencës së interesit publik janë konsideruar të përmbushura në analizën që i është bërë pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, shumica ka analizuar hollësisht respektimin e parimit të proporcionalitetit (*shih paragrafin 78 të vendimit*). Në këtë drejtim, sipas shumicës, janë plotësuar nënkriteret e nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë. Ajo ka vlerësuar se situata faktike e evidentuar në kohën e miratimit të kësaj mase bën të qartë ekzistencën e nevojës për të vepruar edhe me një lloj urgjence për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të evidentuar tashmë prej saj. Organizimi i ri i rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale ka synuar arritjen e objektivave të ligjit nr. 98/2016, që nuk arriheshin nga organizimi i mëparshëm dhe që kanë të bëjnë me garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat, uljen e kostove, me qëllim përdorimin efikas të burimeve, përmirësimin e cilësisë dhe performancës së duhur të shërbimeve. Në drejtim të nënkriterit të domosdoshmërisë, shumica ka vlerësuar se kjo formë organizimi gjyqësor ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur situatën me të cilën po përballej sistemi dhe vetë përdoruesit e tij, nga njëra anë, dhe për të garantuar objektivat dhe parimet e ligjit, nga ana tjetër. Po kështu, është vlerësuar, në drejtim të përshtatshmërisë së masës, se, referuar të dhënave të disponueshme nga palët në gjykim, nuk vërehet dekurajimi i përdoruesve për t’iu drejtuar sistemit gjyqësor dhe nuk është provuar që riorganizimi i rretheve gjyqësore të ketë qenë barrierë në këtë drejtim (*shih paragrafët 80–83 të vendimit*). Shumica ka pohuar se në balancimin e interesave është respektuar interesi publik i së mirës së përgjithshme, nga njëra anë, me kufizimin e së drejtës së aksesit, nga ana tjetër, ndaj ndërhyrja nuk cenon parimin e proporcionalitetit (*shih paragrafin 89 të vendimit*).

3. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës për respektimin e parimit të proporcionalitetit, pasi



vlerësoj se masa e ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë të individit nuk është e nevojshme, e përshtatshme dhe as e domosdoshme për arritjen e objektivit që është synuar të arrihet - eficiencën e sistemit të drejtësisë në kuptim të ndarjes efikase dhe të drejtë të çështjeve, përdorimin efikas të burimeve, cilësinë në drejtësi, si dhe specializimin e gjyqtarëve. Me fjalë të tjera, në vlerësimin tim nuk plotësohet kriteri i baraspeshimit të kufizimit të aksesit në gjykatë me gjendjen që e ka diktuar këtë kufizim, ndërkohë që ka ekzistuar mundësia e përdorimit të mjeteve të tjera më pak të dëmshme për realizimin e interesit publik. Kjo do të thotë se harta e re gjyqësore nuk ka arritur të ruajë ekuilibrin kushtetues mes sigurimit të eficiencës së sistemit gjyqësor dhe ashpërsisë së kufizimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.

4. Duke iu referuar kuadrit normativ pas miratimit të Kushtetutës, duhet evidentuar se me dekret të Presidentit të vitit 1998 janë krijuar 6 gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm (Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë) dhe janë caktuar kufijtë tokësorë të veprimtarisë së tyre. Pas ndryshimeve ligjore dhe miratimit të ligjit të ri për organizimin e pushtetit gjyqësor, me dekret të Presidentit të vitit 2009 janë caktuar kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të apelit, të cilat kanë qëndruar të njëjtat në numër dhe në seli. Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, që parashikoi organizimin e gjykatave administrative dhe kompetencat e tyre, përcaktoi se gjykatat kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ku gjykatat administrative të shkallës së parë organizohen në numër dhe për territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil (*shih nenin 4*), pra duke pasur si referencë pikërisht organizimin e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me dekret të Presidentit të vitit 2012 është caktuar numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë, si dhe kompetenca tokësore e selitë qendrore të tyre, kurse organizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka mbetur i pandryshuar. Për rrjedhojë, që prej vitit 1998 harta e re gjyqësore ka sjellë ndryshimin më të thellë të organizimit të pushtetit gjyqësor, pavarësisht se edhe përgjatë

viteve ka pasur diskutime dhe propozime të ndryshme në lidhje me të.

5. Ligji nr. 98/2016, që përcakton rregullat e organizimit të pushtetit gjyqësor, ka parashikuar objektivat që ndiqen për caktimin e rretheve gjyqësore, kriteret për këtë qëllim, si dhe numrin minimal të gjyqtarëve për rritjen e eficiencës dhe për të siguruar specializimin në gjykata. Sipas këtyre parashikimeve, numri minimal i gjyqtarëve do të jetë: a) gjykata e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku shtatë gjyqtarë; b) gjykata e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, së paku dhjetë gjyqtarë; c) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë përbëhen nga së paku 16 gjyqtarë; ç) gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të apelit përbëhen nga së paku 11 gjyqtarë.

6. Referuar relacionit të këtij projektligji, risia e tij ka të bëjë me rritjen e numrit minimal të gjyqtarëve në përbërjen e një gjykate, që duhet respektuar në rast krijimi të saj dhe ai parashikon një bazë ligjore për të kryer një reformë të gjerë e gjithëpërfshirëse të hartës gjyqësore në vitet e ardhshme. Në lidhje me madhësinë e gjykatave, relacioni shpreh se shumica e vendeve evropiane po përqendrojnë gjeografikisht funksionet gjyqësore, duke zvogëluar në këtë mënyrë numrin e gjykatave, për arsye të ndryshme. Sipas udhëzimit të CEPEJ-it për krijimin e hartave gjyqësore në shtetet anëtare të BE-së (*CEPEJ (2013) 7, 2.3.2 Madhësia e Gjykatave*), produktiviteti më i lartë në nivel evropian është arritur në gjykatat me një numër të përafërt gjyqtarësh, ndërmjet 40 dhe 80. Raporti i CEPEJ-it “Për organizimin e gjykatave dhe kapacitetet e administratorëve të gjykatave në Shqipëri, 2016”, rekomandon një madhësi minimale të gjykatave nga 12 deri 14 gjyqtarë, për të mbështetur ndarjen efikase dhe të drejtë të çështjeve, përdorimin efikas të burimeve, cilësinë në drejtësi dhe të lejojë specializimin (*shih faqet 2–4 të relacionit shoqëruar të projektligjit*).

7. Për sa më sipër, qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e parimeve për caktimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave ka qenë përdorimi i kujdesshëm i burimeve publike, si dhe efikasiteti dhe cilësia e sistemit të drejtësisë, me synimin final që aksesit i qytetarit në gjykatë të



garantohet jo vetëm formalisht, por edhe në substancë, në kuptimin e cilësisë së drejtësisë. As nga përmbajtja e dispozitave ligjore, as nga relacioni shoqërues i projektligjit nuk është e mundur të konkludohet se ato kanë imponuar formulën aktuale të organizimit, me fokus veçanërisht në drejtim të juridiksionit rishikues, edhe pse rezultati i pritshëm në kohën e miratimit të hartës së re gjyqësore ka qenë edhe një reduktim i numrit të rretheve gjyqësore ekzistuese në atë kohë. Ndryshimi aktual në organizimin e rretheve gjyqësore më shumë se sa një masë që ka synuar të sigurojë plotësimin e objektivave të ligjvënës, ka qenë një zgjidhje emergjente e situatës me të cilën po përballej sistemi i drejtësisë për shkak të uljes domethënëse të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në përpjesëtim të zhdrejtë me rritjen e volumit të çështjeve në gjykata. Për rrjedhojë, analiza që i është bërë kësaj formule organizimi nuk është e bazuar në numrin e gjyqtarëve të miratuar nga KLGJ-ja, por në numrin faktik të tyre në detyrë, duke synuar shpërndarjen e tyre në atë mënyrë që të mundësohej numri i nevojshëm për formimin e trupave gjyqësore dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore.

8. Me vendimin nr. 553, datë 29.12.2022, KLGJ-ja ka përcaktuar numrin e gjyqtarëve në gjykatën e apelit, i cili është 78 gjyqtarë, ndërkohë që sipas ligjit numri minimal i gjyqtarëve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ është së paku dhjetë gjyqtarë. Numri i gjyqtarëve i miratuar nga KLGJ-ja përkon me numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të apelit edhe pse faktikisht ky numër është shumë më i vogël, por gjithsesi shumë më i lartë se minimumi prej 10 gjyqtarësh. Në këtë drejtim, krijimi i vetëm një gjykate të apelit me një numër kaq të lartë gjyqtarësh duket se nuk është në logjikën e ligjvënës dhe qëllimin e tij.

9. Sipas GJEDNJ-së e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë praktike dhe efektive, dhe ajo mund të dëmtohet, mes të tjerash, edhe për shkak të rritjes së kostove të procedurave (*shih García Manibardo kundër Spanjës*, 2000, §§ 38–45). Neni 14, i ligjit nr. 98/2016, përcakton se ndarja e kompetencave tokësore synon, ndër të tjera, edhe garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën. Ky element qartazi nuk është analizuar me saktësi dhe bazuar në të dhëna të matshme e reale nga grupi i punës. Për sa u përket treguesve për distancën dhe kohën e udhëtimit, raporti vlerësues i grupit të punës për hartimin e hartës gjyqësore rezultoi t'u jetë

referuar kodeve gjeografike për çdo vendndodhje (*google maps API*), si dhe distancës e kohës së udhëtimit ndërmjet kodeve gjeografike të identifikuar, duke përdorur sistemin OSMR, që mbështetet në burime të disponueshme publikisht, por nuk rezultoi nëse është verifikuar saktësia e llogaritjeve që kanë rezultuar përmes këtyre sistemeve, duke pasur parasysh specifikat e vendit tonë, përfshirë rrugët dhe trafikun, si edhe gjendjen aktuale të shërbimit të transportit publik.

10. Më duhet të evidentoj se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të qytetarit në gjykatë është paraqitur nga KSHH-ja në cilësinë e një organizate të shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile, si shprehje e lirisë kushtetuese të organizimit të qytetarëve, kanë një rol kyç në demokratizimin e shoqërisë. Ato monitorojnë vullnetarisht mënyrën se si ushtrohet pushteti publik dhe krijojnë forume për debatimin e politikave publike dhe shpërndarjen e informacionit për çështjet që prekin interesat e grupeve të ndryshme ose të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë mënyrë, veprimtaria e organizatave civile është e domosdoshme në funksionimin e shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nxit debatin publik dhe ndërgjegjëson qytetarët për çështje me interes të gjerë, por ato shërbejnë edhe si mekanizma të dialogut konstruktiv midis qytetarëve dhe autoriteteve publike. Organizatat e shoqërisë civile, duke qenë të pavarura, janë partnere jetike të shtetit demokratik. Ato kanë aftësinë që me veprimtarinë e tyre vullnetare dhe të pavarur ta bëjnë shtetin në të gjitha nivelet më të përgjegjshëm, llogaridhënës, gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke i forcuar atij legjitimitetin dhe besimin e qytetarëve. Në kuptim të këtij roli thelbësor në një shtet demokratik, shoqëria civile, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe vlerat themelore, bën që autoritetet publike të të gjitha niveleve të jenë më të përgjegjshme, më reaguese, efektive dhe gjithëpërfshirëse, pra më legjitime e më të përgjegjshme në ushtrimin e pushtetit në raport me qytetarin.

11. Në ushtrim të këtij funksioni dhe roli, KSHH-ja ka paraqitur para Gjykatës disa monitorime të kryera prej saj në disa qytete ku janë mbyllur gjykatat dhe nga të dhënat e analizuar ka rezultuar se harta e re nuk është mirëpritur dhe se për përdoruesit e gjykatave, për shkak të rritjes së distancave mes qendrës ku ata jetojnë dhe gjykatës kompetente, rriten në mënyrë të menjëhershme



edhe kostot dhe shpenzimet e procesit gjyqësor. Sipas saj, kjo ndikohet nga rritja e kostos së transportit dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme për të bërë të mundur aksesin në gjykatë. Po kështu, KSHH-ja paraqiti bashkëlidhur jo vetëm petitionin e banorëve të Mat-it, duke e bërë pjesë të mbrojtjes së saj, por edhe rezultatet e monitorimit të kryer me nismë në atë zonë, duke evidentuar situatën faktike referuar gjendjes ekonomike, si edhe gjendjes së infrastrukturës rrugore e të shërbimit publik të transportit. Këto të dhëna nuk u morën parasysht dhe nuk u vlerësuan nga shumica, edhe pse ato janë përftuar nga monitorimet në disa qytete ku janë shkruirë gjykatat dhe janë bazuar në intervistimin e qytetarëve dhe përdoruesve të gjykatave. Në vlerësimin tim ato duhej të ishin marrë parasysht, të ishin vlerësuar dhe analizuar jo vetëm për shkak të informacionit që përcjellin, por edhe për shkak se paraqiten nga një organizatë e shoqërisë civile, që përbën mekanizëm komunikimi midis autoriteteve publike dhe qytetarëve. Për më tepër, vetë KSHH-ja, siç është pranuar në mënyrë konstante në jurisprudencën e Gjykatës, është një organizatë me përvojë tashmë të gjatë në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, si një nga qëllimet kryesore të veprimtarisë së saj.

12. Edhe Avokati i Popullit, mandati kushtetues i të cilit është mbrojtja e lirive themelore të njeriut nga veprimet e parregullta të administratës publike, në mendimin e tij me shkrim para Gjykatës, është shprehur se në fazat e para të propozimit të hartës së re, pra përpara miratimit të VKM-së nr. 495/2022, ka ndjekur me vëmendje diskutimet dhe debatet publike dhe ka kërkuar të marrë pjesë aktive në takime, dhe në ato ku është thirrur ka parashtruar mendimet e tij. Në përfundim të procesit të konsultimit Avokati i Popullit i ka adresuar organeve përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e hartës gjyqësore rekomandimin për rishikimin e projektit, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve në kuadër të së drejtës për proces të rregullt. Ky rekomandim nuk rezultoi të jetë pranuar nga Ministria e Drejtësisë, kurse nga KLGJ-ja nuk ka pasur përgjigje në lidhje me të. Avokati i Popullit ka mbajtur para Gjykatës të njëjtin qëndrim se zbatimi i hartës së re nuk e përmirëson aksesin, por e cenon atë, duke sjellë rritjen e kostove për qytetarët dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

13. Ndërkohë që për sa i përket argumentit të parashtruar nga subjektet e interesuara dhe të pranuar nga shumica se në gjykimin në apel nuk është e domosdoshme prania e palës ose edhe e vetë mbrojtësit, pasi gjykimi zhvillohet edhe mbi bazën e akteve, vlerësoj se ai nuk është i tillë që të justifikojë kufizimin e së drejtës së aksesit, për sa kohë që shqyrtimi gjyqësor në atë gjykatë bëhet, si rregull, në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe është vetëm në vullnetin e palëve ndërgjyqëse pjesëmarrja në gjykim personalisht ose përmes përfaqësuesit ligjor. Për rrjedhojë, formula e zgjedhur për hartën e re gjyqësore, duke parashikuar vetëm një gjykatë të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, uljen e thellë të numrit të gjykatave, përfshi ato të juridiksionit administrativ, nuk rezultoi të jetë masë e përshtatshme dhe proporcionale, për sa kohë që nuk ka arritur të balancojë interesin që synohet me të drejtat kushtetuese të shtetasve që kufizohen.

14. Në vlerësimin tim, edhe pse qëllimi i ligjvënësit ka qenë përmirësimi dhe garantimi i aksesit në drejtësi për qytetarët, harta e re gjyqësore ka sjellë efekte të kundërta si në lidhje me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ashtu edhe ato të juridiksionit administrativ të shkallës së parë, pasi dukshëm e ka larguar qytetarin jo vetëm fizikisht nga gjykata, por duke cenuar edhe aksesin substancial për shkak të rritjes së kostove dhe shpenzimeve që duhet të përballojë, çka mund të çojë deri në pamundësi të ushtrimit të kësaj të drejte, pra në mohim të saj. Duke pasur parasysht se aksesin në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 16, datë 23.3.2023; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*), çmoj se zgjidhja e miratuar e organizimit gjyqësor përmes hartës së re nuk u provua të jetë proporcionale, e përshtatshme dhe e domosdoshme në drejtëm të efektit të synuar nga ligjvënësi, por ka qenë një zgjidhje që ka synuar vetëm rregullimin e një situatë problematike akute me të cilën po përballej sistemi gjyqësor.

15. Nga ana tjetër, për zgjidhjen e çështjes konkrete është me rëndësi të analizohet edhe efekti i shfuqizimit të menjëhershëm të VKM-së nr. 495/2022. Siç u pranua në gjykim edhe nga përfaqësuesi i KSHH-së, në situatën aktuale shfuqizimi i menjëhershëm do të krijonte probleme më të mëdha si në drejtëm të aksesit, ashtu edhe të eficientës, duke krijuar kaos në organizimin



gjyqësor. Në këtë drejtim duhet evidentuar se sipas ligjit nr. 98/2016 harta gjyqësore i nënshtrohet një procesi vlerësues periodik prej KLGJ-së, me qëllim që organizimi gjyqësor t'i përshtatet si duhet zhvillimeve institucionale dhe shoqërore. Më konkretisht, KLGJ-ja ka detyrimin të vlerësojë organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet nëse ai përmbush objektivat, parimet dhe kriteret ligjore. Në këtë kuptim, harta gjyqësore aktuale ka hyrë në fuqi në vitin 2023 dhe rivlerësimi i saj do të duhet të bëhet jo më vonë se viti 2028. Duke mbajtur në konsideratë nevojën për të shmangur kaosin në organizimin gjyqësor, që do të ishte një pasojë edhe më e rëndë kushtetuese në drejtim të aksesit formal dhe substancial të individit në gjykatë, vlerësoj se Gjykata duhet të kishte konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese të aksesit dhe të urdhëronte organet përgjegjëse të rishikonin hartën gjyqësore brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e vendimit. Një afat i tillë do të ishte i mjaftueshëm për të arritur objektivat e ligjvënësit dhe për garantuar të drejtën e aksesit të individit në gjykatë.

Anëtare: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, kërkesa e paraqitur nga Dhoma e Avokatisë dhe KSHH-ja është e bazuar tërësisht, ndaj Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e saj për shkak se VKM-ja nr. 495/2022, me të cilën është miratuar harta gjyqësore, është e papajtueshme me Kushtetutën, pasi cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe barazinë para ligjit të avokatëve, si edhe të drejtën e aksesit të qytetarëve në gjykatë në atë masë sa që, në thelb, e bën të pamundur ushtrimin e tyre.

2. Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore bëhet vetëm në kushtet e parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës, pra: vetëm me ligj, duke iu referuar këtu burimeve parësore dhe atyre dytësore të dala me autorizim dhe në zbatim të ligjit; për interes publik ose mbrojtjen e të drejtave të tjerëve, pra për të mbrojtur ato prime, vlera, objektiva dhe të drejta të mbrojtura kushtetutshmërisht; kufizimi nuk mund të mohojë dhe cenojë natyrën dhe thelbin e së drejtës; ai duhet të jetë proporcional, në kuptim të parimit të shtetit të së drejtës, që nënkupton se masa duhet të ndjekë qëllime të ligjshme që janë të

rëndësishme për shoqërinë dhe ajo nuk duhet të kufizojë të drejtën/lirinë më shumë se sa është e nevojshme për të arritur objektivat e synuar. Rastet ose situatat ekstreme, si ato të krizave apo që kërkojnë ndërhyrje urgjente ose të jashtëzakonshme, nuk nënkuptojnë përjashtimin e autoriteteve nga respektimi i kërkesave të proporcionalitetit të ndërhyrjes. Ky parim nënkupton që edhe në ato raste kur nevojitet marrja e masave që synojnë të garantojnë interesat e shoqërisë dhe ato shtetërore, këto masa nuk duhet të jenë diskriminuese, duke ruajtur, edhe në kategori apo grupe jo të njëjta, të njëjtin raport, në mënyrë uniforme, me situatën në të cilën ndodheshin para ndërhyrjes, pra nuk duhet të rëndojnë më shumë mbi një kategori të caktuar në krahasim me të tjera që preken prej saj.

3. Për sa i përket “interesit publik”, Gjykata ka pohuar se ky koncept është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj. Çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyeshme publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore nuk renditen në mënyrë shteruese, por vetëm në sensin negativ, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Gjykata ka theksuar edhe se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me këtë element, pra interesin publik, në vlerësimin tim ai identifikohet në parashikimet e neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 98/2016, sipas të cilave kompetencat tokësore caktohen në bazë të kriterëve të identifikuar qartësisht dhe synojnë përmbushjen në mënyrë të ekuilibruar të këtyre objektivave: a) garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën; b) uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike; c) rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara. Në hartimin e këtij ligji është parë dhe vlerësuar edhe pasoja në drejtim të zvogëlimit të gjykatave të vogla, për sa kohë që është përcaktuar një numër minimal i gjyqtarëve për çdo shkallë gjykimi. Duke përcaktuar këto kriterë dhe numrin minimal të gjyqtarëve në gjykata, ligjvënësi është kujdesur edhe për të siguruar mbrojtjen e interesit publik, i cili identifikohet i lidhur ngushtësisht me të drejtat e qytetarëve si për të pasur drejtësi eficiente, ashtu edhe për të pasur akses të plotë formal dhe substancial në gjykatë. Ndërkohë, në miratimin e



hartës së re gjyqësore nuk identifikohet asnjë interes publik, përkundrazi ajo është një masë që vjen në kundërshtim me interesin publik të identifikuar nga ligjvënësi, duke synuar më shumë zgjidhjen e një situatë konkrete me karakter të përkohshëm, se sa vënien në jetë të parimeve dhe objektivave të përcaktuar qartësisht nga ligji nr. 98/2016. Në vlerësimin tim nuk mund të ketë një interes publik të identifikuar në të drejtat e përdoruesve të sistemit për të pasur një drejtësi eficiente, duke cenuar të drejtat e të njëjtut grupim individësh, pra të përdoruesve të sistemit për t'iu drejtuar gjykatës me qëllim që të përfitojnë nga kjo drejtësi eficiente.

4. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë, duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpiten në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Ajo që rezultoi gjatë procesit gjyqësor në këtë Gjykatë është se organet kompetente sipas ligjit nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të parashikuar forma të tjera organizimi që shkojnë në përputhje me interesin publik të identifikuar nga ligjvënësi. Në drejtim të interesit publik dhe arsyeve legjitime që e justifikojnë zgjidhjen, autoritetet publike nuk duhet të zgjedhin rrugën dhe metodën më të thjeshtë ose më të lehtë, ndërkohë që ato jo vetëm duhet të bëjnë përpjekjet maksimale, por duhet të provojnë se pavarësisht këtyre përpjekjeve ishte e pamundur që të gjendej një mjet tjetër i përshtatshëm dhe që garantonte ndërhyrje sa më të vogël në të drejtat kushtetuese. Në rastin konkret është zgjedhur mjeti më i shpejtë dhe më i lehtë për zgjidhjen e një situatë konkrete, por pa pasur kujdes që të mos shkeleshin liritë dhe të drejtat themelore. Fakti që organizimi gjyqësor është një masë që mund të ndryshojë edhe periodikisht, në varësi të vlerësimit që i bën KLGJ-ja, si organi i përcaktuar nga ligji, nuk interpretohet se shteti është i përjashtuar nga detyrimi për të gjetur ato mundësi që të sigurojnë ruajtjen e thelbit të së drejtës dhe as nuk justifikon ndërhyrje të pajustificuara në një moment të caktuar mbi

argumentin se problemet apo shkeljet mund të riparohen në të ardhmen.

6. Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata ka theksuar se respektimi i përmbushjes së kushteve të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar (njëfarë relativiteti) në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin tim nuk është zbatuar në ndërhyrjen e kundërshtuar as parimi i proporcionalitetit midis ndërhyrjes në të drejtat dhe liritë kushtetuese dhe nevojës që e ka diktuar atë. Harta e re gjyqësore është në kapërcim të kriterit më esencial të kufizimit, paprekshmërisë së thelbit të së drejtës përballë çdo kufizimi. Mënyra e organizimit të rretheve gjyqësore u ka mohuar tërësisht avokatëve ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, kurse individit aksesin në gjykatë qoftë personalisht, qoftë me përfaqësues të zgjedhur.

7. Për sa i përket pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, e gjej të padrejtë qëndrimin e shumicës se për shkak të mënyrës se si është i organizuar shërbimi i avokatisë, avokatët kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë çdo gjykate, pavarësisht dhomës vendore së cilës i përkasin. Mënyra e organizimit të dhomave të avokatisë aktualisht jo më kot ka qenë e lidhur me ngritjen dhe funksionimin e tyre në ato qendra ku ka pasur gjykata të shkallëve të ndryshme të gjykimit, për sa kohë veprimtaria kryesore e avokatit lidhet me përfaqësimin e palëve në procese gjyqësore, pra ushtrohet pranë gjykatës. Për këtë arsye, kryesisht, zyrat e avokatisë i kanë selitë e tyre sa më pranë territorit të gjykatës, në mënyrë që të sigurohet akses i më i shpejtë. Në organizimin aktual avokatët në ato qytete ku nuk ka më gjykata do të duhet që për shkak të largësisë me gjykatat ku ata kanë procese të iniciuara apo kërkojnë që të iniciojnë të tilla, jo vetëm të humbasin kohë fizike për të aksesuar shërbimet e nevojshme, por edhe të rrisin tarifat për këtë shkak, duke shtuar edhe shpenzimet e udhëtimit drejt dhe prej gjykatës. Përveç të dhënave që lidhen me datat e seancave gjyqësore apo listat e gjykimeve, që mund të aksesohen edhe përmes faqeve zyrtare, çdo veprim tjetër pranë gjykatës është i pamundur të bëhet me mjete të tjera përveç paraqitjes personalisht, ku përfshihet marrja apo depozitimi i akteve, paraqitja e kërkesave etj. pranë sekretarisë gjyqësore, deri te pjesëmarrja në seancë gjyqësore, pa përfshirë këtu rastet e shtyrjeve ose moszhvillimit të



seancave të caktuara. Për këtë arsye praktikisht avokatët do të detyrohen të qëndrojnë për një kohë të gjatë jashtë zyrës së avokatisë, duke mos pasur mundësinë të ofrojnë shërbime të tjera ligjore, si dhe do të jenë në pamundësi të ndjekin procese të ndryshme në gjykata të ndryshme. Largësia fizike me gjykatën dhe rritja e tarifave do t'i çojë palët drejt avokatëve që i përkasin dhomave vendore që ndodhen në qendrat ku ndodhen gjykatat sipas organizimit të ri, në mënyrë që të sigurojnë informacion më të shpejtë, praninë e tyre në procese por edhe tarifa më të ulëta për procesin. Nga ana tjetër, edhe nëse pranohet se Këshilli i Përgjithshëm Dhomes së Avokatisë, sipas ligjit, mund të miratojë një organizim të ndryshëm të dhomave vendore, për ta përshtatur me organizimin gjyqësor, kjo do i detyronte avokatët të shpërnguleshin nga qytetet ku ata kanë ndërtuar jetën dhe punën e tyre, duke prekur edhe të drejtën për jetë familjare, drejt qyteteve të tjera, duke u futur sërish në një treg jo të barabartë me avokatët që tashmë ushtrojnë aty veprimtarinë prej kohësh.

8. Në drejtim të lirisë së veprimtarisë ekonomike në vlerësimin tim kjo masë është e tillë që e cenon këtë liri në thelbin e saj, duke e bërë thujtë të pamundur ushtrimin e veprimtarisë nga një pjesë e madhe e avokatëve. Për të njëjtat arsye, vlerësoj se trajtimi i pabarabartë mes avokatëve të dhomave vendore në qytetet ku nuk ka më gjykata me avokatët e tjerë në ato qytete ku ka gjykata nuk është bërë për arsye objektive dhe të përligjur. Situata e avokatëve që ushtrojnë veprimtarinë në qytetet ku janë shkriur gjykatat është përqendruar dhe ata janë vendosur në situatë të disfavorshme me avokatët e tjerë, edhe pse i përkasin së njëjtës kategori dhe duhet të trajtohen në kushte të barabarta.

9. Edhe në lidhje me të drejtën e aksesit, vlerësoj se individit i është mohuar në thelb e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet përbërës të nenit 42 të Kushtetutës. Në një shoqëri demokratike, e drejta e individit për t'u dëgjuar nga gjykata është një garanci e domosdoshme për të respektuar të drejtat dhe liritë e tjera themelore të shtetasve në një shtet të së drejtës. Kjo e drejtë është thelbësore dhe ka karakter parësor në një shoqëri demokratike për shkak të pasojave që ka në interesat legjitimë të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 26, datë 13.6.2007; nr. 21, datë 24.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Në mënyrë që e drejta e aksesit të jetë efektive kërkohet që individit të ketë një mundësi të

qartë dhe praktike për të kundërshtuar aktet që cenojnë të drejtat e tij të ligjshme (*shih Bellet v. France, viti 1995, § 36; Camelia Bogdan v. Romania, viti 2020, §§ 75–77*).

10. Organizimi i ri gjyqësor jo vetëm që ka larguar qytetarin nga gjykata, por ka sjellë për pasojë edhe rritjen e shpenzimeve gjyqësore për palët në proces, për shkak të rritjes së kostove dhe shpenzimeve të avokatit dhe të tarifave të përfaqësimit. Impakti ndihet jo vetëm tek ata qytetarë që jetojnë në qytetet ku janë shkriur gjykatat, por edhe tek ata që jetojnë në zonat që kishin afërsi me to. Ndërkohë që aktualisht, si në rastin kur qytetari vendos t'i drejtohet vetë gjykatës, ashtu edhe në rastin kur ai vendos të përfaqësohet me avokat, shpenzimet dhe kostot që i ngarkohen janë rritur automatikisht qoftë edhe vetëm për shkak të rritjes së largësisë fizike, gjë që u provua në gjykim me raste konkrete edhe nga përfaqësuesi i Dhomes së Avokatisë.

11. Edhe pse ligji nr. 98/2016 është miratuar në vitin 2016, harta e re është miratuar pas gjashtë vjetësh, ndërkohë që ka hyrë në fuqi akoma më vonë, përfundimisht në korrik të vitit 2023. Përgjatë kësaj periudhe kohore nuk është paraqitur nga subjektet e interesuara asnjë veprim i ndërmarrë për të vlerësuar impaktin dhe pritshmëritë në drejtim të zbatimit të reformës në drejtësi dhe procesit të rivlerësimit kalimtar dhe ndikimit që do të kishte ai mbi administrimin e duhur të drejtësisë dhe efektivitetin e sistemit.

12. Sipas subjektit të interesuar, KLGJ-së, duke iu referuar gjykatave të apelit, ato Korçë dhe Gjirokastrë ekzistuese nuk justifikonin numrin prej 10 gjyqtarësh, kurse ajo Durrës nuk justifikonte ekzistencën për shkak të afërsisë gjeografike me Tiranën. Shkodra, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, nuk krijonte mundësinë e formimit të seksioneve, kurse Vlora nuk ofronte hapësirë të njëjtë për ndarje në seksione dhe nënseksione sikurse Tirana, duke pasjellë diferencë në trajtimin në kohë të mosmarrëveshjeve, numrin e çështjeve për gjyqtar dhe marrjen e drejtësisë në të njëjtin standard profesional. Edhe referuar parashtrimeve të këtij subjekti është e qartë se shkak dhe arsyeja e miratimit të hartës së re ka qenë vetëm zgjidhja e një situatë ngërçi e shkaktuar nga mungesat e gjyqtarëve. Duke e marrë të mirëqenë sa më sipër dhe duke konsideruar se për këtë shkak sistemi nuk ishte më eficient dhe kishte nevojë për një masë të tillë, nuk ka asnjë argumentim se përse nuk ishte i mundur,



mbi bazën e numrit të gjyqtarëve në kohën e hartimit të hartës gjyqësore, një organizim i ndryshëm. Nga ana tjetër, nuk ka asnjë analizë se përse prurjet e Shkollës së Magjistraturës, që i përkasin periudhës nga miratimi i ligjit nr. 98/2016 dhe deri në vlerësimin e organizimit gjyqësor në fuqi dhe propozimin e hartës gjyqësore, nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar një konfigurim të ndryshëm të gjykatave. Përfaqësuesve të KLGJ-së në seancë plenare iu parashtrua edhe alternativa e deritanishme e komandimit/delegimit të gjyqtarëve në gjykata të tjera për çështje të caktuara.

13. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, ndërsa ligji ka synuar një interes publik, që është aksesit i qytetarit në gjykatë, duke parashikuar kriteret të qarta për ta siguruar atë, harta e re gjyqësore e ka përmbysur këtë interes, duke vendosur një barrë të tepruar dhe joproporcionale mbi përdoruesit e sistemit. Qëllimi i vetëm i synuar në këtë rast është zgjidhja e një situate të përkohshme për gjyqtarët dhe KLGJ-në dhe çdo pasojë që mund të ketë sjellë ajo në drejtim të administrimit të proceseve gjyqësore për evadimin e çështjeve apo zhvillimin e seancave gjyqësore,

është më e rëndë se sa pasoja që ka ardhur në të drejtën e aksesit të qytetarit në gjykatë. Në miratimin e kësaj mase, pavarësisht se ligji e ka parashikuar si kriter, nuk është mbajtur parasysh as largësia e qytetarit nga gjykata, as gjendja e infrastrukturës rrugore, transportit publik dhe as gjendja ekonomike, të cilat u provuan nga KSHH-ja, përmes të dhënave të përfthuara nga monitorimet e saj, nga peticioni i banorëve të qytetit të Matit dhe mendimi i Avokatit të Popullit, se janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë dhe afektojnë aksesin në gjykatë.

14. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, harta gjyqësore nuk respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, ndaj kërkesa duhej të ishte pranuar për të tria pretendimet e saj, lirinë e veprimtarisë ekonomike, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të drejtën e aksesit, duke shfuqizuar në këtë mënyrë VKM-në nr. 495/2022 si të papajtueshme me Kushtetutën.

Anëtare: Sonila Bejtja

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë